Viti XXIV. Nr. 5

ISSN 0353/7110

ALTERNATIVA

Revistë për kulturë dhe shkencë

LUBLANË 2015

ALTERNATIVA

Časopis za znanost in kulturo

Revistë
për shkencë dhe kulturë

ISSN 0353-7110

LUBLANË, 2015

Viti XXIV. Nr. 5

Këshilli botues

Akademik dr. Aleksander Stipčević
dr. Zef Mirdita
dr. Martin Berishaj
dr. Anton Bebler
dr. Shaban Sinani
dr. Afrim Krasniqi
dr. Pëllumb Qazimi
dr. Ledi Shamku – Shkreli
dr. Ivo Andrijanić
dr. Romeo Gurakuqi
dr. Rovena Vata
dr. Irena Šumi
dr. Braco Rotar

Kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës: Prof. dr. Martin Berishaj

Adresa: KDA MIGJENI, Celovshka 177 Lublana
Email: martin@berishaj.com

Redaksia:
Tahir Maliqaj, Kryeatar i SHKSH "Migjeni"
Mr. Alma Bejtullahu
Mr. Zef Ahmetaj
Mr. Albert Ramaj
Valentin Batalaku

Alternativa izhaja s finančno pomočjo Javnega Sklada Republike Slovenije za kulturne dejavnosti

IZDANO V 2.000 PRIMERKIH

+GS 403668

PËRMBAJTJA

Shqiptaret ne pritje te nderrimit te Kushtetutes sllovene 4
Dromca ne mediat shqipe 12
Ramushi ne Slloveni dhe shia e idhtë e ndalesës 14
Në Slloveni strukturat ish-komuniste ende kanë ndikim në sistemin e drejtësisë 14
Kombi shqipatr asnjëherë agresor 21
Shqiperia arenë luftrash 22
studime politike dhe juridike 50
Kushtetutat shqiptare si eksperimente te vazhdueshme 51
Fillimet kushtetuese, burim i Konferencës së Londrës 52
Nga Kushtetutat deklarative, në Kushtetutën qeverisëse 54
Rikthimi i monarkisë dhe fundi i saj në Shqipëri 56
Kushtetutat e sistemit njëpartiak në Shqipëri 58
Kushtetutat e tranzicionit, - drejt një modeli kushtetues 60
Oferta e përhershme, - ndërhyrje në kushtetutë 63
Pomen in značilnosto volitev 71
Neposredna in posredna demokracija 71
Volitve in volilno telo 74
Volitve in delovanje državne oblasti 80
Volitve in referendum 84
Volitve in politične stranke 87
Vpliv političnih strank na volitve 90
TEMELJNE ZNAČILNOSTI VOLILNEGA SISTEMA 91
Pojem in temeljne prvine 91
Volilni sistem in volilno pravo 95
Volilni postopek 97
NAČELA VOLILNEGA SISTEMA 98
Pojem in pomen volilne pravice 99
Praviloma je povsod zagotovljeno sodno varstvo volilne pravice, seveda na različne načine v skladu s tradicijo posamezne države. To funkcijo opravljajo v Evropi predvsem upravna sodišča, končna instanca pa so praviloma ustavna sodišča. V Franciji je pri tem še posebej zanimiva vloga Državnega sveta in Ustavnega sveta. 100
Splošna volilna pravica 100
Pojem in vsebina 100

Narodna in univerzitetna knjižnica Ljubljana
J2015376O

Neizvoljivost in nezdružljivost funkcij *105*
V zvezi s pasivno volilno pravico je treba posebej omeniti vprašanje neizvoljivosti (inelegibilnosti) in nezdružljivosti (inkompatibilnosti) državnih funkcij. 105
Enaka volilna pravica *107*
Neposredna in posredna volilna pravica *109*
Svobodna volilna pravica in tajnost glasovanja *111*
shpalime linguistike dhe etnologjikeFishta nga „rrebelimi ne rrebelim“ 113
Shtjefën Gjeçovi – tharm i etnografisë shqipe 124
Gjurmë të Lambertzit në mbledhjen dhe studimin e folklorit shqiptar 129
Kostumografia dhe Ritet e Dasmes Tradicionale Shqiptare . 135
Veshjet e dasmës *136*
Velloja e nusërisë *136*
Unazat e martesës *137*
Muaji i mjaltit (hënës) *138*
Momentet premartesore të Labërisë *144*
Nusja pritet me krisma *145*
Dhëndri dhe lojërat e hajdutërisë *147*
Paja e nuses *150*
Izvinite druže predsedniče 158
Takimi i parë: Formimi i grupit të delegatëve dhe njohuritë me detyrat *163*
Gjorgjeviqi ndërron datën 2.07.1990 për vazhdimin e mbledhjes me 5.07.1990 ..... *164*
Thirrje urgjente në Kryesinë e Kuvendit *164*
Urgjent një emision TV *165*
Takimi i dytë e grupit të delegatëve: Informim për përgatitjen e vazhdimit të tretë të seancës së VIII *165*
Poezi 169
Himni i shpirtit 170
Të vërtetat tua 170
Ecim presim 171
Gjystes 173

Kerkoja 174
Loti 174
Qazim Xani 175
Atje n'Juug 175
Udhëtar 176

SHQIPTARET NE PRITJE TE NDERRIMIT TE KUSHTETUTES SLLOVENE

Shqiptaret per nje muaj rresht ishin te prezantuar ne Muzeun e qytetitt (Mestni muzej), projekti "**Muzeji povezujejo**" (Muzetë krijojnë lidhje) i cili u sponsorua nga Fondi Publik i Sllovenise, ku si bartes projekti ishte SHKSH Migjeni ne Lublane. Pergjegjese dhe ideatore e projektit ishte doktorantja Alma Bejtullahu. Gjate nje muaji shqiptaret u prezantuan si eshte me mire. Aty u prezantuan rrefimet e suksesshme shqiptare ne Slloveni, duke u sjellë ato, miqeve slloven. Nga viti 1968 kur u shenua 500 vjetori i Gjergj Kastriotit – Skenderbeut ne Dramen sllovene me shfaqjen prestixhioze "Erveheja", nuk kishim asnjehere kesi lloj prezantimi si ky i tashmi.

Por jo vetem ne Lublane, edhe ne bregdetin slloven ne qytetin e Piranit poashtu u be ekspozita "**A bi kaj sladkega**" te bartesit te projektit, kesaj here si kurator i ekspozites, Gani Lllalloshit i cili permblodhi rreth vetes eliten kulturore shqiptare, duke i prezantuar sllloveneve por edhe te gjithe atyre qe do e vizitojne bregdetin slloven gjate muajve te verese.
Pra, tre muaj dite rresht, shqiptaret u ofrojnë "**diçka te embel**" te gjithe atyre qe e adhurojne artin, por jo vetëm.

Ka kohe qe Lublana nuk ishte e vizituar me aqe intensitet nga qeveritaret nga Kosova, sa kete fillimviti. Delegacione te panumerta kane vershyer keto ane. Padyshim, kjo me shume ka te beje me agjenden e ngjeshur te Sllovenise per te bere kthese ne "back to the future" sesa intencën tonë për t'u kthye nga Lublana." Procesi Brdo" si iniciative gjermane ka ngarkuar Sllovenine me barrën qe ajo duhet te mbaje ne procesin e perafrimit te "Ballkanit perendimore". Personalisht jam shume me i prirur te quaj kete pjese te Evropes , si Evrope Juglindore sesa keshtu siç quhet, por, sidoqofte!

Vizita zyrtare e ministrit te puneve te jashtme dhe zevendeskryeminsitrit te Republikës se Kosoves z Thaçi ne Slloveni hapi shteg për ardhjen e Kryeminstrit Mustafa ne Lublane. Si gjithehere, shqiptaret e ketushem e ne veçanti SHKSH Migjeni i organizojë Kryeministrit te Kosoves takim me bashkatdhetaret. E veçanta e ketij takimi ishte, sepse ndodhi dy dite pasi qe u be shtetrrethimi ne Kumanove nga forcat policore dhe ushtarake. Pritnim qe takimi te shpalonte ndonje te "re" nga krejte kjo qe ndodhi. Por, si gjithemone, ata, kur duhet te marrin qendrime, si "rregull" flasin "ne mjeker", sikur nuk deshirojne qe te marrin pergjegjesi!
Si gjithmone shqiptaret qe jetojme dhe veprojme ketu ne Slloveni te udhëhequr nga SHKSH Migjeni dhe shoqatat tjera organizuem tubim humanitare per Kumanove. E quajtem jo rastesisht **"Nene, a vrasin keta femije"!.**
U mblodhe nje sasi e konsiderueshme e mjeteve qe u derguan ne Kumanove, familjeve te demtuara. Fjalimin e rastit e kishte Prof.dr. Martin Berishaj, i cili ne mer te komunitetit shqiptare ne Slloveni ne mes terash tha:" ... Te gjithe neve ketu, sot na ka mbledhur loti dhe ankthi, ofshama dhe gjama e femijeve, pleqeve dhe familjareve shqiptarë, i nje fati kolektiv te pambrojtur e te leshuar ne duartë e atyre qe kerkojne me doemos te qendrojne ne pushtet.

Policia dhe ushtria e Maqedonisë ne shtetrrethim te Kumanoves ka sulmuar shqiptarë të pafajshëm, burra, gra, fëmijë, në mëngjes herët, pa njoftim dhe pa paralajmërim. U ka marrë atyre gjithçka që kishin, në radhë të parë i ka dhunuar si shtetas të barabartë të Republikës së Maqedonisë... Dua qe me ju te ndaje medimin tim edhe lidhur me sjelljen e kreut të opozites maqedonase Zaevit ndaj situates se krijuar dhe shqiptareve ne Maqedoni ..... dhe fjalimin e perfundojë me...
Kjo sjellje me perkujton ne puthjen e fundit te judes qe ia beri krishtit duke u dhene shenje romakeve për ta kryqëzuar atë!
kryqezime te tilla populli shqiptare me nuk do ti lejoje dhe as nuk do ti marrin sepse ne kemi vetem një hy, atë të shqiptarisë!

Pastaj ndodhi ndalesa e Ramush Haradinajt ne baze te fletarrestit te leshuar nga nje shtet qe nuk ekziston ai i Serbise dhe Malit te Zi. Ramushi u leshua nga kjo ndalesë. Disa parapëlqenin te thonë se u lirua. Leshimin e tij e pershendesim dhe shpresojmë se raste te tilla nuk do perseriten jo vetem ketu por edhe gjetiu.

Lidhja e Shoqatave shqiptare ne Sllloveni ne krye me kryetrain e saj Tahir Maliqaj, eshte ne pritje te nderrimit te Kushtetutes sllovene, ku shqiptaret shpresojme se do te trajtohen si pakicë kombetare.

Tahir Maliqaj

Ekspozita "**A DONI DIÇKA TË ËMBËL**?"artistët kosovarë në Slloveni

Ali bi kaj sladkega? je naslov skupinske razstave kosovske sodobne likovne umetnosti. Idejni pobudnik in kustos razstavnega projekta v Obalnih galerijah Piran je umetnik **Gani Llalloshi**.

Llalloshi je bil rojen na Kosovu, likovno umetnost je študiral v Ljubljani, Berlinu in Parizu, živi pa v Portorožu. Zbral je dela dvajsetih tako svetovno uveljavljenih kot manj znanih kosovskih umetnic in umetnikov, ki so začeli z delom po letu 2000 ali pa so takrat bili deležni večjih mednarodnih priznanj. Razstavljena dela v različnih

tehnikah, od videa, fotografije, instalacije do risbe in slike, bodo razkrivala različne osebne zgodbe in pripovedi umetnikov, "ki so odraščali v družbi brez institucionalno organiziranega sistema umetnosti, brez finančne podpore in z majhno možnostjo pridobivanja informacij o mednarodnih dogajanjih v sodobni vizualni umetnosti. Kljub težavam pri komunikaciji z ostalim svetom niso nehali iskati možnosti za predstavitev svojih misli in so s svojimi deli prodirali na mednarodne trge, začeli so sodelovati na pomembnih razstavah, vzbudili so pozornost mednarodnih likovnih kritikov, pa tudi ljubiteljev sodobne vizualne umetnosti," je zapisal Gani Llalloshi v spremni publikaciji.

Razstavo so Obalne galerije Piran pripravile v sodelovanju z Leutrimom Fishekqiu, predsednikom kulturnega društva LEOS-Art.org. iz Prizrena na Kosovu. Podprli pa so jo: Ministrstvo za kulturo RS, Občina Piran, Veleposlaništvo Republike Slovenije v Prištini in Veleposlaništvo Kosova v Ljubljani.

A bi kaj sladkega?

Nekoč sem poznal starega slaščičarja. Od trenutka, ko je izvedel, da sem študent, sem pri njem vedno brezplačno pil kavo in bil tako na nek način študent, ki ga je subvencioniral stari patriot. Medtem ko sem srkal kavo ali jedel burek, sem ga opazoval, kako je pozorno in ljubeznivo stregel svojim gostom. Za dobrodošlico jih je vedno prehitel s prisrčnim vprašanjem: "Ali bi nekaj sladkega?" Na obrazih njegovih gostov sem opazil, da jih to njegovo vprašanje vedno spravi v dobro voljo, a jih tudi postavi pred dejstvo, da morajo razmisliti in se odločiti, zakaj so tu. "Če imaš rad svoje delo, lahko pripovedueš o sebi, družini, družbi in deželi," so bile besede starega slaščičarja.

Od takrat je minilo veliko let, starega slaščičarja ni več, a njegovih besed iz najinih pogovorov se dobro spominjam. Sinergija spominov

in razmišljanje o današnji družbi in prostoru, v katerem živimo, sta postala motiv za razstavo, osredotočeno na socialni odnos posameznika do družbe. Razstava predstavlja dela umetnikov, ki s pomočjo sodobnih medijev in v sodobnem jeziku pripovedujejo osebne zgodbe. So vizualna materializacija ideje ustvarjalca; ta nam svojo zgodbo pripoveduje kot resnični dogodek. Njegove intimne pripovedi opisujejo dogodke iz vsakdanjega življenja neke družbeno angažirane osebe, ki je osredotočena na dogodke, kjer se identiteta in kultura prepletata s prostorom, v katerem živi.

Leta 2003 sva z dr. Nadjo Zgonik, izredno profesorico za umetnostno zgodovino na ljubljanski ALUO, pripravila prvo bienalno razstavo "Çmimi Muslim Mulliqi". To je bila prva mednarodna razstava vizualne umetnosti na Kosovu. Dela za razstavo so se zbirala na javnem razpisu in jih je izbral kurator na podlagi približevanja njegovemu konceptu. Odziv umetnikov je bil ogromen, kljub temu, da je bil razpis za razstavo objavljen po dolgih letih institucionalne blokade in dve leti po osamosvojitveni vojni.

Še danes se dobro spominjam prostora Nacionalne galerije v Prištini, polne umetniških del. Takratna domača udeležba je bila velika, kar pa ni bilo mogoče reči za njeno kakovost! Kljub temu mi je množična prisotnost mladih umetnikov vlivala upanje, da bo v bodoče kakovost domače produkcije višja.

Na povabilo ravnateljice Obalnih galerij Piran Lilijane Stepančič, naj pripravim skupinsko razstavo, sem se odločil, da predstavim dela umetnikov, ki ustvarjajo na Kosovu ali imajo nekaj skupnega s to deželo. Na razstavo sem povabil umetnike, ki so se kot samostojni umetniki uveljavili po letu 2000, torej po zgoraj omenjeni razstavi v Prištini. Pričujoča razstava predstavlja umetnike, katerih delo spremljam že petnajst let. Njihova dela dobro poznam, so podlaga za moja razmišljanja o poteku in razvoju sodobne vizualne umetnosti na

Kosovu. Dela, predstavljena na razstavi, so osebne zgodbe in pripovedi umetnikov, ki so odraščali v družbi brez institucionalno organiziranega sistema umetnosti, brez finančne podpore in z majhno možnostjo pridobivanja informacij o mednarodnih dogajanjih v sodobni vizualni umetnosti. Kljub težavam pri komunikaciji z ostalim svetom niso nehali iskati možnosti za predstavitev svojih misli in so s svojimi deli prodirali na mednarodne trge, začeli so sodelovati na pomembnih razstavah, vzbudili so pozornost mednarodnih likovnih kritikov, pa tudi ljubiteljev sodobne vizualne umetnosti.

Danes so njihova dela prisotna tako v domačih kot tudi mednarodnih zbirkah, postali so nova umetniška avantgarda z zahodnega. Balkana ter del evropske in svetovne sodobne vizualne umetnosti.

V očeh večine Slovencev so Albanci slaščičarji. S tem stereotipom se je poigral slikar, tokrat kot kurator, Gani Llalloshi. Razstavo del dvajsetih sodobnih umetnikov s Kosova je naslovil A bi kaj sladkega? V piranski Mestni galeriji jo bodo odprli nocoj ob 20.30, Llalloshi pa je k sodelovanju na prvi veliki predstavitvi kosovske sodobne umetnosti v Sloveniji, povabil zlasti mlajše in angažirane umetnike.

> "Umetnost razumem kot odpiranje novih vprašanj. Poleg tega sem vajen, da z zunanjim svetom komuniciram prek paraironije oziroma parakomedije. Nenazadnje, odkar živim v Sloveniji, se mi je neštetokrat zgodilo, da me je kdo vprašal, ali ima moj stric slaščičarno. Pa sem se odločil, da naslov razstave izpeljem iz tega stereotipa," pojasni **Gani Llalloshi.**

Skupinsko predstavitev sodobnih vizualnih umetnikov in umetnic, ki prihajajo s Kosova, je pripravil na povabilo Obalnih galerij, zgodba piranske razstave pa ima korenine v Prištini, od koder je tudi sam. Leta 2003 je skupaj z dr. **Nadjo Zgonik**v Nacionalni galeriji zasnoval prvo bienalno razstavo Qmimi Muslim Mulliqi, ki je bila prva mednarodna predstavitev vizualne umetnosti na Kosovu po drugi

svetovni vojni. Poleg uveljavljenih tujih umetnikov je takrat svoja dela razstavilo tudi 20 kosovskih likovnih ustvarjalcev. Kar nekaj teh se bo predstavilo tudi na razstavi v Piranu.

"Povabil sem tiste umetnike, ki so se samostojno uveljavili po letu 2000. Te umetnike poznam, večino spremljam že zadnjih 15 let," pravi kurator in opozarja na nekaj posebnosti sodobne kosovske likovne ustvarjalnosti. V Piranu bodo na ogled dela tistih umetnikov, ki jih zanima odnos med družbo in posameznikom.

Na skupinski razstavi v Obalnih galerijah se predstavljajo Alban Muja, Alketa Ramaj, Astrit Iamaili, Alketa Xhafa Mripa, Driton Hajredini, Dren Maliqi, Elsa Martini, Eliza Hoxha, Haveit, Jakup Ferri, Jetmir Idrizi, Leunora Salihu, Lulzim Zeqiri, Mehmet Behluli, Merita Koci, Majlinda Hoxha, Nita Deda, Rudina Xhafer,Qendres Deda in Yll Citaku.

Poleg tega se mu zdi izjemno pomembno in zgovorno tudi to, da gre za umetnike, ki so odraščali in se formirali v družbi brez institucionalno organiziranega sistema umetnosti in brez finančne podpore. "Pod apartheidovskim Miloševićevim režimom se je za Albance na Kosovu sesulo vse. Inteligenca je v tistih desetih letih ustvarjala paralelne institucije. In večina umetnic in umetnikov, predstavljenih na razstavi A bi kaj sladkega?, zato nima klasične, formalne izobrazbe. Znanje so pridobivali skoraj ilegalno, na predavanjih, ki so bila v zasebnih hišah," pripoveduje Llalloshi. In dodaja, da občuduje njihovo vztrajnost, umetniško samoniklost in prodornost: "Najbolj zgovorno od vsega se mi zdi, da so ti ljudje prodrli na tuje trge. Večina ima pogodbe z galerijami po evropskih mestih, s svojo umetnostjo se preživljajo, v Prištini pa jih ne poznajo."

Za kosovske umetnike in umetnice, ki svet okrog sebe komentirajo prek različnih likovnih zvrsti - od videa, instalacij, fotografij do

slikarstva - Gani Llalloshi pravi, da so neke vrste homerji: “Ko so stopili v svet vizualne umetnosti, so bili 'slepi'. S tem hočem reči, da niso imeli vpogleda v to, kaj se dogaja v svetovni, evropski sodobni umetnosti. A njihova dela tega ne kažejo, kar dokazuje, kako resnično velik je njihov potencial in kako močna je njihova umetniška govorica.”

Dromca ne mediat shqipe

Gani Llalloshi ka thënë se përzgjedhja e artistëve është bërë duke u fokusuar në punën e tyre prej vitit 2000, ku veprat e tyre kanë zgjuar vëmendjen por edhe kanë marrë çmime ndërkombëtare

Ekspozita "A doni diçka të ëmbël?", me kurator, Gani Llaloshin do të hapet më 29 maj në Galerinë bregdetare të qytetit Piran të Sllovenisë, e cila do të qëndrojë e hapur deri më 31 gusht të këtij viti. Ekspozita "A doni diçka të ëmbël?", sipas Llalloshit në qytetin Piran do të prezantojë artin vizual bashkëkohorë nga Kosova, e cila tashmë ka tërhequr vëmendjen në forumet ndërkombëtare. Dhe pikërisht kjo ekspozitë me artistët kosovarë është edhe një përpjekje e kuratorit Gani Llalloshi që të lidhë Kosovën dhe Slloveninë, pasi që edhe jeta e tij ka një ndërlidhje mes Kosovës dhe Sllovenisë.

“Ekspozita do të prezantojë artin bashkëkohor dhe punët vizuale në teknika të ndryshme si video, fotografi, instalacion, vizatime dhe piktura. Këto vepra flasin për jetën e përditshme të njeriut dhe shoqërisë në të cilën jeton. Tregimet personale dhe ngjarjet e përditshme që përshkojnë përmbajtjen e veprave te ekspozuara nxjerrin në pah rëndësinë e individit te angazhuar ne shoqëri”, ka thënë për KultPlus, Llalloshi duke treguar më pas se përzgjedhja e artistëve në këtë ekspozitë është nga ata më të njohurit që i njeh edhe skena ndërkombëtare por edhe ata që janë më pak të njohur. Ai ka thënë se përzgjedhja është bërë duke u fokusuar në punën e artistëve prej vitit 2000, ku veprat e tyre kanë zgjuar vëmendjen por edhe kanë marrë cmime ndërkombëtare.

Krejt në fund vlerësohet se kjo ekspozitë do të bëj të mundur që sllovenët të njohin më për së afërmi me cilësinë e lartë të prodhimit të artit bashkëkohor në Kosovë.

RAMUSHI NE SLLOVENI DHE SHIA E IDHTË E NDALESËS

Ai rrugëtojë nga Gjermania, erdhi ne aeroport... e ndalën... Sllovenia u korit por edhe shteti i Kosoves nuk e kreu detyren e vet siç duhej, ne perjashtim te Amabasades se Republikes se Kosoves qe ishte ne krye te detyres.

Kjo do te ishte shia e idhtë qe mbeti pas ndalesës se Ramush Haradinajt ne Sllloveni dhe "lirimit" te tij. Ai nuk u lirua, sepse nuk degjoj qe te dal para gjyqit te ketushem. Sa qendroj ketu, per herë të parë publikisht e theu tabune e heshtjes qe ndodhe ne keso rastesh. Nje mik imi, pasi qe ndegjoj per kete ndalesë, me pershperiti "dashkan me e frigue harushen me shoshë"!

Ne fakt, ai kishte ne te kaluaren e tij dy here ballafaqime ne gjykaten e Hages dhe dy here doli i pafajshem.

Në Sllloveni strukturat ish-komuniste ende kanë ndikim në sistemin e drejtësisë

Enver Robelli

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Martin Berishaj, i cili jeton në Sllloveni ka vizituar sot liderin e AAK-së, Ramush Haradinajn. Profesor Berishaj, më herët kishte shkruar se është i mendimit që

Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës është dashur që si hap të parë ta thërras ambasadorin slloven në Prishtinë për të sqaruar këtë ngjarje, në mënyrë që të merret qëndrim serioz dhe konsistent ndaj rasteve të tilla. Berishaj kritikon reagimin zyrtar të Kosovës në rastin Haradinaj

Profesori i shkencave politike, Martin Berishaj, kritikon ndalimin e kryetarit të AAK-së, Ramush Haradinaj në Lubjanë nga autoritetet e atjeshme.

Ai, në një intervistë për DialogPlus.ch e quan këtë veprim të palës sllovene si flirt deri në vasalitet ndaj Beogradit. Por Berishaj thotë se problemet politike mes Kosovës dhe Sllovenisë nuk rregullohen me bojkotim të mallrave duke i derdhë pesë litra qumësht "alpsko" në rrugët e Prishtinës siç ndodhi pas ndalimit të Agim Çekut vite më parë. Ai kritikon heshtjen e ministrit të Jashtëm të Kosovës për këtë rast dhe reagimin e vakët të Qeverisë së Kosovës.

Si e vlerësoni veprimin e autoriteteve sllovene në rastin e ndalimit të kryetarit të AAK-së, Ramush Haradinaj, në bazë të një fletarrestimi nga Serbia?

Së pari mendoj se rasti i ndalimit të shtetasit – kështu u cilësua – Ramush Haradinaj në aeroportin e Lubjanës dhe peripecitë rreth këtij ndalimi nuk duhet shikuar assesi si rast i izoluar. Tendencën e këtij ndalimi shteti slloven deshi ta paraqesë si sprovë të "vigjilencës" juridike duke u dëshmuar si partner serioz në rrafshin ndërkombëtar, me qëllim të jetësimit në praktikën juridike sllovene të konceptit anglosakson "clean up", kur lënda duhet të përmbyllet, me ç'rast sistemi juridik duhet të veprojë në mënyrë të civilizuar karshi palës, në këtë rast karshi politikanit kosovar me pasaportë diplomatike, i cili jo më larg se një ditë më parë u prit nga autoritet gjermane.

Evidenca e debatit juridik këtu vjen e pështillet edhe më shumë pas deklaratës se Presidentit slloven Borut Pahor i cili në një mënyrë e cilësoi ndalimin më tepër si qasje politike sesa juridike – e unë do të shtoja si një "mbetje e rastësishme" e fletarrestimeve në sistemin mjaft të sofistikuar të Interpolit. Krejt kjo e iniciuar që në vitin 2004 nga shteti i cili nuk ekziston më, pra Serbia dhe Mali i Zi! Personalisht mendoj se Sllovenia me këtë ndalim të kryetarit të AAK-së tenton të "balancojë" karshi Kosovës teorinë e marrëdhënieve "tërheq e mos këput", kurse ndaj Serbisë si kurrë me parë apo shikuar nga brenda si flirt deri në rrafshin e vasalitetit ndaj saj.

A kanë qenë adekuate reagimet e shtetit të Kosovës deri më tani?

Për ta kuptuar më mirë këtë gjendje dhe pse jo edhe të nxjerrim mësim nga kjo do të ishte me rëndësi ta kthejmë mbrapshtë situatën: si do të reagonte shteti slloven nëse, për shembull, do të ishte ndaluar kreu i opozitës apo edhe ndonjë person publik slloven në Kosovë? Çka do të bënte Ministria e Punëve të Jashtme sllovene, a do të kishte reaguar ndryshe? Duke e njohur mirë këtë ministri nga brenda supozoj se ajo fillimisht, si hap të parë, do ta kishte ftuar për sqarime ambasadorin tonë, të cilit pa dyshim do t'i kishte dorëzuar së paku një notë proteste, për t'i hapur rrugë diplomacisë për ta neutralizuar gjendjen e krijuar.

Këtu, në rastin konkret, nga MPJ e Kosovës kishim heshtje. Asnjë prononcim publik të Ministrit të Punëve të Jashtme të Kosovës nuk kishim, përpos një deklarate të vaktë të Qeverisë. Unë nuk dua të paragjykoj se çka mund të ndodhë më tutje. Nuk e di se si do të reagojë opozita në Kuvend, mirëpo personalisht mendoj se së paku do të ishte e nevojshme të behej interpelancë dhe "numërim i brinjëve" të kabinetit ministror.

Para Haradinajt në Sllloveni qe ndaluar edhe Agim Çeku, po ashtu me kërkesë të Serbisë. Por ai ishte lejuar të kthehet në Kosovë. A mund të shohim të njëjtin skenar tani edhe me Haradinajn?

Ne aspektin juridik po! Mirëpo, rrethanat kur ishte ndaluar Agim Çeku po ashtu në aeroportin e Lubjanës ishin krejtësisht të ndryshme nga kjo që ka ndodhur tani me Ramush Haradinajn. Sllovenia në atë kohë ishte në prag të hyrjes në zonën Schengen dhe alibi për ndalimin e Agim Çekut ishte sprova për të treguar se sa do jenë autoritetet sllovene të pakompromis sa i përket ruajtjes së kufirit jugor të Schengenit. Kosova në atë kohe nuk kishte shpallur pavarësinë dhe përgjegjësinë për këtë ndalim nuk e kishte në atë masë sa e ka sot klasa politike e Kosovës. Përpos skenarit të njëjtë të ndalimit sot nuk mund të bëjmë krahasime të tilla, sepse Kosova është shtet i pavarur dhe mundësia për llogaridhënie do të duhej të ishte më e madhe, duke e bartur barrën e arsyes dhe jo vetëm Qeveria e Isa Mustafës.

Shefi i AAK ka zgjedhur fjalë të ashpra kundër sllovenëve në përgjithësi, duke i quajtur "vëllezër të serbëve". A mendoni se prononcime të tilla mund të komplikojnë edhe më shumë situatën në të cilën gjendet Haradinaj?

Prononcimi i Ramush Haradinajt, nëse e krahasojmë me prononcimin e Agim Çekut, ndryshon dukshëm. Çeku ishte me i ekuilibruar, në atë kohë ai ishte komandant i Trupave Mbrojtëse të Kosovës, kurse Haradinaj sot është pjesë e opozitës dhe si opozitar pesha e përgjegjësisë është më e vogël, por jo edhe e fjalës.

Kundër sistemit të drejtësisë në Sllloveni ka pasur mjaft akuza viteve të fundit. Ish-kryeministri Janez Jansha mendon se bëhet fjalë për një sistem të ndikuar ende nga strukturat e kohës së komunizmit. Në ç'gjendje është drejtësia sllovene?

Siç e dini, me rastin e burgosjes se ish-kryeministrit Janez Jansha dhe lirimit të tij pas disa muajsh, vendimi i gjykatës u rrëzua si jokushtetues nga Gjykata Kushtetuese sllovene. Aty u shpalos gjendja reale e këtij sistemi, i cili ende vuan dhe nuk mund të lirohet nga ndikimet e strukturave ish-komuniste. Debati që u hap ditë më parë këtu në Slloveni në mes të kryeministrit Miro Cerar dhe ish-kryeministrit Janez Jansha e aktualizon edhe më tepër çështjen e ikjes nga përgjegjësia të qeverisë aktuale sa u përket reformave, të cilat Sllovenia i ka filluar, por, fatkeqësisht, nuk i ka përfunduar. Natyrisht, kjo reflekton në të gjitha fushat. Nuk mund të jetë sistemi juridik i veçuar, sepse ai është një nga tri shtyllat e organizimit shtetëror. Në Slloveni ky sistem po përjeton plasaritje të mëdha. Ato plasaritje natyrisht dalin në shesh pikërisht tek kjo shtyllë e pushtetit, e cila e stigmatizon edhe ashtu qeverinë më të pavendosur që kur është themeluar ky shtet.

Para pak ditësh nëpër Slloveni ka kaluar Naser Oriqi, komandant i trupave boshnjake në Srebrenicë në vitet 90-të. Oriq u arrestua pastaj nga Zvicra – me kërkesë të Serbisë. Si është e mundur kjo, kur edhe Sllovenia, si Zvicra, ka qasje në bazën e njëjtë të të dhënave në Interpol?

Baza e njëjtë e të dhënave në Interpol nuk garanton edhe reagim të njëjtë të shteteve në përgjithësi, në këtë rast shtetit slloven. Këtë proces unë e shoh si fillim te «akomodimit» të elitave në kushte të reja karshi asaj që pritet në Kosovë rreth Gjykatës Speciale.

Në Kosovë disa militantë të AAK-së kanë bërë thirrje për bojkotim të produkteve sllovene. A mund t'i keqësojë dukshëm raportet kosovaro-sllovene ndalimi i Haradinajt?

Personalisht mendoj se jo! Për të ndërtuar mure të pakapërcyeshme është lehtë, por është urti t'i zbusim tensionet. Për këto raporte natyrisht që duhet të gjykojmë me mendje të akullt, duhet të

udhëhiqemi me urti si bindje politike për t'i tejkaluar problemet. Ato relacione duhet t'i mbajmë në vija sa më të qarta, natyrisht aty ku duhet dhe shihet si e nevojshme duhet t'i përmirësojmë ato. Sot shoqëria civile në Kosovë nuk e ka fuqinë e duhur për të ndryshuar rrënjësisht diçka që duhet medoemos të ndryshohet. Problemet politike nuk rregullohen me bojkotim të mallrave duke i derdhë pesë litra qumësht "alpsko" në rrugët e Prishtinës siç ndodhi pas ndalimit të Agim Çekut vite më parë.

Pala kosovare po zhvillon negociata me Serbinë prej vitesh në Bruksel. A është dashur, sipas mendimit tuaj, që Beogradit t'i bëhet presion të heq dorë nga përdorimi i drejtësisë për poenë politikë?

Deklarata e kryeministrit të Serbisë Aleksandar Vuçiq se "diçka e tmerrshme është duke ndodhur" qartëson këtë mjegullnajë. Padyshim, Serbia duhet të heq dorë nga e kaluara e saj. Atje nuk ka ndodhur deserbizimi ideologjik millosheviqian i përshkruar si denacifikim. Edhe pse është më se e nevojshme të ndodhë, por për këtë duhet kohë, sepse serbët nuk janë gjermanë! Serbia sot, pas negociatave me Kosovën, ka përfituar shumë më shumë sesa Kosova. Ajo po promovohet me një dinamikë të cilën unë personalisht e kam pritur. Kuptohet unë nuk kam dashur të ndodhë stagnimi ynë në këtë drejtim. Por stagnimi ka ndodhur për shkak se klasa politike që negocion nuk u prin proceseve dhe sillet me inercionin serb të kësaj dinamike. Përfitimi i poenëve politikë Serbisë dita-ditës po i sjell rezultate. Ajo duhet të heq dorë nga përdorimi i kësaj lloj "drejtësie", mirëpo ne duhet të rrisim standardet tona në këtë proces negociues. Ekipet e ekspertëve nga Kosova shpesh nuk ma mbushin mendjen dhe kjo më shqetëson në këtë proces negocimi, por jo vetëm në këtë proces. Ka një prirje te një pjesë e opinionit gjaknxehtë në Kosovë që Sllovenia të konsiderohet si vend armik. Historikisht situata paraqitet ndryshe: në shkurt të vitit 1989 në Cankarjev dom qe mbajtur tubimi i

famshëm i solidaritetit me minatorët e Trepçës, aktivistët sllovenë të të drejtave të njeriut kanë denoncuar shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë, revista Mladina ka shkruar me ton kritik mbi represionin serb në Kosovë.

Cankarjev domi ishte ndërgjegje e klasës politike sllovene karshi vetes në rend të parë, kurse mbështetje e fuqishme e tendencave tona dhe përputhje e interesave shqiptare të kohës me një aleat që po bëhej i natyrshëm për ne. Sllovenia e viteve 80-të të shekullit të kaluar ishte pragu i parë i kushtrimit shqiptar për në Evropë dhe sllovenët, si pjesë e atij pragu, na mbështetën neve shqiptarëve në synimet tona. Për freskim të kujtesës, jo për të qetësuar gjaknxehtit, do të ndalesha pak në këtë pikë. Mbështetja për minatorët e Trepçës që rezultoi me Cankarjev dom ishte jo vetëm hapi i parë i rezistencës kundër politikes së Slobodan Millosheviqit dhe dhunës që ushtrohej në Kosovë. Tërheqja e policëve sllovenë nga policia federale në Kosovë për të mos u zhytur në krime kundër shqiptarëve përcillej me mbështetje të fuqishme të mediave – në radhë të parë revistës Mlladina. Kjo hapi shtigje të një bashkëpunimi mes shqiptareve dhe sllovenëve edhe në kohën e luftës në Kosove dhe ky bashkëpunim në makrostrukturë është edhe sot i tillë. Padyshim, përgjegjësia mbetet në klasën politike e cila ballafaqohet me sfida të reja, mbetet në ndërgjegjen tonë dhe të tyre dhe kurrsesi në kokat e nxehta që nesër do të harrojnë se çka ndodhi dje.

KOMBI SHQIPATR ASNJËHERË AGRESOR

Dr. Pëllumb Qazimi

Abstract

Despite that the Albanian lands have been arena of wars, promoted and carried out by neighbours and other powers, the Albanian nation knew how to behave toward the others. Albanians have known how to defend themselves. But at the same time they new how to respect and properly treat the foreigners, the losers, the surrenders and the victims. Albanian nation and Albanians have always been prone to good neighbourly intentions and non-aggression against the others. Albanian code towards the foreigners, despite that it was not referring to any international convention, it has been similar to that applicable based on them. Albanians have been able to distinguish the aggressor from the friend, the invander from the defeted and from the surrender.

Albanians, in this respect, have shown themselves during the Balkan Wars and during the First and the Second World War. They new how to deal with defeted or armies that have passed through Albanian territory. They have extended cooperation and help to the defeted. These inherited values of Albanians, have made them to be an example to the world for the treatment made and the relationships built with Jews before and during World War II.

Hand of friendship and good neighbourliness have been natural features for Albanians, even special, which have accompanied them throughout their history. The values of religious harmony, good neighbourly relations and cooperation are still valid and have made Albanians fully engaged and commited towards the European and Euro-Atlantic integrations.

Fjalët kyçe: hebrenjtë, kanuni i Lekë Dukagjinit, kombi shqiptar, luftrat ballkanike, Lufta e Parë Botërore, Lufta e Dytë Botërore, Shqipëria, shqiptarët,

Shqiperia arenë luftrash

Gadishulli ku shtrihet Shqipëria në shekuj ka qenë arenë luftrash. Territori shqiptar gati përherë është përdorur nga aktorë të tjerë ndërluftues. Sipas Piro Mishës[1], territori shqiptar përbën një tokë mes lindjes dhe perëndimit, mes Evropës dhe Azisë, apo mes të djeshmes dhe të sotmes, një urë që lidh këto dy botë.[2] Pra, në këtë truall janë zhvilluar luftra nga fuqitë e mëdha dhe mes vendeve ballkanike, por përherë raporti ka anuar tek të parët. Në këtë kuadër, vetë Shqipëria nuk kishte si të shmangej. Përkundrazi, ka qenë arenë e truall i përshtatshëm për ndeshje ndërmjet fuqive ushtarake. Një gjë e tille natyrshëm do të kishte edhe pasoja afatgjata në ecurinë e zhvillimin e vendit.

Në shekujt e dymbëdhjetë e të trembëdhjetë në tokat shqiptare u ndeshën disa nga forcat më të mëdha të kohës. Ndërkohë, arbërit nisin të shfaqen gjithnjë e më dëndur nëpër kronika, ndonëse thuajse gjithnjë si protagonistë anësorë e dytësorë të ngjarjeve. Është një periudhë e ngjeshur, e turbullt, e ngatërruar, e mbushur me luftëra, por edhe me shkëmbime, me largime, afrime e bashkime.[3] Romakët e pas tyre bizantinët dhe më tej bullgarët e serbët përdorën për kalim apo fushë beteje territorin shqiptar. E njëjta pamje vazhdon edhe në shekujt në vijim nën perandorinë osmane. Nën këtë të fundit trojet shqiptare emërtohen si tokë e zgjedhur për

---

[1] *Studjues shqiptar*

[2] *Misha, Piro, Duke kërkuar Rrënjët ose... Kthimi i Shqiptarëve në Histori, f. 14*

[3] *Po aty, f.15*

trazira dhe kryengritje.[4] Këto troje në historinë e tyre kanë ofruar vetëm një varg të gjatë rebelimesh kundër qeverisjes së sulltanëve. E veçantë për nga mënyra e organizimit dhe e realizimit është periudha e Skëndërbeut. Edith Durham pohon se në trojet e veta Skëndërbeu nuk u thye kurrë. Dy sulltanë me radhë u betuan se do ta zhduknin rebelin shqiptar nga faqja e dheut.[5] Ushtri të mëdha u angazhuan kundër tij, por pa sukses. Sa jetoi Skënderbeu, Shqipëria qe e lirë. Sipas autores, turqit u ndihmuan vetëm nga vdekja e Skënderbeut më 1468.[6] Por me vlera jo të vogla paraqitet edhe periudha e Ali Pashë Tepelenës, i cili gjatë sundimit të tij më tepër ndeshej ushtarakisht dhe jo ushtarakisht me Portën e Lartë, sesa plotësonte detyrimet ndaj saj. Më tepër mashtronte se sa bashkëpunonte për paqe, më tepër mendonte se si do të krijonte aleanca, por nuk harronte të vendoste se kur do t'i prishte ato, për të filluar të reja.

Trojet shqiptare vazhduan të ishin arenë betejash e përpjekjesh luftarake deri në fund të shekullit XIX e të fillimit të shekullit XX duke kulmuar me Lidhjen e Prizrenit dhe me kryengritjet shqiptare të asaj periudhe. Në vitin 1912 shpërtheu lufta e Parë Ballkanike e më tej e dyta. Në këtë kohë Shqipëria shpalli pavarësinë. Prania osmane në territorin shqiptar shënoi fundin e ekzistencës pesë shekullore. Gjatë Luftës së Parë Botërore Shqipëria ishte përcaktuar neutrale, por territori i saj u shndërrua në fushë betejë për vende e fuqi të tjera. Më parë ishte provuar prania ushtarake e fqinjëve. Megjithë neutralitetin e Shqipërisë, pjesë të vendit u pushtuan nga trupa të huaja.[7] Pas largimit të princ Vidit nga Shqipëria në shtator

---

[4] *"Ushtritë otomane hynin me kujdes të madh në ato vende fizikisht torturues, të krijuara për guerilas, të banuara nga popullsi gjysmë të egra, pjesëtarët e së cilës, që në fëmini janë ushtruar në artin e luftës partizane e që jeta e vet iu dhimbset aq pak, sa edhe e të tjerëve". Shih: Remerand, Gabriel, Pashai Janinës, f.22*

[5] *Durham, Edith, Brenga e Ballkanit, dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe Shqiptarët, f. 21*

[6] *Po aty, f.21*

[7] *Samer, Haroey, Rescue in Albania-One hundred percent of Jews in Albania rescued from Holocaust, f. 25*

1914, territori shqiptar u bë fushë beteje për fqinjët dhe objekt këmbimi për fuqitë e mëdha. Greqia u lejua të pushtonte Korçën dhe Gjirokastrën, Italia do të merrte portin e Vlorës dhe ishullin e Sazanit. Në të njëjtën kohë serbët dhe malazezët do të përparonin deri në Shkodër, Tiranë, dhe Elbasan. Në të vërtetë kjo do të thoshte mosekzistencë e atij shteti që vetëm më pak se tre vite më parë pati shpallur pavarësinë. Disfata e serbëve në vitin 1915 solli zëvendësimin e tyre me pushtimin austo-hungarez, i cili u shtri deri në Shkodër, Durrës e lumin Vjosë. Ndërkohë në Vlorë vazhdonin të ishin italianët. Në të njëjtën periudhë, anglo-francezët duke qenë në konflikt me mbretin Kostandin të Greqisë, ua besuan trupave italiane pushtimin e krahinës të Gjirokastrës e madje edhe të Janinës, dhënë Greqisë në vitin 1913. Në të njëjtën periudhë trupat franceze arritën të drejtoheshin drejt Korçës, duke e marë atë në tetor 1916.[8] Në fund të vitit 1916, Shqipëria përveç se arenë lufte, ishte pre e pushtimit, duke u shndëruar realisht në vend i pushtuar. Historiani Schmidt-Neke arrin në përfundimin se "Shqipëria nuk mund të ishte si shtet palë ndërluftuese, sepse nuk kishte shtet shqiptar. Shqipëria qe territor i pushtuar nga austriakët, serbët, malazezët, grekët, francezët, bullgarët, italianët dhe secili prej tyre kishte aleatët e vet shqiptarë. Kushtet e vitit 2013 u rikthyen edhe më me forcë."[9]

Në periudhën pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Shqipëria përsëri mbeti teatër i pranisë ushtarake të huaj dhe objekt pushtimi. Nga shtatori i vitit 1918, me përjashtim të krahinës së Korçës dhe qytetit të Shkodrës, Shqipëria mbeti nën kontrollin e ushtrisë italiane, sepse vendi duhej të mbahej nga trupat aleate deri sa të merrej vendimi përkatës nga Konferenca e Paqes. Në këtë situatë, serbët përfituan duke pushtuar Shkodrën. Por kjo nuk zgjati shumë, pasi prania e tyre u zëvendësua nga trupa ushtarake franceze, britanike dhe italiane.[10] Largimi i italianëve nga Shqipëria u

---

[8] Castellan, Georges, Histori e Ballkanit, f. 450

[9] Gazeta Shekulli, datë 15.02.2014, Intervistë e DW me historianin Michael Schmidt-Neke

[10] Duka, Valentina, Histori e Shqipërisë, 1912-2000, f.100

realizua vetëm në vitin 1920 dhe pas luftimeve të shqiptarëve të emërtuara si Lufta e Vlorës. Kjo gjendje vazhdoi deri në traktatin e paqes. Do të duheshin përpjekje dhe mbështetje që orekset e vazhduara të Italisë, Greqisë, Jugosllavisë të frenoheshin. Vetëm në pranverën e vitit 1920 u realizua rivendosja e shtetit shqiptar në kufijtë e njohur të vitit 1913.

Edhe pas vitit 1920, Shqipëria ishte objektiv i të tjerëve për marrje territoresh. Pas nje pauze, jo vetëm për arsye të pushtimit fashist të vendit në muajin prill 1939, por edhe tetori i vitit 1940 e prezanton përsëri Shqipërinë arenë lufte. Territori shqiptar u shndërrua në teatër lufte. Italia përmes territorit shqiptar kaloi në agresion kundër Greqisë. Për italianët, territori shqiptar i pushtuar prej tyre, konsiderohej i përshtatshëm për të kaluar në agresion kundër Greqisë, pavarësisht nga natyra malore e shkëmborre e terrenit shqiptar. Data 28 tetor 1940 shënon fillimin e agresionit, por brenda një periudhe shume të shkurtër forcat greke mundën t'i smprapsin trupat ushtarake italiane. Këto të fundit vepruan mandej brenda territorit shqiptar. Në këtë mënyrë pjesa dërmuese e Shqipërisë së Jugut u kthye në teatër të luftimeve mes dy vendeve të tjerë, Italisë dhe Greqisë.

"Për të mirën dhe të këqen e tyre" shqiptarët asnjëherë në historinë e tyre nuk janë prirur nga synime agresive, pushtuese. Ata kanë qenë të prirur për paqe e marrëdhënie të mira me fqinjët. Nga ana tjetër ata kanë reaguar dhe janë përgjigjur ushtarakisht ndaj çdo veprimi ose ndërmarrje të armatosur kundër tyre.

Në kushtet kur mbreti Zog u largua nga vendi, kur uniteti i kombit ishte lëkundur jashtëzakonisht, shqiptarët e pritën me armë pushtimin fashist. Periudha e mëvonëshme, d.m.th. pas datës 7 prill 1939 nuk evidentoi kundërshtime të strukturave ushtarake zyrtare shqiptare. Për më tepër, pushtuesi në qershorin e 1939-ës likujdoi si strukturat e shërbimit të jashtëm, ashtu edhe të ministrisë së brendëshme dhe të forcave të armatosura.[11] Tashmë ato ishin të

[11] *Po aty, f. 211*

përfshira në strukturat fashiste italiane. E gjithë periudha e Luftës së Dytë Botërore për shqiptarët karakterizohet nga kundërshtimi popullor i pushtimit fashist dhe më vonë nazist. Lëvizja shqiptare erdhi duke u rritur, konsoliduar dhe materializuar përmes krijimit dhe veprimtarisë luftarake të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, deri në çlirimin e plotë të vendit.

Shqiptarët nuk vrasin të pafajshmit, të dorëzuarit, të mundurit dhe viktimat

Ismail Kadare trajton me shumë realizëm Kanunin e Lekë Dukagjinit. "Ky kod, ligji themeltar i shqiptarëve gjatë shumë shekujve, ka vërtet një ftohtësi e ashpërsi tragjike, por edhe ky kod primitiv e i kritikueshëm fort, në bazën e tij, në pjesë themelore, atë që përcakton 'Rregullat e vdekjes', përjashton në mënyrë absolute masakrën dhe gjymtimin. Ligji i parë i kësaj pjese është që në çdo grindje, në çdo hakmarrje, secila palë në konflikt, sado i rëndë të jetë ai, ka të drejtë vetëm për një vdekje. Ligji i dytë themelor është që vrasja mund të bëhet vetëm në distancë dhe trupi i viktimës nuk mund të preket kurrsesi.[12] Kadare vijon më tej duke u shprehur i zemëruar e i revoltuar që pavarësisht nga ç'ka treguar historia ndaj shqiptarëve, kjo meritë e shqiptarëve duhet njohur e vlerësuar, nuk mund të neglizhohet. Sipas tij, qëndrimi mosnjohës e injorues ndaj kësaj vlere nuk është më pak se mizori. Pjesë themelore e kodit shqiptar është qëndrimi ndaj të huajit, të panjohurit, të ardhurit nga vend tjetër, pra bujtësit. Mbrojtja e tij është, sipas kodit, detyra e parë morale e njeriut shqiptar. Ky përcaktim është shprehur qartazi në rrjedhat e historisë së shqiptarëve në marrëdhënie me të tjerët, qofshin fqinjë, por edhe të largët. Sidomos kjo ka gjetur reflektim në ato periudha të historisë ku shqiptarët janë ballafaquar ushtarakisht me të tjerët. Ata kanë ditur që pavarësisht nga mungesa e shkollimit, apo kodeve përcaktues të të sjellurit në luftë, të ndanin e dallonin luftëtarin në betejë nga

---

[12] Lani, Remzi, Mustafaj, Besnik, Misha, Piro, Lufta kundër Luftës (artikull i Ismail Kadare), f.11

luftëtarin e mundur, luftëtarin veprues si vrasës nga luftëtarin e dorëzuar e të mundur, luftëtarin e huaj agresor nga viktima e kështu me radhë. Kjo është realizuar si me bindje e përgjegjësi, ashtu dhe me natyrë njerëzore e veprime praktike.

Shembujt për Shqipërinë e shqiptarët janë të shumtë. Historia na ofron pasuri të vyer në këtë drejtim. Në periudhën e luftrave ballkanike, Shqipëria përveç se arenë lufte, ku ushtritë e tjera, përfshi të vendeve fqinjë, kaluan dhe përdorën territorin shqiptar si teatër veprimesh luftarake, nuk u ndalën edhe para dëmeve shkaktuar shqiptarëve, duke patur synim të aktualizojnë edhe pretendimet e tyre territoriale. Por, referuar dokumenteve apo dëshmive nga të huajt që ndodheshin në atë kohë në Shqipëri "..., shqiptarët, edhe në këto kushte, kanë bërë më shumë se ç'mund të pritej prej tyre. Megjithëse në vend kishte zi buke, ata ndihmuan ushtrinë serbe kur ajo u tërhoq nëpër territorin e Shqipërisë.[13] Sipas Haris Silajxhic autor i librit "Shqipëria dhe SHBA në Arkivat e Washingtonit", referuar deklarimeve të bëra nga Erickson[14], dëshmitar ngjarjesh të asaj periudhe në Shqipëri, bën të ditur se ai, pra Erikson, ka jetuar disa vite mes shqiptarëve së bashku me familjen dhe për këtë arsye ka të drejtë dhe e ndjen si detyrë të thotë të vërtetën: "Ata, shqiptarët, janë inteligjentë, fisnikë, punëtorë, e duan jetën familjare, seriozë, mikpritës,.. besnikë deri në vdekje. Të tillë popull kam njohur unë..."[15] Sipas misionarit amerikan në periudhën e luftrave ballkanike, me ndihmën e shqiptarëve, tragjedia e ushtrisë serbe mund të mënjanohej. Te shqiptarët gjen virtyte, të cilat do të ishin të dëshirueshme për shumë popuj të përparuar. Por që propaganda sistematike e asaj kohe i paraqiste shqiptarët armiq të qytetërimit.[16]

---

[13] Silajxhic, Haris, Shqipëria dhe SHBA në Arkivat e Washingtonit, f. 99

[14] C. T. Erikson, misionar amerikan në Shqipëri prej vitit 1908 deri në pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste

[15] Silajxhic, Haris, Shqipëria dhe SHBA në Arkivat e Washingtonit, f. 99

[16] Po aty, f. 99

Shqiptarët, më tepër për arsye të natyrës së tyre humane kanë ditur të përcaktojnë rregulla të sjelljes në luftë. Ata kanë ditur të përcaktojnë rregulla për t'u zbatuar, të cilat kanë qenë në përputhje me rregullat e përfshira në konventa të ndryshme ndërkombëtare. Në kryengritjen e përgatitur në Kosovë në vitin 1919, Komiteti i Kosovës përgatiti programin e përgjithshëm të kryengritjes të Kosovës, ku ndër të tjera bëhet fjalë se: asnjë kryengritës nuk guxon t'i dëmtojë shkiet e vendit veç atyre që qëndrojnë me armë në dorë kundër qëllimit shqiptar; asnjë kryengritës nuk guxon të djegë shtëpia, të rrënojë kisha e gjera të tjera; plaçka është jasyk (e ndaluar) e kryengritjes; asnjë kryengritës nuk guxon të bëjë ndonjë shëmtim mbi trupat e të vrarëve të armikut, as t' zhvesh ata armiq që vdesin a plagosen, ose që zihen robër.[17]

Vlerat e shqiptarëve evidentohen edhe me përfundimin e Luftës së Vlorës në vitin 1920. Dëshmitë italiane[18] bëjnë të njohur se trupat e mundura italiane janë shoqëruar deri sa të hipnin nëpër anije e të niseshin drejt Italisë. Autoritetet shqiptare e kanë bërë këtë duke respektuar kodin e tyre njerëzor e të sjelljes ndaj të mundurit e të dorëzuarit.

Gjatë luftës Italo-Greke, grekët ishin në dyshim ndaj trupave ushtarake të atëhershme shqiptare nëse ato do të bashkoheshin me ta kundër italianëve.[19] Por, e vërteta ishte krejt ndryshe. Batalionet shqiptare që ishin inkuadruar në ushtrinë italiane, dezertuan dhe nuk pranuan të luftonin kundër grekëve. Referuar dukumenteve të arkivuar në zyrën e shtabit të përgjithshëm të ushtrisë italiane mund të gjendet evidencë e bollëshme e qëndrimit të shqiptarëve, efektivë të batalioneve shqiptare të inkuadruar në njësitë ushtarake italiane, qëndrim i cili nuk ka qenë në një linjë me atë italian. Në dokumentin e datës 11 nëntor 1940 të komandës të divizionit 83 të këmbësorisë

---

[17] Tahiri, Bedri, Hasan Prishtina-Truri i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, f. 107-108

[18] Jakomoni, Francesko, Politika e Italisë në Shqipëri, f. 133

[19] Samer, Haroey, Rescue in Albania.., f.5

malore "Ferrara" drejtuar komandës së korparmatës "C",[20] ndër të tjera bëhet e ditur se nga trupat shqiptare ka braktisje kolektive të frontit të luftës, të cilat lënë shumë për të dëshiruar. Në batalionin shqiptar "Dajti" verifikohen dezertime masive në bllok prej 30-50 vetë. Në momentin e përgatitjes së raportit, dy kompani shqiptare braktisin frontin. E njëjta situatë ndodh edhe me batalionin tjetër shqiptar "Gramozi", ku një ditë më parë është realizuar largim në masë i shqiptarëve, aq sa komandanti i regjimentit italian arrin të grumbullojë pak më shumë se 200 vetë, ndërkohë që efektivi i batalionit eshte 3-4 herë më i madh. Janë këto fakte që e detyrojnë komandantin italian të kërkoj te eprori mos përfshirrjen e trupave shqiptare në operacion. Gjithashtu, evidentohet se ka mungesë ndërlidhje mes batalioneve shqiptare me repartet italiane në vijën e frontit. Në batalionin "Dajti" ka mungesa organike, pasi në masë ka dezertime, apo edhe kalime në anën e grekëve. Këto janë njoftime të oficerëve shqiptarë drejtuar eprorëve italianë.[21] Të gjithë këto fakte të evidentuara janë vetëm brenda dy javëve të para të agresionit italian kundër Greqisë.

Qëndrimi kundër agresionit nuk u shpreh vetëm nga ushtarakët shqiptarë të rreshtuar në radhët e ushtrisë italiane. Opinioni publik shqiptar gjithashtu ka qenë kundërshtues. "... Një fakt akoma më i rëndë, asnjë student universitar shqiptar nuk ka kërkuar që të shkojë në luftë, përkundrazi është vënë re që, në muajin nëntor, një lloj shpejtësie e gjithë studentëve për t'u nisur në Itali... Ky fenomen shfaqet akoma më preokupant kur mendohet se, në verë, gjatë një fushate të organizuar qëllimshëm nga partia (lexo fashiste) për studentët universitarë, janë manifestuar propozime shumë nacionaliste dhe irredentiste",[22] dëshmojnë dokumentet e asaj kohe.

---

[20] Crociani, Piero, Shqiptarët në Forcat e Armatosura Italiane (1939-1943), f. 234-235 – Dokumenti 8. D.S.B.203, Komanda e divizionit 83 të këmbësorisë Malore "Ferrara", Nr.Prot. 394/g, datë 11 nëntor 1940 – XiX, Objekti: batalionet shqiptare, drejtuar: Komandës të Korparmatës "C", nga Komandanti gjeneral L. Zannini

[21] Po aty, f. 236, - dokumenti arkivor Nr.9, H5b.53

[22] Po aty, f. 249 – dokumenti 12, Tiranë, më 18 dhjetor 1940, letër drejtuar Inspektorit të PNF (Partia Kombëtare Fashiste) në Shqipëri

Më tej, bëhet e ditur se shqiptarët mbanin qëndrim kundërshtues për luftën kundër Greqisë sepse: "... kjo luftë nuk ishte lufta e tyre dhe nuk duhet që të marrin pjesë, pasi një patriot i vërtet ka për detyrë që të përfitojë nga të gjitha rrethanat për t'i bërë mirë dhe zmadhuar vendin e tyre, por ky nuk është një rast historik që mund të shfrytëzojnë shqiptarët."[23] Qëndrimi i cituar i referohet shqiptarëve përmes raportit që bëhet për drejtuesit e partisë fashiste italiane. Përveç qëndrimit kundërshtues ndaj kësaj lufte, shqiptarët i shmangen lojës italiane që përmes agresionit kundër Greqisë do të mundësohej bashkimi me Çamërinë.

Gjatë Luftës Italo-Greke, megjithëse popullsia e krahinave të Jugut të Shqipërisë i kishte ende të freskëta në kujtesën e vet masakrat çnjerrëzore të ushtrisë dhe banditëve grekë në vitet 1913-1914, strehoi, ushqeu dhe mjekoi ushtarakët grekë që vepronin në territorin shqiptar."[24]

Shqipëria u bë vend i rrallë në Evropë që nuk u dorëzoi gjermanëve asnjë hebre gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kur hebrejtë e kuptuan se çdo të thosh për shqiptarët trajtimi i të huajit, të pafajshmit, të dëbuarit, të viktimës, vërshuan nga çdo anë për të kërkuar ndihmë te shqiptarët. Në fund të Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria ishte i vetmi vend në Evropë, që në fund të luftës kishte numër më të madh hebrenjsh se para fillimit të saj. Domethënës është fakti se asnjë hebre nuk u dorëzua, apo ekspozua të tjerëve. Po kështu, asnjë hebre, jo vetëm ata që kishin shtetësinë shqiptare, por edhe ata të ardhur nga Austria, Gjermania dhe vendet fqinje nuk patën fat të ndryshëm. Të gjithë u konsideruan njëlloj.[25] Prania e hebrenjve në

---

[23] Po aty, f. 250 – dokumenti i arkivuar Nr.12, Tiranë, më 18 dhjetor 1940

[24] Kotani, Apostol, Shqiptarët dhe Hebrenjtë në Shekuj, f. 78

[25] Gjatë pushtimit nazist në Shqipëri, një shqiptar i qytetit të Krujës strehoi 10 hebrenj në shtëpinë e vet. Kur nazistët ju afruan shtëpisë së tij, ai i dërgoi hebrenjtë të fshihen në çati. Hebrenjtë e frikësuar pyetën se cfarë do të ndodhte nëse shtëpisë i vihej zjarri. Atëherë shqiptari dërgoi djalin e tij të fshihej bashkë me ta. Ky shqiptar i thjeshtë dëshmoi, ashtu si shumë e shumë të tjerë, për vlerën e institucionit unik të besës, këtë kod të lashtë shpirtëror shqiptar të mikpritjes ndaj miqve apo njerëzve në nevojë, si gjënë më të shtrenjtë që ai kishte. Shih: Topi

trojet shqiptare është shumë e hershme, që para dy mijë vjetësh.[26] Ndërkohë, sipas Apostol Kotanit,[27] legjendat flasin edhe për marrëdhënie mes hebrenjve dhe ilirëve që në lashtësi. Autori trajton me detaje lidhjet mes shqiptarëve dhe hebrenjve, të cilat kanë njohur vijimësi, intensitet, dashamirësi, ndihmë reciproke, duke ardhur deri në ditët tona. Hebrenjtë kanë qenë të pranishëm jo vetëm në marrëdhënie tregëtare, apo biznese të ndryshme por edhe në angazhime të tjera.[28] Në vend të shërbimit ushtarak në ushtrinë osmane, ata paguanin një taksë për mos kryerje të tij. Por ata me dëshirë pranonin të rreshtoheshin në ushtri shqiptare,[29] pavarësisht se ajo ishte pjesë e ushtrisë osmane. Dëshmi të qarta ekzistojnë për ushtrinë e Ali Pashë Tepelenës, ku hebrenjtë kanë qenë të përfshirë.

Në veçanti mund të flitet për atë çka shqiptarët kanë ofruar për hebrenjtë sidomos për periudhën para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Diplomacia shqiptare, pavarësisht se jo me përvojën e vendeve të tjera, edhe në vitin 1934 pat ndërhyrë te komisari i lartë i Lidhjes së Kombeve për refugjatët për dërgimin dhe vendosjen në Shqipëri të një pjese hebrenjsh të përzënë nga nazistët.[30] Referuar vitit 1938, pra pragut të Luftës së Dytë Botërore, ndërkohë që hebrenjtë e Gjermanisë apo të Austrisë po fillonin të strehoeshin në

Bamir, Fjala e Presidentit në Konferencën Ndërkombëtare "Përballja me të nesërmen", Jerusalem, 13 maj 2008

[26] *Mordechai Arbell, Konferenca Ndërkombëtare për Hebrenjtë, Tiranë, 21-22.05.2008*

[27] *Apostol Kotani është autori i librit Shqiptarët dhe Hebrenjtë në Shekuj, në të cilin trajtohen me hollësi marrëdhëniet mes tyre, të cilat sipas autorit janë të lashta, kanë njohur ecuri të vazhdueshme dhe kanë shprehur karakteriatika nga më të mirat të dy popujve. Në librin e tij trajtohen lidhjet në këndvështrimin historik, duke nxjerrë në pah edhe të vecanta në periudha të caktuara historike, vecanërisht gjatë Luftës së Dytë Botërore. Libri jep një pasqyrë të qartë se çfarë u kanë ofruar shqiptarët hebrenjve për t'i mbrojtur ata nga nazizmi, duke prezantuar kështu qytetari e dashamirësi, që vështirë se gjendet në raste të tjerë.*

[28] *Samer, Haroey, Rescue in Albania..., f. 23*

[29] *Po aty, f. 23*

[30] *Asllan, Uran, Prof. Dr., Diplomacia dhe Diplomatët shqiptarë 1912-1944, f. 138*

Shqipëri, ambasadori amerikan Bernshtajn (Bernstein) shkruante: "Në Shqipëri nuk ka gjurmë diskriminimi kundër çifutëve, sepse është një nga vendet e rralla të Evropës ku nuk ka as paragjykime, as urrejtje fetare."[31] Ajo që bëri Shqipëria dhe shqiptarët për hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore pati trajtim të veçantë në një Konferencë Ndërkombëtare në Tiranë në datat 20-21 maj 2008. Gjatë konferencës Mordechai Arbell, Kryetar i Kongresit Botëror të Hebrenjve do të theksonte: "Shpëtimi heroik i hebrenjve në Shqipëri është shumë i veçantë."[32] Dhe më tej: "Hebrenjtë janë mbrojtur në Shqipëri për pothuajse 2,000 vjet. Jeta e veçantë harmonike mes besimeve fetare në këtë vend duhet të jetë shembull për botën.[33] Në këtë mënyrë Shqipëria u shndërrua në parajsë të vërtetë për hebrenjtë që ndiqeshin e vriteshin kudo në atë periudhë. Gjithë këto fakte nuk kanë qenë theksuar më parë, nuk kanë qenë njohur e vlerësuar. Dhe kjo për arsye të izolimit të gjatë komunist të vendit.

A ishte e njëjtë situata e hebrenjve nëpër vende të tjerë? Kurrsesi. Hebrenjtë që banonin në Janinë apo në Korfuz patën ndërtuar e vijuar kontakte e lidhje me hebrenjtë në qytete shqiptare. Por ajo që ndodhi gjatë holokaustit tregoi se komuniteti i hebrenjve në Korfuz u zhduk, ndërkohë që në Janinë vetëm një numër i vogël hebrenjsh arriti të mbijetonte.[34] Madje qeveria shqiptare e asaj periudhe ishte e gatshme për të pranuar hebrenj nga vende të tjerë. Italiani Francesko Jakomoni, dëshmitar i ngjarjeve, pasi ishte mëkëmbës i mbretit Viktor Emanueli gjatë pushtimit fashist në Shqipëri[35] thekson vlerat e larta qytetare, mikpritëse e njerëzore të

---

[31] Metais, Serge, Histori e Shqiptarëve-Nga Ilirët deri te Pavarësia e Kosovës, f. 323

[32] Konferenca Ndërkombëtare për Hebrenjtë, Tiranë 21,22.05.2008

[33] Po aty

[34] Samer, Haroey, Rescue in Albania.., f. 12

[35] Sipas Francesko Jokomonit, kur Kryeministrit të qeverisë shqiptare Mustafa Kruja i kishte vajtur konsulli i Përgjithshëm i Gjermanisë dhe i kishte paraqitur një notë verbale, me anë të së cilës qeveria naziste kërkonte dorëzimin e 300 çifutëve, të ardhur nga Jugosllavia, ai nuk u tregua entusiast për përgjigje pozitive. Ndërkohë, komanda ushtarake gjermane e Beogradit, kishte njoftime të sakta për emrat dhe për vendet ku ishin strehuar në Kosovën shqiptare. Mustafa Kruja i kërkon

shqiptarëve ndaj hebrenjve. Këto vlera ai nuk i evidenton vetëm për qytetarët e thjeshtë, por edhe për qeveritë shqiptare të asaj periudhe, pavarësisht se ato ishin të shkrira me pushtuesin fashist. Të sillet në vëmendje që ai ishte autoritet dhe përfaqësues i lartë i vendit pushtues, i cili qëndronte në krahë të Gjermanisë naziste, e cila e kishte në filozofinë e saj zhdukjen e hebrenjve. Interesante është dëshmia, se kur mbreti Zog ishte në Britaninë e Madhe pas largimit me pushtimin e Shqipërisë nga Italia, ai i propozoi një plan udhëheqjes britanike për të vendosur hebrenj në Shqipëri.[36]

Të gjithë faktorët shqiptarë kanë vepruar me dashamirësi e përkujdesje ndaj hebrenjve, duke marrë përsipër edhe rrezikun. Ky shembull është plotësisht i admirueshëm dhe tregon vlerat civilizuese të shqiptarëve e të Shqipërisë. Kjo evidencë përbën një fakt shumë domethënës. Nuk duhet harruar se para fillimit të Luftës së Dytë Botërore nazistët do të deklaronin: "Sot Gjermania na përket ne, nesër e gjithë bota" dhe në synimet e tyre do të përcaktohej: "luftë në

mëkëmbësit të mbretit, pra autorit të librit, që hebrenjtë të mos prekeshin fare në Shqipëri. Në atë periudhë nuk kishte asnjë ushtar gjerman që mund t'i zbulonte. Kështu, në bashkëpunim me palën italiane, u duk më e përshtatëshme që çifutët mërgimtarë të dërgoheshin menjëherë në zonën e Gjirokastrës, që kufizohej me zonën greke dhe ishte nën pushtimin italian, ashtu si e gjithë Shqipëria. Këta hebrenj u pajisën me pasaporta shqiptare, me emër të rremë. Të gjitha këto masa i dhanë mundësi Mustafa Krujës që t'i përgjigjej pas disa ditësh konsullit të Përgjithshëm të Gjermanisë, se të gjitha hetimet që ishin bërë në Kosovë për emrat që ishin vënë në listë, kishin përfunduar të kota. Nga ana tjetër edhe pala italiane u tregua tolerante në këtë drejtim dhe nuk ndoqi qorrazi linjën naziste. Shih: Jakomoni, Francesko, Politika e Italisë në Shqipëri, f.304.

[36] Plani nënkuptonte vendosjen e 50,000 familje hebrenjsh në Shqipëri. Ahmet Zogu përshkroi Shqipërinë si një vend shumë të pasur me njerëz të varfër. Vendi kishte një popullsi prej një milion dhe mund të absorbonte një popullsi prej pesë milion. Ai propozoi që për çdo nga 50 mijë familjet hebreje të ofrohej tokë bujqësore, e cila ishte pronë shtetërore. Bordi i Deputetëve britanikë e mori seriozisht propozimin, por jo Ministria e Jashtme (British Foreign Office). Kjo e fundit dyshonte se mbreti Zog do të rikrijonte monarkinë pas Luftës së Dytë Botërore. Shih: Samer, Haroey, Rescue in Albania, f. 13

shkallë botërore; ideologji raciste përmes të cilës hebrenjtë duhet të eliminohen."[37] Për më tepër, duhet marrë parasysh fakti i një shteti tepër të brishtë shqiptar dhe i një populli të vuajtur dhe pa mundësi për të patur një emër përballë të tjerëve dhe aq më pak përballë nazizmit. Por në fund mund të thuhet se ndaj hebrenjve Shqipëria e shqiptarët treguan vlera të larta civilizuese, të pashëmbullta dhe për t'u patur zili edhe nga kombet e qytetëruara.

Shifra e hebrenjve në Shqipëri, ofruar nga studimet e Prof. Shaban Sinanit, është 2265. Kërkimet e autorit saktësojnë se 2265 persona kanë qenë të shenjuar zyrtarisht në regjistrat dhe shkresat e autoriteteve të shtetit shqiptar në periudhën 1930-1944. Kopje të dokumenteve të arkivave të shtetit shqiptar i janë dorëzuar nga studjuesi Shaban Sinani autoriteteve të "Memorial Museum of Holocaust" në SHBA. Sipas autorit, numri i hebrenjve rezidentë në Shqipëri vlerësohet rreth 200. Kjo shifër rezulton duke u nisur nga të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, të kryer nga viti 1929 deri në vitin 1931. Në këtë regjistrim hebrenjtë patën fituar të drejtën e deklarimit të tyre si bashkësi fetare dhe etnike. Mendohet se numri i hebrenjve të shpëtuar gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri ka qenë më i madh. Pra më shumë se 2265. Shumë prej tyre, të ardhur nga vende të tjerë, nuk janë regjistruar. Ata janë pajisur me dokumente identiteti false, ose kanë hyrë në Shqipëri në mënyrë të fshehtë.[38] Profesor Shaban Sinani vë në dyshim edhe tezën se në Kosovë me hebrenjtë është vepruar ndryshe, se atje shumica e tyre janë dorëzuar e asgjësuar nëpër kampe, etj. Referuar dokumenteve, ai thekson se edhe atje, pra në Kosovë, shqiptarët kanë qenë të njejtë ndaj hebrenjve, i kanë mbrojtur, shpëtuar e ndihmuar ata, sidomos për të kaluar drejt Shqipërisë shtetërore.[39] Më tej, duke mbrojtur këtë

---

[37] Gitman, Esther, Historian, New York, Dr. Aloysius Stepinac, Archbishop of Zagreb, under the lens of historians and diplomats (1941-1945), International Conference, September 19, 2008

[38] Sinani, Shaban, Hebrenjtë në Shqipëri, Prania dhe Shpëtimi, f. 448

[39] Po aty, 83-87

pohim, ai ndërkohë lë të hapur rrugën për studim dokumentesh arkivorë e përcaktime më të plota.

Numri i hebrenjve të shpëtuar në Shqipëri, ku asnjë i vrarë dhe asnjë i dorëzuar është tepër e vogël para shifrës 6 milionë hebrenj, të vegjël e të mëdhenj, meshkuj e femra të vrarë gjatë Luftës së Dytë Botërore në të gjithë botën. Por, krahasuar me numrin e popullsisë e të territorit të Shqipërisë dhe me kushtet e vendit në atë kohë, shpreh shumë. Në Shqipëri, ashtu si në Danimarkë, nuk ndodhi ajo që ndodhi në vendet e tjera.[40] Duke ju referuar disa vendeve të Ballkanit situata e qëndrimi ndaj hebrenjve paraqitet ndryshe. Në shtator 1941 në Rumani fillon dëbimi i më shumë së 100 mijë hebrenjve për në Transnistria, mes të cilëve një pjesë e madhe vdiqën për shkak të kushteve të këqija të jetesës.[41] Deri në fund të verës të vitit 1942, forcat pushtuese gjermane "zgjidhin problemin hebre" në Serbi, duke vrarë pothuajse 90 përqind të popullsisë çifute.[42] Në

---

[40] *Në Gjermani nga 5 milionë hebrenjtë që ishin në vitin 1933, në mbarim të luftës mbetën gjallë vetëm 15 mijë; në Austri u vranë 61 mijë hebrenj; në Poloni u vranë 2 milionë e 900 mijë; në Belgjikë nga 43 mijë mbetën gjallë vetëm 515 hebrenj; në Hollandë u shfarosën 90 mijë hebrenj; në Bashkimin Sovjetik, në pjesën e pushtuar nga nazistët u shfarosën 720 mijë hebrenj; në Itali nga të 15 mijë hebrenjtë që u dërguan në kampet e përqëndrimit, vetëm 610 shpëtuan; në Greqi nga 69 mijë hebrenj që ishin para lufte, vetëm 7 mijë shpëtuan; në Bullgari nga të 48 mijë hebrenjtë që ishin, vetëm 7 mijë vetë u kapën drejtpërsëdrejti nga nazistët dhe u vranë, ndërsa të tjerët shpëtuan sepse nga njëra anë i mbrojti populli e nga ana tjetër shtatmadhoria e ushtrisë bullgare nuk pranoi urdhrat naziste dhe nuk i dorëzoi; në Jugosllavi nga të 75 mijë hebrenjtë që banonin aty, u shfarosën mëse 80% e tyre; të 50 mijë izraelitët që banonin në Maqedoni u internuan në Auscwitz dhe u shfarosën të gjithë; sipas deponimeve të Wislicenit në gjyqin e Nurembergut edhe të 35 mijë hebrenjtë e Sllovakisë në pranverën e vitit 1942 u internuan në Lindje dhe u sfarosën; në qytetin e Rigës nga afro 80 mijë hebrenjtë që banonin aty para pushtimit nazist, çlirimi i qytetit gjeti vetëm 140 prej tyre. Për më tepër shih: Kotani, Apostol, Shqiptarët dhe Hbrenjtë në Shekuj, f.100-101*

[41] *Mësimdhënia e Historisë Moderne të Evropës Juglindore, Materiale Mësimore Plotësuese, Lufta e Dytë Botërore, f. 21*

[42] *Po aty, f. 22*

mars-maj 1943 Bullgaria kundërshton "zgjidhjen përfundimtare" dhe internimin e hebrenjve bullgarë. Në muajt mars-qershor 1943 internohen 50 mijë hebrenj nga Selaniku në Aushvitc.[43] Në maj 1944 më shumë se 100 mijë hebrenj nga Transilvania e Veriut (nën administrimin hungarez) internohen në kampet gjermane të shfarosjes në masë.[44] Nga mbi 11 milionë hebrenj të shpërndarë nëpër Evropë u shfarosën rreth 6 milionë, ndër të cilët 1 milion e 500 mijë fëmijë.

Lidhur me trajtimin, mbrojtjen e mos dorëzimin e hebrenjve në Shqipëri, Profesor Shaban Sinani del në disa përfundime. Gjatë viteve të pragut të Luftës së Dytë Botërore numri i hebrenjve në Shqipëri u shtua dhe ata kishin origjinën nga shumë vende si Gjermania, Austria, Jugosllavia, Rumania, Bullgaria, Polonia, Turqia, Egjipti, Britania e Madhe, Amerika, etj. Shqipëria ishte gati nën protektorat italian, por për rastin e hebrenjve nuk kishte diktate nga pala italiane dhe as interesim të dukshëm diplomatik ndërkombëtar. Edhe pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia, pra pas 7 prillit 1939, ardhja e hebrenjve vazhdoi, madje duke u pajisur edhe me viza prej shërbimit konsullor italian. Vitet 1941-1942 evidentojnë shpërnguljet më të mëdha të hebrenjve drejt Shqipërisë, sidomos nga Jugosllavia e Bullgaria, të cilët u vendosën në kampe përqëndrimi në qytete dytësore dhe nën kujdesje shtetërore. Deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore numri i hebrenjve në Shqipëri u dhjetëfishua dhe asnjë hebre nuk u dorëzua apo u bë viktimë e luftës. Autoritetet italiane nuk u bënë pengesë e këtij procesi, nuk u bënë palë me gjermanët kundër hebrenjve, ata ishin indiferentë, por njëherazi edhe ndihmues. Autori pohon se "Mungesa e antisemitizmit në ushtrinë italiane në Shqipëri dhe tek populli shqiptar janë vlera nga të cilat duhen nxjerrë mësime."[45]

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, pas kapitullimit të Italisë fashiste, shqiptarët ditën të sillen ndaj italianëve të mundur. Ata që dëshiruan u inkuadruan në radhët e përkrahë partizanëve shqiptarë

---

[43] *Po aty, f. 23*

[44] *Po aty, f. 25*

[45] *Sinani, Shaban, Hebrenjtë në Shqipëri, Prania dhe Shpëtimi, f. 89*

në luftë kundër okupatorëve nazistë. Dëshmi e këtij realiteti është krijimi i batalionit "Antonio Gramshi" me rreth 1500 italianë.[46] Ndërkohë të dhëna të tjera dhe që duket se janë më të plota, ofrojnë më shumë informacion.[47] Bëhet fjalë për rreth 15 mijë ushtarakë italianë të dorëzuar pas kapitullimit të Italisë fashiste. Ata ju dorëzuan partizanëve shqiptarë, por vetëm ata më të vendosurit, rreth 2.150 vetë u futën në formacionet partizane. 472 ushtarakë italianë u rreshtuan në brigadat sulmuese, 401 u bënë pjesë e shërbimit të prapavijës, ndërsa pjesa tjetër prej rreth 1.270 vetësh u angazhuan pranë komandave të vendit. Shumë të tjerë mundën të largohen. Por pjesa e mbetur, nuk u masakrua. Përkundrazi, ata u pranuan nga shqiptarët dhe qëndruan nën kujdesin e tyre. U sistemuan në shtëpitë e shqiptarëve. Ju dha punë dhe kontribuonin në familjet shqiptare. Ata u miqësuan me shqiptarët, pavarësisht se më parë ishin në luftë për jetë a vdekje me ta. Ushtarët italianë, pushtues të djeshëm, të mbetur më 1943, pas kapitullimit të Italisë, në mëshirë të shqiptarëve, jo vetëm s'u prekën prej tyre, por u strehuan e u mbrojtën deri në mbarimin e luftës. Ekzistojnë vlerësime të ndryshme rreth numrit të ushtarëve italianë të mbetur në Shqipëri pas kapitullimit të Italisë fashiste. Ndoshta në shifrat e paraqitura përfshihen edhe italianë të përfshirë në administratë, institucione, apo edhe në sipërmarrje të ndryshme. Sipas Ismail Kadaresë bëhet fjalë për rreth 40 mijë ushtarë italianë.[48] Burime të tjera bëjnë fjalë për 45 mijë të mbetur brenda vendit,[49] ndërkohë që një vlerësim tjetër ofron shifrën 25 mijë vetë,[50] pjesëtarë të ish ushtrisë pushtuese fashiste të cilëve pas përfundimit të luftës ju krijua mundësia e riatdhesimit.

---

[46] Metais, Serge, Histori e Shqiptarëve-nga Ilirët deri te Pavarësia e Kosovës, f. 316

[47] Hasani, Proletar Prof. Dr., Formacionet tona luftarake me ish ushtarakë të huaj, Revista Ushtarake, 2/2005

[48] Lani, Remzi. Mustafa,Besanik, Misha, Piro, Lufta Kundër Luftës, (artikull nga Ismail Kadare), f.12

[49] Bartl, Peter, Shqiptarët – nga Mesjeta deri në ditët tona, f.228

[50] Sinani, Shaban, Hebrenjtë në Shqipëri, Prania dhe Shpëtimi, f. 88. Shih edhe: Kotani, Apostol, Shqiptarët dhe Hebrenjtë në Shekuj, f. 79

Në linjën e qëndrimit shqiptar ndaj të huajve, mund të shërbej edhe një fakt domethënës i ditëve tona. Sic dihet anarkia që përfshiu Shqipërinë në vitin 1997, u pasua me prani ushtarake ndërkombëtare të konkretizuar përmes Operacionit ALBA. Gjatë zhvillimit të këtij operacioni asnjë nga trupat ushtarake të vendeve të tjerë nuk u bë objekt sulmi apo objektiv për shqiptarët. Ushtarakët e huaj patën ardhur në Shqipëri me mision paqeje. Ata qenë të përgatitur për më të keqen, pra edhe për reagim të armatosur. Por pritja nga publiku shqiptar nuk qe e tillë. Ata janë pritur me dashamirësi, pasi i tillë ishte misioni i tyre. Për më tepër, shqiptarët edhe njëherë shprehën traditën e mikpritjen ndaj të huajit e mikut. Me siguri mund të thuhet se shumë ushtarakë e autoritete ushtarake të huaja janë surprizuar nga një realitet i kësaj natyre, gjë që lehtësoi edhe kryerjen e misionit.

Ajo që shqiptarët kanë bërë për të tjerët nuk ka ndodhur nga të tjerët në adresë të shqiptarëve. Përmes dokumenteve apo dëshmive të ndryshme vetëm për rreth 50 vitet e para të shekullit XX, ballafaqohemi me fakte tronditëse.

Tregues që flasin shumë, ofrohen gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Ballkanike. Në vitin 1912 në rajonin e Ballkanit mendohej për optimizëm liberal, por "që u zhduk shpejt dhe madje në mënyrë të dhunshme. Shtetet ballkanike fituese, të freskëta nga fitorja kundër ushtrisë otomane, menjëherë iu kthen njeri tjetrit në Luftën e Dytë Ballkanike. U shfaqën njoftimet për brutalitetin e treguar nga ushtritë e rregullta të tyre kundër civilëve,... 'Kjo është e gjitha që duket kur ju e shikoni atë nga afër,' raportonte Trotski. 'Mishi po prishet, si ai i qenieve njerëzore, ashtu edhe i kafshëve shtëpiake; fshatrat janë bërë pirgje zjarresh; njerëz që nuk kursejnë as 'persona nën dymbëdhjetë vjeç'; kushdo brutalizohet, duke humbur aspektin e vet human."[51] Shqipëria, që sapo ishte shpallur e pavarur, u kthye viktimë e drejtpërdrejtë e këtij realiteti. Pikërisht periudha e fundit të vitit 1912 dhe muajve të parë të vitit 1913 nga Profesor Zekeria Cana emërtohet "... kohë e zezë prej murtaje e përshkruar me skena të llahtarshme të

---

[51] *Mazower, Mark, The Balkans, A Short History, f. xxxix*

një drame të paparë deri në zhbimjen e tërë një populli."[52] Është periudha që forcat malazeze ndërmorrën çdo lloj mase për të zhbërë popullsinë shqiptare të Plavës, Gucisë, Pejës, Gjakovës, përfshi edhe pjesë të Shqipërisë që kishte shpallur pavarësinë.

Përmes rreth 420 dokumenteve arkivorë të Malit të Zi[53] vërtetohen përpjekjet dhe veprimtaria zhdukëse e ndërmarrë nga Mali i Zi kundër shqiptarëve. Operacione të mirëmenduara janë ndërmarrë për vrasje kundër shqiptarëve pa kursyer edhe fëmijët. Nën pretekstin e grumbullimit të armëve janë vrarë, në shumicën dërmuese pa gjyq rreth 400 shqiptarë.[54] Brutaliteti kundër shqiptarëve arrin deri atje sa në raportet e drejtuesve ushtarakë malazezë bëhet fjalë për qërime hesapesh dhe se "hiqen koka (shqiptarësh)",[55] për t'i përdorur ato si shenja të vërtetësisë të suksesit në operacione. Dokumentet arkivorë njëkohësisht vërtetojnë veprimtarinë asimiluese të realizuar kundër shqiptarëve duke u kërkuar me forcë ndryshimin e besimit fetar nga musliman ose katolik në ortodoks. Gjithashtu djegiet dhe sekuestrimi i pasurisë së shqiptarëve ka qenë rregull i ditës. Edith Durham bëri me dije Evropën e qytetëruar mbi masakrat malazeze kundër shqiptarëve, duke botuar për këtë problem artikuj në gazeta të ndryshme.[56] Madje ajo, duke qenë e tronditur dhe e indinjuar nga këto krime, me t'u kthyer në Londër bëri një akt tjetër civil. Nxori medaljen e artë të Knjaz Nikollës, mbretit të Malit të Zi dhe ia ktheu mbrapsht duke i dërguar

---

[52] *Cana, Zekeria, Gjenocidi i Malit të Zi mbi Popullin Shqiptar, 1912-1913 (dokumente), f. 11*

[53] *Shih po aty, f. 57-347*

[54] *Po aty, f. 359-364*

[55] *Dokumenti numër 18/31.X nxjerrë nga Arkivi i Malit të Zi. Shih: Cana, Zekeria, Gjenocidi i Malit të Zi mbi Popullin Shqiptar, 1912-1913 (dokumente), f.102*

[56] *Edith Durham i botoi artikujt e saj në gazetat: The Contemporary Review, The Adriatic Review, The New Statesman, The New Europe, Affaires Etrangeres, Man.Annual Register, The Times, Mancester Guardian. Shih: Cana, Zekeria, Gjenocidi i Malit të Zi mbi Popullin Shqiptar, 1912-1913, f. 12*

mesazhin se nuk i bëhej nder me mbajtjen e asaj dekorate të lyer me gjak.[57]

Në periudhën e viteve 1913-1914 në Shqipërinë Jugore nga forcat greke, sipas raportit të gazetarit amerikan Uilliam U. Houard: "ishin djegur ose hedhur në erë mbi 300 fshatra me 35.000 shtëpi dhe kishin mbetur pa strehë 330.000 vetë. Sipas llogaritjeve të tij, ishin vrarë, therrur me bajonetë ose djegur 20.000 burra, gra dhe fëmijë.[58] Masakrat e asaj periudhe kanë qenë të pashembullta. Ato përfshinin gjera rrënqethëse si therrje foshnjash e nënash, përdhunime, vrasje, djegie shtëpish e pronash të shqiptarëve, rrëmbim e dërgim bagëtish të shqiptarëve në territorin grek. Skenat kanë qenë nga më rrënqethëset që as mund të imagjinohen.[59]

E njëjta situatë, në të njëjtën periudhë, paraqitet nga serbët kundrejt shqiptarëve. Në pranverën e vitit 1914 udhëheqësit e disa komuniteteve në Shqipërinë Veriore, veçanërisht Kosova, u dërguan ministrave të jashtëm të Fuqive të Mëdha një protestë kundër mizorive të pamenduara të trupave ushtarake serbe kundër grave, fëmijëve dhe të moshuarve. Në protestë theksohej se vrasjet qenë kryer me gjakftohtësi dhe jo në zjarrin e betejës. Protesta shoqërohej me një listë të 50 fshatrave të rretheve të Gjakovës, Ipekut, Prizrenit, Dibrës dhe Ohrit duke bërë me dije për 359 shtëpi të djegura dhe 1827 njerëz të vrarë.[60] Ndërkohë gazetari raportues Uilliam Houard, në një intervistë të titulluar "Le të vdesin shqiptarët: ata janë

---

[57] Shih: Cana, Zekeria, Gjenocidi i Malit të Zi mbi Popullin Shqiptar, 1912-1913, f. 12

[58] Ulliam U. Houard ka qenë gazetar, kishte përvojën e gazetarit në shumë vende. Gjatë një udhëtimi vëzhgues në Shqipëri, në moshën 50 vjeçare, ai përshkoi 600 km me kalë e më këmbë për të parë gjendjen me sytë e vet. Në Shqipëri ai u takua me Harold Sherud Spenser. Ky i fundit ishte një vullnetar amerikan pa pagesë, që mbështeste edhe të tjerë financiarisht, i cili gjithashtu ka marrë edhe vetë pjesë në luftime në krye të shqiptarëve kundër grekëve. Për më tepër shih: Jacques, Edwin, Shqiptarët, Histori e Popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, f. 389

[59] Shih: Kosta Papa Tomori, Barbaritë Greke në Shqipëri, Kujtime Historike: 1913-1914, f. 47-51, 54, 57, 68, 69, 71-74, 79-80, 81, 87-93

[60] Jacques, Edwin, Shqiptarët, Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, f. 390

muhamedanë!“ bën përshkrimin e mëposhtëm: “Regjimentet serbe prej 1100 vetësh, nën komandën e gjeneral Karlos Popovič, një nga pjesëtarët e komplotit të mbretit, hynë në Shqipëri të armatosur me vajgur, pompa spërkatëse dhe dinamit. Ata kapnin shqiptarë sa mundnin. Pastaj i lidhnin së bashku për krahu dhe i qëllonin. Gratë i përdhunonin. Besoj se çdo grua që binte në dorën e serbëve, bëhej viktimë e tyre. Pastaj ata i mbyllnin nëpër shtëpi dhe vendosnin bomba nëpër mure. Spërkatnin me vajgur gjithandej dhe i vinin zjarrin. Kur flakët arrinin dinamitin, shtëpia hidhej në erë. Shqipëria është mbushur me pirgje gurësh të nxirë, që dikur ishin shtëpi“.[61]

Të dhëna të njëjta evidentohen edhe më parë dhe më konkretisht në vitin 1913. Dëshmi origjinale prezantohet nga një letër e dërguar nga një ushtarak serb, e cila u botua nga gazeta socialiste serbe Radinčke Novine , më 9 tetor1913. Ushtari në letrën drejtuar një shoku të tij shkruan: “I dashur mik, nuk kam kohë të shkruaj gjatë, por dua të flas për gjërat e tmerrshme që po ndodhin këtu. Tmerrohem prej tyre, dhe gjithmonë i bëj pyetje vetes se si mundet që njeriu të bëjë mizori të tilla.. E tmerrshme. Unë nuk do të guxoja (edhe sikur të kisha kohë të mjaftueshme, por nuk kam) të tregoja më shumë, por do të thoja vetëm kaq, që Luma (një krahinë shqiptare gjatë lumit me të njëjtin emër) nuk ekziston më. Nuk ka asgjë tjetër veç kufomave, pluhurit dhe hirit. Ka fshatra me nga 100, 150, 200 shtëpi, ku nuk ka mbetur më asnjë njeri, në kuptimin e plotë të fjalës, asnjë. Ne i mbledhim njerëzit në grupe nga dyzetë deri në pesëdhjetë vetë, pastaj i vrasim të gjithë duke i shpuar me bajoneta. Plaçkitja vazhdon kudo. Oficerët u thanë ushtarëve që të shkonin në Prizren për t' shitur gjërat që kishin vjedhur.’ Gazeta që boton letrën shton: “Miku ynë na shkruan edhe për gjëra më të tmerrshme sesa këto!; por ato janë aq të llahtarshme dhe prekëse sa që ne menduam të mos i botojmë.“[62]

---

[61] *Po aty, f. 390*

[62] *Radičke Novine, organ of Serbian social-democracy, no. 212, October 9, 1913. Shih gjithashtu: The Truth in Kosova,, f. 165. Shih edhe: Luftërat e tjera Ballkanike- Raport i Vitit 1913, f. 111*

Një tjetër dëshmi, gati e të njëjtës periudhë, një letër e dërguar nga Elbasani dhe e botuar në gazetën bullgare L'Echo de Bulgarie, 28 shtator/ 11 tetor (1913) bën me dije: "Në 20 shtatorin e kaluar...ushtria serbe rrëmbeu të gjithë bagëtinë e Malësisë së Dibrës. Barinjtë u detyruan të mbrohen dhe të përleshen, por u vranë të gjithë. Serbët vranë gjithashtu edhe dy bajraktarë të fisit të Lumës, Mehmet Ademin dhe Xhafer Elezin dhe filluan të plaçkisnin dhe të digjnin të gjitha fshatrat nga shkonin: Peshkopi, Pjeçë dhe Dohoçisht, në Dibrën e Poshtme; Allaj, Beg, Maç, Para, Obok, Klobçisht dhe Solokicë në Dibrën e Sipërme. Në të gjitha këta fshatra serbët kryen masakra të tmerrshme edhe ndaj grave, fëmijëve dhe pleqve. Në qytetin e Dibrës autoritetet nxorën një urdhër që ndalonte të bëhej pazari ditën e djelë, dhe atë ditë banorët nuk duhet të dilnin nga shtëpitë e tyre. Atë ditë u arrestuan dyzetë e tetë vetë nga paria e qytetit. Kur serbët panë se banorët e fshatrave të plaçkitura, ..., kishin ardhur për të kërkuar bagëtinë e grabitur dhe po e rrethonin qytetin, serbët e nxorrën parinë nga burgu dhe i vranë ata në mënyrën më të turpshme. Shqiptarët e Dibrës dhe zonës përreth i mbërtheu dëshpërimi dhe paniku, kështu që ata u ngritën në revoltë. I sulmuan serbët me armë, me sopata, me gurë dhe me hunj; vranë disa prej tyre dhe pjesën tjetër e përzunë nga qyteti..."[63]

Gjendja e krijuar në atë periudhë i detyroi shqiptarët që më 21 shtator t'iu drejtoheshin me kërkesat e tyre Fuqive të Mëdha në emër të popullit të Gjakovës, Ipekut, Plavës, Gucisë dhe të ish vilajetit të Kosovës. Shqiptarët nuk e tepruan kur deklaruan, lidhur me këtë zonë tjetër të revoltës, se "ushtritë e rregullta serbe dhe malazeze ndërmorrën dhe bënë gjithshka, që nga dita e parë që pushtuan territorin shqiptar, që t'i detyronte banorët të humbisnin kombësinë, ose ta mbyste brutalisht racën shqiptare. Shtëpi dhe fshatra të tërë u shndrruan në hi, popullsia e pafajshme dhe e paarmatosur u masakrua en masse, akte të pabesueshme dhune, grabitje dhe brutalitet të çdo lloji-këto ishin mjetet që u përdorën dhe po përdoren akoma nga ushtarët serbo-malazez, me synimin që të transformojnë

---

[63] *Luftërat e tjera Ballkanike-Raport i Vitit 1913, f.112*

tërësisht karakterin etnik të rajoneve që banohen kryesisht nga shqiptarët.“[64] Dëshmi të tilla janë vërtetë rrënqethëse dhe nuk shprehin aspak qëndrimin e shqiptarëve ndaj të tjerëve.

Të njëtat dukuri të tmershme evidentohen edhe më vonë, në vitin 1918 gjatë okupimit serb në Kosovë, realizuar nga Mali i Zi dhe po kështu gjatë okupimit të dytë të Kosovës dhe të pjesës perëndimore të Maqedonisë. Pushtuesit “...ishin aq brutalë sa ishin edhe gjatë viteve 1912-1913.”[65], do të shkruante shumë vite më vonë historian kroat Ivo Banac.

Edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, në Kosovë, marrëdhëniet mes strukturave partizane të Jugosllavisë dhe popullit shqiptar të Kosovës nuk isht aq fort për t'u përshëndetur. Shqiptarët ishin bërë objekt masakrash për strukturat ushtarake jugosllave.[66] Pra nuk mund të flitet për atë lloj “harmonie“ që të paktën është pretenduar nga pala jugosllave, apo për “harresën“ zyrtare shqiptare lidhur me këto marrëdhënie. Në vitin 1945 më shumë se 35 mijë luftëtarë shqiptarë nga Kosova u dërguan në veri të Jugosllavisë dhe më tepër se 50 mijë ushtarë serbë, malazezë e maqedonas të organizuar ushtarakisht ndërmorrën operacione ndëshkimore, duke arritur që më 8 shkurt 1945 të vendosnin një administratë ushtarake në Kosovë.[67] Në këtë kuadër, krimet dhe masakrat u bënë të pranishme kundër shqiptarëve në Llap, Gjilan, Drenicë, Prishtinë, por edhe në Tetovë e në Gostivar,[68] duke u shtrirë kështu në territor të gjerë, në Kosovë e në Maqedoni.

Rast e ngjarje makabre, tipike, e pashembullt në kuptimin që një shtet realizon kundër një populli përfaqësohet me masakrën e Tivarit në vitin 1945. Në këtë ngjarje të pashembullt shteti jugosllav me pretekstin e lëvizjes të shqiptarëve të Kosovës, të organizuar

---

[64] *Po aty, f. 113*

[65] *Banac, Ivo, The National Question in Yugoslavia, Origins, History, Politics, f. 297*

[66] *Ndoj, Gjetë, Gjin Marku dhe Lufta, f. 108*

[67] *The Kosova Issue-A Historic and Current Problem, f. 111*

[68] *Po aty, f. 111*

ushtarakisht, drejt frontit kroat kundër nazistëve, duke kaluar përmes territorit shqiptar dhe Malit të Zi, arriti që të realizojë masakër duke asgjësuar rreth 4310 shqiptarë të Kosovës.[69] Fillimi i këtij marshimi u kamuflua me vajtjen në front në të mirë të Jugosllavisë. Por qëllimi ishte i ndryshëm. Shqiptarët u çarmatosën dhe ashtu të pambrojtur, pa kujdesje, pa bukë e pa ujë, nën ruajtje të rreptë, kanë marshuar për kohë të gjatë Ata janë vrarë, djegur, terrorizuar, duke finalizuar veprimin makabër ndaj tyre me masakrën e Tivarit, varrin më të madh të shqiptarëve pa asnjë skelet dhe dëshmi të krimeve serbosllave mbi popullin shqiptar.[70] Përgjegjësi e plotë bie edhe mbi shtetin e qeverinë komuniste shqiptare të asaj periudhe. Jo vetëm që u lejua ky marshim nëpër territorin e shtetit shqiptar, por nuk u bë asnjë reagim zyrtar, qoftë për likujdimet nëpër territorin shqiptar, ashtu edhe për ato që ndodhën në Tivar dhe për ngjarjet pasuese.[71]

Në ditët tona, këto lloj qëndrimesh nuk pushuan. Tirani Miloshević nuk do ta respektonte ligjin e brendshëm dhe nuk do të pranonte e respektonte identitetin shqiptar në Kosovë. Ai do të zbatonte një politikë të egër gjenocidi, në emër të sovranitetit të shtetit serb. Regjimi i Milošević nuk u ndal para asnjë veprimi kundër shqiptarëve të Kosovës dhe identitetit të tyre. Në evidencën rënqethëse të vuajtjeve të popullit shqiptar të Kosovës ja vlen veçimi i ngjarjes të vitit 1990 të helmimit të 7 400 nxënësve të shkollave. Fëmijë të moshës nga 3 deri 16 vjeç, në kopshte fëmijësh, shkolla fillore e të mesme në Deçan, Gjakovë, Pejë, Podujevë, Prishtinë, etj., u helmuan,[72] ndërkohë që asnjë herë nuk u dha përgjigje zyrtare për arsyet. Mosdhënia e përgjigjes lehtësisht nënkupton autorin, i cili është regjimi miloshevician dhe strukturat e tij ushtarake e policore të instaluara në Kosovë.

---

[69] Hajdini, Azem, Tragjedia e Tivarit, Botim i Dytë, f. 70

[70] Po aty, f. 87

[71] Po aty, f. 120-121

[72] Prof. Dr. Pajazit Nushi (Prishtinë) The Phenomenon of Military-Police Violence in Kosova in the Years 1981-1992. Shih: The Kosova Issue-A Historic and Current Problem, f. 150

Për një kohë jo të shkurtër, komuniteti ndërkombëtar qëndroi pasiv. Ndërkohë që shqiptarët nuk vrasin të pafajshmit, me ta çfarë ka ndodhur? Koha e Milosheviqit në Kosovë është dëshmi e qartë e gjenocidit të sotëm. Ajo çka ndodhi në Kosovë është përsëritje e asaj që u ndodhi hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore, është përsëritje e tragjedisë së Tivarit në vitin 1945. Veprimi me vonesë i komunitetit ndërkombëtar në rastin e Bosnjës, por edhe në rastin e Kosovës, i la rrugë të lirë masakrave, zhdukjeve, dëmeve. Ajo që ndodhi në Srebrenicë të Bosnje dhe Hercegovinës në korrik 1995 ku u shfarrosën me mijra qytetarë boshnjakë përfaqëson rastin më të madh të zhdukjeve njerëzore të pas Luftës së Dytë Botërore. Si duket ende nuk ishin nxjerrë mësime për veprim në kohë. Mosveprim i komunitetit ndërkombëtar ka qenë prezent edhe në kohën e Gjermanisë naziste. Shfarrosja e çifutëve filloi më herët se viti 1939, kur filloi lufta botërore. Nëse do të veprohej, atëherë do të ishte e mundur të shpëtoheshin të gjashtë milion hebrenjtë. Mosveprimi në kohë nga komuniteti ndërkombëtar, gjithmonë është shoqëruar me pasoja katastrofike për jetët njerëzore.

Shqiptarët evidentohen si dashamirës, mikpritës, mbrojtës, respektues dhe shpëtues ndaj atyre që shkelën në territorin e tyre. Shqiptarët nuk vrasin. Ata nuk kalojnë në agresion e masakra ndaj të tjerëve. Sipas një shkrimtari izraelit, fqinjët i ka caktuar historia pranë njeri tjetrit dhe prandaj duhet të mësojmë të jetojnë pranë njeri tjetrit, ta pranojnë njeri tjetrin, të bashkëpunojnë.[73] Faktet tregojnë se shqiptarët kanë përmbushur më së miri këtë mesazh.

Në ditët e sotme, populli shqiptar është edhe më afër me popujt e tjerë. Konfrontimi i dikurshëm ia ka lënë vendin bashkëpunimit. Populli shqiptar më së miri ka përqafuar rrugën e fqinjësisë së mirë, rrugën e mirëbesimit, shkëmbimit dhe përfitimit të dyanshëm. Mesazhi është i qartë, ecja drejt së ardhmes së përbashkët dhe jo drejt së shkuarës konfrontuese, izoluese e rrënuese.

[73] *Lani, Remzi, Mustafa, Besnik, Misha, Piro, Lufta kundër Luftës*

"Shqipëria e sotme, laike në kushtetutë, por me pasuri të trashëguar besimesh lëvron vlera të rralla të lirisë, tolerancës dhe harmonisë ndërfetare. Këto veti, këto atribute, shqiptari i ndjen si të vetat, si pjesë të identitetit e jo si kontradikta që përçajnë personalitetin dhe shoqërinë. Marrëdhëniet mes besimeve, sa institucionale, por sidomos shpirtërisht dialoguese e ndërpranuese, historikisht kanë prodhuar një shoqëri shqiptare pa konflikte fetare e armiqësi apo paragjykime besimesh e kulturash, një shoqëri shembull i rrallë i patjetërsueshëm i së shkuarës, së tashmes dhe të nesërmes globale". Përcaktimi i mësipërm vlen për të shkuarën shqiptare, që në lashtësi e duke vijuar me periudhën e gjatë nën perandorinë osmane, gjatë luftrave ballkanike dhe ato botërore të shekullit XX, vlen për të sotmen në realitetin shqiptar, por edhe në marrëdhëniet me fqinjët, vlen për të ardhmen integruese të Shqipërisë. Në këtë kuadër, shëmbull më kuptimplotë është vizita e Papa Franceskut në Tiranë në muajin shtator 2014. Pa mëdyshje, mund të thuhet se harmonia ndërfetare përfaqëson ambasadorin më të mirë të shqiptarëve në botën e qytetëruar.

Përfundime

Shqiptarët në trojet e tyre janë të lashtë dhe krenarë. Në këto troje ata janë përballur me të tjerët, të cilët kanë dashur t'i pushtojnë. Vështirë të gjenden raste kur shqiptarët kanë synuar apo tentuar të pushtojnë apo dëmtojnë popuj të tjerë. Për shqiptarët dora e miqësisë dhe fqinjësia e mirë kanë qenë karakteristika nga më të mirat. Ato kanë qenë pjesë e natyrshme e identitetit shqiptar.

Shqiptarët historikisht kanë respektuar dhe aktualisht respektojnë e nderojnë të tjerët. Respekti e mirënjohja është virtyt i tyre. Hakmarrja kursesi. Me këto veti shqiptarët, aktualisht janë në rrugën e tyre të integrimeve evropiane dhe euroatlantike.

Abstrakt

Pavarësisht se trojet shqiptare kanë qenë arenë luftrash, të nxitura e të realizuara nga fqinjë dhe fuqi të tjera, kombi shqiptar ka ditur të sillet ndaj të tjerëve. Shqiptarët kanë ditur të mbrohen. Por, njëherazi kanë ditur edhe të respektojnë e të trajtojnë si duhet të huajt, të mundurit, të dorëzuarit dhe viktimat. Kombi shqiptar dhe shqiptarët përherë kanë qenë të prirur nga synime të fqinjësisë së mirë dhe jo të agresionit ndaj të tjerëve. Kodi i shqiptarëve ndaj të huajve, pavarësisht se ai nuk i referohej ndonjë konvente ndërkombëtare, ka qenë i ngjajshëm me kërkesat që aplikohen bazuar në to. Shqiptarët kanë ditur të dallojnë agresorin nga miku, pushtuesin nga të mundurin dhe të dorëzuarin.

Shqiptarët e kanë treguar veten e tyre në luftrat ballkanike dhe gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore. Ata kanë ditur të sillen me ushtritë e mundura apo ushtritë që kanë kaluar nëpër territoret shqiptare. Ata kanë qenë të prirur për bashkëpunim e ndihmë ndaj të mundurve. Kanë qenë këto vlera të trashëguara nga shqiptarët, të cilat i kanë bërë ata që të jenë shembull në botë për trajtimin që u kanë bërë dhe marrëdhëniet që ndërtuan me hebrenjtë para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Për shqiptarët dora e miqësisë dhe fqinjësia e mirë kanë qenë karakteristika të natyrshme, madje të veçanta që i kanë shoqëruar ata në historinë e tyre. Vlerat e harmonisë fetare, marrëdhënieve të mira me fqinjët dhe treguesit e bashkëpunimit, kanë bërë që edhe sot ata të jenë të angazhuar me vetëdije në rrugën e integrimeve evropiane dhe euroatlantike.

Literatura

1. Asllan Uran, Prof. Dr., Diplomacia dhe Diplomatët shqiptarë 1912-1944, Shtëpia Botuese ILAR, Tiranë, 2006
2. Banac, Ivo, The National Question in Yugoslavia, Origins, History, Politics, Cornell University Press, Ithaca ad London, 1984
3. Bartl, Peter, Shqiptarët – nga Mesjeta deri në ditët tona, Instituti i Dialogut&Komunikimit
4. Cana, Zekeria, Gjenocidi i Malit të Zi mbi Popullin Shqiptar, 1912-1913 (dokumente), Prishtinë, 1996
5. Castellan, Georges, Histori e Ballkanit, Çabej
6. Crociani, Piero, Shqiptarët në Forcat e Armatosura Italiane (1939-1943), Tiranë, 2005
7. Duka, Valentina, Histori e Shqipërisë, 1912-2000, Shtëpia Botuese "Kristalina", Tiranë, 2007
8. Durham, Edith, Brenga e Ballkanit, dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe Shqiptarët, Shtëpia Botuese "8 nëntori",
9. Gitman, Esther, Historian, New York, Dr. Aloysius Stepinac, Archbishop of Zagreb, under the lens of historians and diplomats (1941-1945), International Conference, September 19, 2008
10. Hajdini, Azem, Tragjedia e Tivarit, Botim i Dytë, Botues Shoqata e të Burgosurve Politikë, Prishtinë, 1998
11. Hasani, Proletar Prof. Dr., Formacionet tona luftarake me ish ushtarakë të huaj, Revista Ushtarake, 2/2005
12. Jacques, Edwin, Shqiptarët, Histori e Popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, Fondacioni Abraham Linkoln, Kartë e Pendë, 1995
13. Jakomoni, Francesko, Politika e Italisë në Shqipëri, Tiranë, 2005
14. Kotani, Apostol, Shqiptarët dhe Hbrenjtë në Shekuj, Tiranë, 2007

15. Kosta Papa Tomori, Barbaritë Greke në Shqipëri, Kujtime Historike: 1913-1914, Naimi, Tiranë, 2012
16. Lani, Remzi, Mustafaj, Besnik, Misha, Piro, Lufta kundër Luftës, (Opinioni intelektual rreth luftës në Kosovë), Instituti Shqiptar i Media, Tiranë, Gazeta Koha Ditore, Prishtinë
17. Luftërat e tjera Ballkanike-Raport i Vitit 1913 nga Carnegie Endowment në një vështrim Retrospektiv, me Shënime dhe me një Parathënie të re për Konfliktin e Sotëm nga Xhorxh F. Kenan, Onufri, 1993
18. Mazower Mark, The Balkans, A Short History, The Modern Library, New York, 2000
19. Metais, Serge, Histori e Shqiptarëve-Nga Ilirët deri te Pavarësia e Kosovës, Tiranë, 2006
20. Mësimdhënia e Historisë Moderne të Evropës Juglindore, Materiale Mësimore Plotësuese, Lufta e Dytë Botërore, CDRSEE, Shkup 2007
21. Misha, Piro, Duke kërkuar Rrënjët ose... Kthimi i Shqiptarëve në Histori, ese, TOENA, Tiranë, 1997
22. Ndoj Gjetë, Gjin Marku dhe Lufta, Geer, Tiranë, 2008
23. Remerand, Gabriel, Pashai Janinës, GLOBUS R, Tiranë, 2004
24. Samer, Haroey, Rescue in Albania-One hundred percent of Jews in Albania rescued from Holocaust, Brunswick Press Cathedral City, California, 1997
25. Silajxhic, Haris, Shqipëria dhe SHBA në Arkivat e Uashingtonit, Tiranë
26. Sinani, Shaban, Hebrenjtë në Shqipëri, Prania dhe Shpëtimi, Naimi, Tiranë, 2009
27. Tahiri, Bedri, Hasan Prishtina-Truri i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Prishtinë 2008
28. The Truth in Kosova, The Academy of Sciences of the Republic of Albania, Institute of History, Tirana, 1993

STUDIME POLITIKE DHE JURIDIKE

KUSHTETUTAT SHQIPTARE SI EKSPERIMENTE TE VAZHDUESHME

Asoc. Prof. Dr. Afrim Krasniqi

Kushtetuta është dokumenti themelor i organizimit të shtetit. Në terma politikë, ajo është "një kontratë shoqërore, një marrëveshje midis të gjithë qytetarëve dhe qeveritarëve të tyre" në të cilën përcaktohet "çfarë të drejtash kanë drejtuesit dhe çfarë të drejtash kanë qytetarët" dhe pas miratimit ajo shërben "si garanci thelbësore e të gjitha të drejtave të qytetarëve dhe e formës së regjimit" (Scott Carlson, 2010). Në këtë mënyrë, Kushtetuta përmban "normat dhe rregullat lidhur me organizimin e funksionimin e pushtetit shtetërore , sidomos te organeve te larta shtetërore, si dhe raporti midis këtyre organeve" (Jelinek, 2008). Sipas studiuesve të tjerë bashkëkohorë, Kushtetuta është "dokument i shkuar me fuqi më të lartë juridike e sjellë nga organi përfaqësues i cili është bartës i pushtet ligjvënës ose nga organ special kushtetues, me procedurë të veçantë nga ajo sipas të cilës sillen ligjet, dispozitat dhe aktet e tjera" (Kelzen, 1998[74]).

Në traditën shqiptare kushtetuta, nocionet e lidhura me të dhe konceptet që burojnë prej saj kanë jetëgjatësi më pak sesa vetë jetëgjatësia e shtetit. Për shkak të rrethanave historike, shteti shqiptar u krijua në fazën e fundit të rënies së Perandorisë Otomane dhe krijimit të shteteve ballkanike, dhe për pasojë, u ndesh me vështirësi të dyfishta në formësimin e shkruar dhe jetësimin praktik të praktikave dhe normave kushtetuese. Për themeluesit e shtetit shqiptar mungonte një dokument referues i mëparshëm, mungonte tradita e

[74] *A. Anastasi L. Omari , E Drejta Kushtetuese ,Tiranë 2008 (citim Georg Jelinek dhe Kalzeni)*

afërt bashkëkohore dhe mungonin institucionet legjitime nga të cilat mund të buronte dokumenti kushtetues. Krahas këtyre tri mungesave të mëdha, themeluesit e shtetit u ndeshën edhe me një kulturë minimale politike dhe demokratike të banorëve të atëhershëm, të cilët, prej më se pesë shekujsh, brez pas brezi, kishin jetuar në periferi të Perandorisë Otomane, nën sundimin e normave kushtetuese, qeverisëse dhe administrative të Portës së Lartë.

Në kulturën shqiptare në raport me shtetin, dominues pati qenë organizimi lokal mbi rregullat e përcaktuara nga e drejta zakonore, Kanuni. Ky institucion i hershëm dhe vetë-organizues në kohën e mungesës së shtetit funksional dhe nacional, krijoi struktura lokale funksionale, të cilat i mbijetuan edhe periudhave të gjata të sundimit otoman. Ai u trashëgua në formë të pashkruar, por u respektua nga të gjitha subjektet e tij, - një praktikë unike për një vend evropian në të njëjtën fazë zhvillimi historik. Kanuni dhe modelet e tij të shfaqura në forma të ndryshme kryesisht në zonat veriore dhe më pak në zonat jugore, bazohej në konceptin e vendimmarrjes legjitime lokale, ekzistencës së Kuvendit të Pleqve dhe organizimit patriarkal, institucionit të besës dhe respektit ndaj institucionit fetar, sidomos atij kishtar.Në fazën e fundit në prag të shpalljes së krijimit të shtetit, territori shqiptar ishte pjesë e administrimit otoman, dhe figura të njohura publike e politike shqiptare ishin pjesë e strukturave vendimmarrëse politike otomane. Gjatë atyre viteve dhe më vonë përgjatë shekullit shteti shqiptar u përball në mënyrë periodike nga problemet e mëdha të mungesës së stabilitetit të brendshëm dhe kërcënimeve të jashtme (Schmidt-Neke, 2009).

Fillimet kushtetuese, burim i Konferencës së Londrës

Kushtetuta e parë shqiptare nuk ishte produkt i elitave politike dhe kombëtare që shpallën pavarësinë dhe krijuan shtetin në nëntor 1912, por e Fuqive të Mëdha, e diplomatëve dhe ekspertëve pa lidhje organike me Shqipërinë. Themeluesit e shtetit, ata që nën drejtimin e

Ismail Qemalit shpallën Pavarësinë më 1912, arritën të hedhin themelet e para edhe në legjislacionin e shtetit të ri, kryesisht me ligjin mbi Kanuni i Zhurisë (maj 1913) dhe Kanunin e Përshtatshëm të Administratës Civile (nëntor 1913). Vendimmarrja kryesore e Kuvendit të Vlorës i përket aktit të shpalljes së pavarësisë, krijimin e qeverisë dhe pleqësisë, si dhe angazhimin për mbrojtjen e çështjes shqiptare në kancelaritë vendimmarrëse evropiane.

Në mesin e vitit 1913, në Londër Fuqitë e Mëdha zyrtarizuan Statutin Organik të Principatës Shqiptare, një dokument me rëndësi historike dhe thelbësore për fatet e shtetit të parë shqiptar që prej periudhës së Skënderbeut. Vendimi i Konferencës së Londrës përmblidhej në 11 nene, ku sipas nenit 1, "Shqipëria formohet si një principatë autonome, sovrane dhe e trashëgueshme sipas rendit të parëlindjes, nën garancitë e të gjashtë Fuqive. Princi do të caktohet nga të gjashtë Fuqitë". Më tej Statuti përcaktonte ndarjen e plotë nga Turqia, neutralitetin e shtetit të ri, krijimin e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit për administrimin civil e financiar, përgjegjësinë e vendosjes së rendit dhe sigurimit të mbrojtjes përmes ekspertëve të ardhur nga jashtë, etj. Megjithëse një dokument me 11 pika, ai ka vlera të jashtëzakonshme për historinë e shtetit shqiptar. Tri vlerat thelbësore të tij janë: krijimi i shtetit nën kujdesin e Fuqive të Mëdha, përcaktimi perëndimor i Shqipërisë përmes kushtëzimit për caktimin e një Princi në krye të shtetit të ri, si dhe krijimi për herë të parë i institucioneve legjitime, me njohje ndërkombëtare dhe me fuqi vendimmarrëse në emër të shtetit.

Pas përcaktimit të Princ Ëied në krye të Principatës Shqiptare në prill 1914 u shpall prej Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe Princit, "Statuti Organik i Shqipërisë", e para Kushtetutë e plotë, integrale, evropiane dhe legjitime e shtetit shqiptar. Kushtetuta e re në nenin 1 përcaktonte se "Shqipëria formohet si një principatë kushtetuese,sovrane dhe e trashëgueshme nën garancinë e të gjashtë Fuqive të Mëdha.....Shqipëria është e pandashme, territori i

saj është i patjetërsueshëm...Shqipëria është neutrale; neutraliteti i saj është i garantuar nga të gjashtë Fuqitë e Mëdha".

Kushtetuta e re (Statuti Organik), në dallim nga modelet e tjera shtetërore, u imponua nga jashtë, pa pjesëmarrjen e shqiptarëve, pa votim direkt ose indirekt dhe për pasojë, në aspektin juridik, është kritikuar[75] se cenonte sovranitetin e shtetit shqiptar (Omari, 2004). "Statusi Organik i Shqipërisë" përbëhej nga 216 nene të ndarë në kapituj, përkatësisht[76]: Shqipëria dhe territori i saj (nenet 1-6), sovrani (nenet 7-21), populsia (nenet 22-39), legjislacioni (nenet 40-71), organet e qeverisjes (nenet 72-140), financat (nenet 141-143), punët publike (nenet 144-148), forcat e armatosura (nenet 149-158), drejtësia (nenet 159-169), feja (nenet 170-177), arsimi publik (nenet 178-182), prona e tokës (nenet 183-194), bujqësia, tregtia dhe industria (nenet 195-208), posta, telegrafët dhe telefonat (nenet 209-210), marrëdhëniet me jashtë (nenet 211-212), dhe e drejta administrative (nenet 213-216). Vlera e tij kryesore është pikërisht krijimi dhe shpallja e tij, ndërkohë që elementi tjetër thelbësor, - jetësimi praktik, rezultoi i pamundur në kushtet në të cilat u ndodh Shqipëria e vitit 1914.

Nga Kushtetutat deklarative, në Kushtetutën qeverisëse

Me përfundimin e Luftës së Parë Botërore dhe përpjekjet shqiptare për të krijuar struktura përfaqësuese në Konferencën e Paqes në Paris/Versajë, problemi kryesor për elitën e re shqiptare ishte kalimi nga akti i krijimit të shtetit (1912) tek jetësimi konkret i shtetit. Me këtë objektiv delegatë nga gjithë vendi u mblodhën në Lushnje, në Kongresin Kombëtar, i cili i dha jetë një dokumenti kushtetues me vlerë të madhe historike, - Kanunorja e Këshillës së Naltë. Ashtu si dokumenti i Londrës, edhe produkti kushtetues i

---

[75] Luan Omari. "Sistemi parlamentar". Parlamenti në Shqipëri, Tiranë, 2004.

[76] Antolello Biagini: "Historia e Shqipërisë", Tiranë, 1998.

Lushnjës hedh bazat kryesore të organizimit të ri shtetëror, - parime të cilat në një fazë tjetër do të mund të shndërroheshin në dokument kushtetues më të gjerë. Dokumenti i njohur si Statuti i Lushnjës, përbëhej nga 6 nene, duke krijuar institucionin e Këshillit të Naltë të shtetit në funksionin e kryetarit të shtetit. Pa prekur formën e regjimit dhe pa hyrë në debat mbi frontin e Princ Ëied të krijuar më 1914, delegatët e Lushnjës përcaktuan se "me të ardhmen e mbretit në fronin e naltë mbretnor, Këshilla e Naltë njihet vetvetiu e rrëzueme". Më tej delegatët krijuan Kuvendin Kombëtar (Këshillin Kombëtar) me atributet e parlamentit të parë shqiptar, zgjodhën katër anëtarët e Këshillit të Naltë dhe zgjodhën qeverinë e re, duke jetësuar kështu edhe de facto shtetin e ri shqiptar.

Pas kalimit të fazës së parë të njohjes ndërkombëtare, të vendosjes së kufijve dhe vendosjes së autoritetit të shtetit deputetët bashkëpunuan ngushtë për hartimin e dokumentit të plotë kushtetues, ashtu si KNK më 1914. Në dhjetor 1922 parlamenti miratoi "Statutin e Zgjeruar të Lushnjës", Kushtetuta e parë e produktit tërësisht shqiptar, kushtetuta e parë e miratuar dhe kushtetuta e parë funksionale në historinë e shtetit 100 vjeçar shqiptar. Dokumenti i ri ishte shumë më cilësor, më evropian në norma, më demokratik në produkt dhe legjitimitet, si dhe më funksional në konceptet e ndarjes dhe balancës së pushteteve. Ai përbëhej nga 129 nene dhe trajtonte të gjithë problematikat e funksionimit të shtetit. Që në fillim të tij Statuti përcaktonte se "shteti shqiptar qeveriset prej nji qeverije monarkike kushtetore. Vendin e Mbretit e zen përkohsisht Këshilli i Naltë me të drejtat e detyrat e caktueme taksativisht në ketë Shtatut. Pushteti legjislativ ushtrohet prej Pleqsis e Këshillit të Naltë".

Statuti i Zgjeruar i Lushnjës ishte baza themelore mbi të cilën funksionoi shteti shqiptar përgjatë viteve 1922-1924, derisa në ngjarjet e qershorit dhe dhjetorit 1924 të gjitha institucionet e krijuara prej tij u vunë në sprovë dhe nuk rezultuan të afta të zgjidhnin në mënyrë institucionale mosmarrëveshjet mes tyre. Për rrjedhojë, në fundin e vitit 1924 mori fund sistemi shumëpartiak demokratik dhe jeta

institucionale e bazuar në modelin e Kongresit të Lushnjës apo Statutit të Zgjeruar të tij. Mbështetësit e "kthimit të legalitetit" referuar institucioneve politike e shtetërore të periudhës përpara 10 qershorit 1924, inicuan ndryshime të shpejta kushtetuese dhe proklamuan nevojën e ndryshimit të formës së regjimit, - kalimin nga principata tek republika. Me miratimin e këtij ndryshimi mori fund edhe periudha e drejtimit të Shqipërisë nga Princ Ëied apo Këshilli i Naltë si zëvendësues dhe ushtrues i pushtetit në mungesë të Princit.

Në janar 1925 parlamenti i ri votoi për formën republikane të qeverisjes dhe zgjodhi Ahmet Zogun si Kryetar të Republikës. Zyrtarisht vetëm në mars 1925 mori jetë Kushtetuta e re republikane, e quajtur, Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare. Sipas Statutit, "Shqipnija asht Republikë Parlamentare e Kryesueme prej nji Kryetari. Sovraniteti buron prej popullit". I përbërë nga 142 nene dhe duke qenë 100% produkt i një rryme politike në parlamentin shqiptar, Statuti përbën dokumentin e parë kushtetues që ndaloi ekzistencën e partive politike dhe eksperimentoi modelin republikan në Shqipëri. Në shumicën e koncepteve të tij Statuti kishte risi pozitive, referohej modeleve franceze dhe italiane në ngritjen e institucioneve, si dhe lejoi eksperimentimin për herë të parë të sistemit parlamentar me dy dhoma, duke krijuar institucionin e Senatit, si institucion balancues dhe maturues në sistemin politik. Gjithsesi Kryetari i Republikës, i zgjedhur me mandat 7 vjeçar, mori kompetencat thelbësore, përfshirë edhe kompetencën unike, të qenies njëherësh edhe kryeministër dhe organ emërtues për një të tretën e anëtarëve të Senatit.

Rikthimi i monarkisë dhe fundi i saj në Shqipëri

Modeli republikan mbijetoi vetëm tri vjet, për ti lënë vendin rivendosjes së monarkisë, tashmë si fron shqiptar dhe produkt tërësisht shqiptar. Me ndihmën edhe të shtetit monarkist italian monarkia shqiptare u vendos në shtator 1928 dhe kryetari i

Republikës u bë edhe mbreti i parë e i fundit i shtetit shqiptar. Dokumenti kushtetues i Monarkisë Shqiptare u quajt "Statuti Themeltar i Mbretërisë" dhe u jetësua zyrtarisht në dhjetor 1928, tre muaj pasi sovrani ishte zgjedhur tashmë nga parlamenti.

Sipas Statutit, "Shqipëria është Mbretëri (Royaume) demokratike, parlamentare dhe e trashëgueshme". Statuti i ri anulloi modelin me dy dhoma parlamentare dhe riktheu modelin e një dhome, krijoi institucionin e Këshillit të Shtetit, si dhe hodhi bazat e organizimit shtetëror bazuar në disa prej praktikave të njohura në disa vende monarkiste perëndimore. Me 243 nenet e tij ai mbetet dokumenti kushtetues më i gjatë, më i detajuar, por edhe një produkt shqiptar unik, i miratuar indirekt përmes votës parlamentare dhe mungesës së opozitës politike e publike.

Kushtetuta e vitit 1928 (Statuti) udhëhoqi modelin qeverisës të shtetit shqiptar përgjatë 11 viteve duke qenë dokumenti dhe modeli qeverisës më stabël dhe funksional gjatë gjysmës së parë të shekullit të kaluar. Bilanci i saj duhet parë në kontekstin e kohës dhe rrethanave kur u praktikua, sistemit politik që prodhoi dhe trendit në modelet autoritariste në shumicën e vendeve rajonale dhe evropiane.

Në prill 1939 Italia e identifikuar me fashizmin vendosi pushtetin e Shqipërisë dhe inskenoi edhe bashkimin e dy shteteve në një shtet të vetëm. Me pushtimin e vendit mori fund periudha e drejtimit nga Zog dhe modeli politik e kushtetues që ai krijoi. Italia krijoi institucione formale varësie në Shqipëri, dhe miratoi në qershor 1939 një dokument kushtetues vasaliteti politik, si bazë e funksionimit shtetëror përgjatë 3-4 viteve të ardhshme. Sipas Statutit Themeltar të Mbretërisë (1939), "shteti Shqiptar sundohet prej nji Qeverije monarhike kushtetnore. Froni trashigohet si mbas ligjës salike prej dinastisë së Madhnis së Tij Viktor Emanuelit III, Mbretit t'Italis e të Shqipnis, Perandorit t'Ethiopisë". I gjithë dokumenti kushtetues përbëhet nga 54 nene, të gjitha pushtetet drejtohen nga Perandori (përmes mëkëmbësit të tij), dhe se Shqipëria praktikon për herë të parë modelin e partisë shtet, ku Partia Fashiste ishte e identifikuar me

shtetin dhe forcë e vetme politike në Asamblenë (parlamentin) e krijuar nga Italia në Shqipërinë e pushtuar.

Pas kapitullimit të Italisë në shtator 1943 elitat vendore shqiptare u përpoqën të krijojnë institucionet e reja shtetërore dhe të rikthejnë monarkinë e para vitit 1939, por pa praninë e ish mbretit Zog. Ata bashkuan dy elementë historikë, monarkinë shqiptare me modelin e Kongresit të Lushnjës (Këshilli i Naltë në vend të Mbretit) dhe kështu, krijuan një model të ri kushtetues eksperimental, të njohur më pas pjesërisht edhe nga autoritetet pushtuese gjermane. Baza ligjore e sistemit të ri eksperimental u hodh me vendimin e Kuvendit Kombëtar (tetor 1943), sipas të cilit, rrëzohen të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e datës 12 prill 1939 (e organizuar nga Italia Fashiste), dhe bashkë me të, edhe kurora e Viktor Emanuelit III si dhe Statuti i dekretuar prej tij në qershor 1939.

Kuvendi ia delegoi kompetencën e pushtetit përmbarues Këshillit të Naltë të zgjedhur prej tij, si dhe pushtetin legjislativ parlamentit në bashkëpunim me Këshillin, duke marrë si bazë referuese ligjore Statutin e datës 1 dhjetor 1928. Rreth 15 nenet e pëcaktuara nga ky Kuvend krijuan një bazë juridike më rëndësi për pozitën politike të Shqipërisë, por pa ndikim të madh në pozitën ndërkombëtare, për shkak të rrethanave nën pushtimin gjerman, si autoriteti de facto, kryesor vendimmarrës në vend. Përgjatë periudhës tetor 1943-tetor 1944 u krijuan disa qeveri dhe u bënë zgjedhje të rregullta për Këshillin e Naltë, gjithësesi në gjysmën e këtij mandati, në maj 1944 lindi një realitet tjetër paralel, prej të cilit do përcaktohej fati politik i Shqipërisë përgjatë gati pesë dekadave të ardhshme. Kjo i dha fund edhe modeli monarkist në historinë shekullore shqiptare dhe kushtetutave që prodhuan ato.

Kushtetutat e sistemit njëpartiak në Shqipëri

Në maj 1944 forcat politike dhe ushtarake të grupuara pranë PKSH dhe të asistuara nga aleatë të lëvizjes rezistente komuniste zhvilluan Kongresin e Përmetit. Në Përmet u morën vendime politike

me ndikim direkt në sistemin politik dhe formën qeverisëse në Shqipëri. Konkretisht, u krijua Këshilli Antifashist Nacional Clirimtar, prej nga doli më pas edhe Komiteti ANC dhe organet kryesore politike të PKSH. Në mbledhjen e KANC (maj 1944) u vendos anullimi i monarkisë, ndalimi i kthimit në Shqipëri i familjes mbretërore, njohja e këshillave zonale si pushteti i vetëm legjitim, luftë ndaj forcave të tjera politike dhe pushtuesit, si dhe krijimi i qeverisë së përkohshme komuniste. Janë 6 nene, - dokumenti më i shkurtër kushtetues në historinë 100 vjecare, por nenet më me ndikim për shkak të sistemit që prodhuan dhe jetësuan me vendosjen e regjimit komunist.

Në nëntor 1944 komunistët morën pushtetin, një vit më pas në dhjetor 1945 zhvilluan zgjedhje pa praninë e opozitës dhe votës alternative dhe në janar 1946 u vendos forma republikane, me emërtimin "republikë popullore" e Shqipërisë. Për pasojë, në mars 1946 u jetësua edhe dokumenti kushtetues i parë i periudhës komuniste, i quajtur "Statuti i Republikës Popullore". Sipas nenit 1, "Shqipëria është një republikë popullore, ku i gjithë pushteti buron nga populli dhe i takon popullit" dhe se "populli realizon pushtetin e tij me anë t'organeve përfaqësonjëse të pushtetit shtetëror që janë këshillat popullore, të cilat lindën në luftën nacional çlirimtare kundër fashizmit e reakcionit edhe përfaqësojnë fitoren më të madhe të masave kryesore të popullit shqiptar". Dokumenti ishte imitim thuajse identifik i modelit të kushtetutave të vendeve në sferën sovjetike, sidomos i modelit jugosllav, dhe se formalisht u konsiderua i miratuar nga Asambleja Kombëtare, organ i krijuar në funksionet parlamentare nga PKSH. Pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, eleminimit të opozitës, marrjes së kontrollit të plotë, shtetëzimit të pronës dhe njohjes së regjimit të ri brenda zonës së ndikimit sovjetik në botë, PPSH vendosi rishikimin dhe ndryshimin e dokumentit kushtetues. Ndryshimi u jetësua më 1950, përfshirë edhe emërtimi zyrtar, nga "Statut" në "Kushtetutë". Kushtetuta e RPSH kishte dy nene më shumë sesa modeli kushtetues i vitit 1946, gjithësesi që në fillim të saj theksonte se "Shqipëria është një republikë popullore.... shtet i

punëtorëve dhe fshatarëve punonjës" dhe se "baza politike e RPSH janë këshillat popullore që lindën gjatë luftës nacional-çlirimtare kundër fashizmit dhe reaksionit dhe u forcuan me fitoren historike të kësaj lufte dhe gjatë ndërtimit të bazave të socializmit". Ky dokument kushtetues e thelloi natyrën ideologjike të shtetit dhe shoqërisë, dhe mbeti në fuqi deri më 1976, kohë kur marrëdhëniet miqësore midis Shqipërisë dhe BRSS ishin zëvendësuar fillimisht me marrëdhëniet me Kinën dhe më pas me politikën e izolimit të plotë nga Lindja dhe Perëndimi. Kushtetuta e vitit 1976 përbën dokumentin më ideologjik dhe statik në historinë e shtetit shqiptar. Që në fillim të saj theksohet se "RPSSH është shtet i diktaturës së proletariatit, që shpreh e mbron interesat e të gjithë punonjësve. RPSSH mbështetet në unitetin e popullit rreth Partisë së Punës së Shqipërisë dhe ka në themel aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë kooperativiste nën udhëheqjen e klasës punëtore". Me një nen unikal Kushtetuta përcakton se PPSH "është forca e vetme politike udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë" dhe se "në RPSSH ideologjia sunduese është marksizëm leninizmi. Në bazë të parimeve të tij zhvillohet gjithë rendi shoqëror socialist". 112 nenet e kësaj Kushtetute kanë të njëjtën masë ekstreme ideologjizmi dhe identifikimi me modelin klasik të partisë-shtet. Të gjitha institucionet e tjera burojnë prej të njëjtës frymë dhe model ideologjik.

Në këtë mënyrë, tri modelet kushtetuese të regjimit komunist reflektuan tri fazat e zhvillimit të tij, periudhën e dominimit të lidhjeve jugosllave, më pas dominimin e koncepteve sovjetike dhe së fundi, parimet e një vendi që ka vendosur të izolojë vetveten nga pjesa tjetër e botës, duke e veshur këtë zgjedhje me argumente dhe alibi ideologjike.

Kushtetutat e tranzicionit, - drejt një modeli kushtetues

Në fundin e vitit 1990 lëvizja demokratike solli ndryshimin e sistemit dhe bashkë me të, edhe ndarjen nga modeli kushtetues dhe politik i vitit 1976. Gjatë periudhës dhjetor 1990-prill 1991, përfshirë edhe

procesin e parë zgjedhor shumëpartiak në mars 1991, u eksperimentua me një sistem dual politik, - një sistem shumëpartiak në një vend ku ende ligjërisht ishte në fuqi kushtetuta antidemokratike e vitit 1976. Me jetësimin e parlamentit të ri shumëpartiak, të gjitha forcat politike ranë dakord për anulimin e Kushtetutës së vitit 1976 dhe miratimin e përkohshëm të një sërë normash kushtetuese, të njohura me emrin, Dispozitat Kryesore Kushtetuese (DKK).

Në krye të ligjit mbi DSK theksohet se "Shqipëria është republikë parlamentare. Sovraniteti kombëtar buron nga populli dhe i përket atij. RSH është shtet juridik dhe demokratik. Dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, zhvillimi i lirë i personalitetit të tij, si dhe rendi kushtetues, barazia para ligjit, drejtësia shoqërore e përkrahja shoqërore dhe pluralizmi janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë e mbrojë ato". Në një nen tjetër pasues theksohet se "parimi themelor i organizimit shtetëror është ndarja e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe atij gjyqësor. Populli e ushtron pushtetin nëpërmjet organeve përfaqësuese të tij, si dhe me referendum". Të gjitha këto janë nocione unike në historinë e shtetit dhe bëjnë dallim të dukshëm me cdo formë tjetër kushtetuese dhe qeverisëse.

Fuqia e DKK do të shtrihej deri në kalimin në parlament të draftit të ri konsensual kushtetues, proces që dështoi më 1993 dhe më pas edhe me votimin e një drafti kushtetues qeveritar në referendum në nëntor 1994. Në këtë mënyrë, DKK mbetën në fuqi deri më 1998. Përgjatë 7 viteve të funksionimit të tyre u krijuan institucionet kryesore të shtetit dhe u hodhën bazat e parimit kushtetues të ndarjes dhe balancës së pushteteve. Bazuar në DKK u zhvilluan dy procese zgjedhore parlamentare, u krijua Gjykata Kushtetuese dhe u miratua legjislacioni bazë për të gjithë sektorët shtetërorë e publikë.

Më 1998 mazhoranca qeverisëse dhe partnerët ndërkombëtare iniciuan procesin e hartimit të Kushtetutës, proces që u mbyll me votimin në referendum dhe dekretimin në ditën kombëtare. Kushtetuta e vitit 1998 shënon dokumentin e parë dhe të vetëm kushtetues të

votuar nga qytetarët, dokumentin e parë të plotë kushtetues të Shqipërisë demokratike, dhe një bazë të qëndrueshme dhe cilësore të konceptit dhe synimit për një shtet të lirë, të drejtë dhe të integruar.

Në krye të Kushtetutës përcaktohet natyra parlamentare e shtetit, si dhe parimi se "qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike". Më tej kushtetuta përcakton të drejtat politike, sociale, ekonomike, juridike, etj, si dhe ndarjen e balancën e pushtetit midis pushteteve kryesore dhe instirtucioneve kryesore në sistemin politik dhe qeverisës në vend. Parlamenti mbetet me sistem me një dhomë, Presidenti zgjidhet nga parlamenti, pushteti ekzekutiv i përket qeverisë, gjyqësori krijon pushtet më vete në sistemin qeverisës, një sërë institucionesh të tjera, përfshirë Banka Qëndrore, KLD, KLSH, KQZ, etj krijon dhe marrin mbrojtje demokratike kushtetuese.

Dokumenti final i tekstit të Kushtetutës së Shqipërisë, miratuar me referendum në nëntor 1998, mbeti i pacënuar deri më 2003, kur debati rreth KQZ i shtyu partitë të ndryshojnë me ligj parimin kushtetues të zgjedhës së anëtarëve të tij. Palët politike kërkuan dhe vendosën balancimin politik të KQZ, duke ndryshuar thelbin e nenit kushtetues mbi të. Gjithësesi ndryshime direkte në Kushtetutë u bënë vetëm në janar 2007, pra 9 vjet më vonë nga miratimi, përsëri lidhur me pikën referuese të përbërjes së KQZ, duke shtuar me dy numrin e anëtarëve.

Më 2008 palët politike nisën një proces të shpejtë dhe bilateral, jo publik, të ndryshimit të kushtetutës në disa elementë thelbësor të saj. Procesi u mbyll me votim konsensual midis dy partive kryesore politike në prill 2008, por nën kritikat e shumta të institucioneve të tjera kushtetuese dhe të shoqërisë civile. Me ndryshimet e reja kushtetuese u kalua nga sistemi i votimit miks në sistemin proporcional rajonal, KQZ u hoq tërësisht si institucion nga kushtetuta dhe u kalua me trajtimin një ligjin zgjedhor, u vendos mandat për Prokurorin e Përgjithshëm, si dhe u ndryshua mandati i qeverisjes vendore nga tre në katër vjet.

Ndryshimi thelbësor i paktës kushtetuese 2008 kishte të bënte me zgjedhjen e Presidentit të Republikës dhe mbi pozitën e Kryeministrit ndaj parlamentit. Nga modeli i zgjedhjes së Presidentit me shumicë të cilësuar u kalua me zgjedhje me shumicë të thjeshtë në dy raundet e fundit, duke e ulur ndjeshëm peshën dhe rolin e Presidentit në jetën politike dhe institucionale. Ndryshimi tjetër i dha mundësi kryeministrit të zgjerojë kontrollin mbi parlamentin përmes mocionit konstruktiv, sipas të cilit, kryeministri me mocion besimi mund të provokojë në cdo kohë zgjedhje të parakoshme dhe se shkarkimi me mocion mosbesimi bëhet teknikisht thuajse i pamundur. Ndryshimi kushtetues solli ndryshim edhe në jetën politike dhe institucionale, duke krijuar intepretime mbi shanset reale për garantimin e parimeve kushtetuese të transparencës, ndarjes dhe balancës së pushteteve.

Në shtator 2012 Kuvendi ndërhyri përsëri në Kushtetutë për të bërë ndryshime në termat që lidhen me heqjen e imunitetit për deputetët dhe zyrtarët e lartë. Nisma ishte kryesisht kërkesë ndërkombëtare dhe palët politike e përdorën atë për të treguar vullnet në masat institucionale kundër korrupsionit. Në praktikë, tre vjet pas këtyre ndryshimeve asgjë nuk ka ndryshuar në raport me akuzat që iu bëhen zyrtarëve të lartë për korrupsion dhe se vetë nisma, u provua se ishte më shumë politike sesa institucionale.

Oferta e përhershme, - ndërhyrje në kushtetutë

Prej vitit 2012 kanë kaluar 3 vjet të tjera dhe ende cdo mazhorancë politike vijon të ketë premtim periodik nevojën për ndërhyrje në kushtetutë për jetësimin e reformave në disa sektorë me mbrojtje kushtetuese. Palët politike dhe ekspertët bashkohen në vlerësimin se reformat në drejtësi janë të pamundura pa ndërhyrje në kushtetutë, ndërkohë që ndërhyrjet shihen si zgjidhje edhe për një rishikim të

formulës së zgjedhjes së presidentit, të disa kompetencave dhe sidomos formave zgjedhore në drejtim të disa institucioneve kushtetuese që zgjidhen në parlament, deri edhe tek ndërhyrja për të mundësuar reformën territoriale apo një ndryshim më cilësor dhe më përfaqësues të sistemit zgjedhor.

Gjatë vitit elektoral 2013 dhe vitit të fundit (2014) pothuajse të gjitha partitë kryesore politike si dhe një numër zyrtarësh të lartë politikë kanë paralajmëruar nisma specifike për ndërhyrje në Kushtetutë. Mazhoranca e majtë në qeveri u zgjerua me aleatë të rinj nga opozita duke arritur numrin e 84 deputetëve, të nevojshëm për të votuar edhe ndryshime kushtetuese. Një sërë ligjesh organike ose nisma të ekzekutivit u anulluan nga Gjykata Kushtetuese me argumentin se ato bien ndesh me kushtetutën dhe për pasojë, jetësimi i tyre do kërkonte indirekt edhe ndryshime në vetë përcaktimet dhe normat kushtetuese.

Midis debatuesve, kryesisht drejtues politikë dhe të institucioneve kryesore, është krijuar bindja se një sërë reformash do kërkojnë domosdo prekjen e kushtetutës. Dallimi midis palëve gjendet vetëm në terma konkretë të ndryshimit, - një palë që kërkon ndryshime për të jetuar reformat që ajo premton se do realizojë dhe një palë tjetër që i sheh ndryshimet e propozuara të lidhura me interesa elektoralë e politikë të ditës. Dy palët bien dakord se në aspektin afatgjatë Kushtetuta ka nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime, dhe se eksperimenti i produktit të ndryshimeve kushtetuese 2008, nuk solli rezultate të pritshme pozitive.

Me ndryshimin e strukturës administrative të vendit (2015) ka mbetur në fuqi institucioni i qarkut, i cili, pranohet nga cdo palë politike dhe aktor publik, se është i tepërt, jo efikas dhe duhet shfuqizuar. Për shkak se reforma territoriale nuk pati konsensus politik, edhe ndryshimet kushtetuese referuar qarkut, nuk gjetën konsensus të gjerë politikë. Tradita, sipas të cilës ndërhyrjet në kushtetutë përdorën e keqpërdoren nga palët politike për ndërhyrje shtesë në elementë që lidhen me interesat politike afatshkurtra, vijon të jetë dominuese edhe në Shqipërinë e vitit 2015.

Ndërkohë, procesi i integrimit të vendit dhe detyrimet shtetërore që burojnë prej tij nxjerrin në pah nevojat e rishikimit të disa elementëve dhe praktikave kushtetuese, sidomos referuar cështjeve të sigurisë dhe angazhimeve ndërkombëtare të vendit. Krahas tyre, ekzistojnë edhe detyrime kushtetuese, për shembull, nevoja për ligje organike për institucionet kushtetuese, të cilat megjithëse citohen në dokumentin kushtetues të vitit 1998, ende nuk janë miratuar dhe as nuk janë pjesë e axhendës afatshkurtër parlamentare.

Tabela mbi kushtetutat shqiptare përgjatë një shekulli paraqet të dhëna mbi format e qeverisjes, numrin e neneve të secilës kushtetutë, datën e hyrjes në fuqi dhe fundin e saj, si dhe vitet e jetëgjatësisë. Pjesa e fundit e tabelës ilustron mënyrën e miratimit të kushtetutës. Referuar të dhënave të trajtuara në tabelë, Kushtetutat më jetëgjata janë ato të periudhës komuniste, ndjekur nga Kushtetuta e peridhës së monarkisë dhe më pas ajo e tranzicionit në Shqipëri. Duke iu referuar retrospektivës dhe tabelës së dokumenteve kushtetuese përgjatë 100 viteve mund të arrihet në disa përfundime dhe vlerësime me rëndësi. Studiuesi gjerman Schmidt-Neke llogarit se koha mesatare e ekzistencës dhe jetëgjatësisë së një dokumenti kushtetues ka qenë 7.8 vjet. Referenca e tij përmbledh nga ana formale të gjitha periudhat dhe emërtimet e dokumenteve kushtetuese, por nëse i referohemi faktit se kushtetutat e periudhës komuniste ishin më jetëgjatat për shkak të vetë sistemit brutal që prodhuan, mesatarja kushtetuese e modeleve demokratike është shumë më e vogël sesa mesatarja shekullore e secilit model kushtetues.

Referuar madhësisë së dokumenteve kushtetuese, ato të periudhës së Mbretit Zog dhe të Princ Wied janë dukshëm më të mëdha dhe më të detajuara sesa ato të cdo periudhë tjetër shtetërore. Tabela mbi kushtetutat shqiptare dëshmon se shteti shqiptar është qeverisur jo vetëm me dokumente kushtetuese, por edhe me dokumente tranzicioni, kryesisht Kanunore dhe Rregullore të institucionit më të lartë drejtues, kryetarit të shtetit, ose të kalimit të

autoritetit drejtues tek një organ tjetër tranzicioni, si në modelin e KANC. Gjatë periudhave të ndryshme, sidomos ndryshimeve të mëdha historike, vihen re bashkëjetesa midis dy formave të ndryshme qeverisëse dhe kushtetuese, ndonjëherë edhe të kundërta (1944 apo 1991), apo periudha pa dokument kushtetues dhe institucione kushtetuese (1914-1920), periudha të formalitetit kushtetues përballë një pushteti ekstra kushtetues (1944-1976), etj.

Në 100 vjet vetëm një kushtetutë është miratuar me referendum popullor (1998), por edhe ky dokument është ndryshuar disa herë pa lejuar votimin e ri përmes referendumit, por në mënyrë të njëanshme, nga parlamenti. Kushtetuta 1998 megjithëse mori votën e qytetarëve vlen të theksohet se ishte gjithsesi produkt i njëanshëm besimi, për shkak se vetëm një palë politike mori pjesë në votime dhe votoi pro ose kundër draftit kushtetues. Në bilancin shekullor kemi kushtetuta që vijnë ose imponohen nga fuqi jashtë nesh (1914 apo 1939), kushtetuta që janë imitime të modeleve të gatshme politike (1946 dhe 1950), kushtetuta eksperimentale (1920 dhe 1922), kushtetuta unike (1925 apo 1976), si dhe modele kushtetuese bazuar në norma të pranuara si standarde pozitive (1991, dhe sidomos 1998), etj.

Konkluzione

Kushtetuta dhe nocionet kushtetuese në jetën politike, institucionale dhe publike në Shqipëri janë përballur po me ato tipare të vetë vlerave të sistemit demokratik: mosnjohje, traditë të brishtë, krijimin e liderëve të fortë në vend të institucioneve të forta dhe kritika mbi legjitimitetin dhe produket konkrete të tij. Për shtet me traditë kushtetuese është më e lehtë analiza e rolit të Kushtetutës, por për një vend në traditë të brishtë kushtetuese si Shqipëria, studimet kushtetuese janë më shumë studimeve të eksperimenteve kushtetesa sesa mbi nocione, praktika dhe evoulime të tyre.

Natyra eksperimentale e sistemit tonë kushtetues është ndikuar edhe nga eksperimentimet në format e qeverisjes dhe

modelin qeverisës, në importin nga jashtë të formave të ndryshme dhe në tendencën për ta përshtatur sistemin politik me kushtetutën, jo e anasjellta. Kritikat e vazhdueshme, psh, se partitë shqiptare kanë më shumë pushtet sesa u njeh kushtetuta, se hapësira të intepretueshme në Kushtetutë përdoren e keqpërdoren nga politika e ditës për të justifikuar akte të njëanshme politike të tyre dhe se brishtësia e sistemit përfaqësues buron nga vetë brishtësia e nocioneve, normave dhe institucioneve kushtetuese, - janë tregues se Kushtetuta, megjithë progresin, ende nuk është bërë pikë referimi e pakontestueshme nga politika dhe qytetarët.

Tendenca pozitive e viteve të fundit për një numër të madh praktikës kushtetuese në politikë, për adresim në Gjykatën Kushtetuese në emër të mbrojtjes së parimeve kushtetuese, apo shenjat e reagimit civil e qytetar në mbrojtje të normave të vecanta kushtetuese, janë një sinjal pozitiv dhe inkurajues për forcimin e kulturës së ligjit, dhe respektin ndaj Kushtetutës së RSH.

Ne vijim shih tabelen:

TABELA E DOKUMENTEVE KUSHTETUESE NË SHQIPËRI NË 100 VJET

Nr	EMËRTIMI I KUSHTETUTËS	QEVERISJA	NENE	MIRATIMI	ANULIMI	VITE	ORGANI MIRATUES
1	Statuti Organik i Shqipërisë	Principatë	11	29.07.1913	10.04.1914	1	Konferenca e Londrës
2	Statuti Organik i Principatës	Principatë	216	10.04.1914	31.01.1920	1 (6)	KNK dhe Princi
3	Statuti i Lushnjes	Principatë	6	31.01.1920	08.12.1922	2	Kuvendi Kombëtar
4	Statuti I Zgjeruar i Lushnjes	Principatë	129	08.12.1922	02.03.1925	3	Këshilli Kombëtar
5	Statuti Themeltar i Republikës	Republikë	142	02.03.1925	01.12.1928	3	Asambleja Kombëtare
6	Statuti themeltar i Mbretërisë	Monarki	234	01.12.1928	22.10.1943	11	Parlamenti
7	Statuti Themeltar i Mbretnisë	Monarki	54	03.06.1939	22.10.1943	4	Asambleja Kombëtare
8	Rregullore për Këshillin e Naltë	Monarki	15	22.10.1943	27.04.1944	1	Kuvendi Kombëtar
9	Rregullore e KANÇ	Pa formë	6	27.04.1944	14.03.1946	2	Këshilli Antifashist NÇ
10	Statuti i Republikës Popullore	Republikë	96	14.03.1946	05.07.1950	4	Asambleja Kombëtare
11	Kushtetuta e Republikës Popullore	Republikë	98	05.07.1950	28.12.1976	26	Kuvendi Popullor
12	Kushtetuta e R Popullore Socialiste	Republikë	112	28.12.1976	29.04.1991	15	Kuvendi Popullor
13	Dispozita Kryesore Kushtetuese	Republikë	46	29.04.1991	28.11.1998	7	Kuvendi Popullor
14	Kushtetuta e Shqipërisë	Republikë	183	28.11.1998	21.04.2008	10	Referendum
15	Kushtetuta e Shqipërisë	Republikë	183	21.04.2008	-		Kuvendi

Bibliografia

1. Anastasi, Aurela. "E drejta kushtetuese", Tiranë, 2000.
2. Anastasi, Aurela. "Institucionet politike dhe e drejta kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)", Tiranë, 1998.
3. Biberaj, Elez. "Albania in Transition: The Rocky Road to Democracy". USA, 1998.
4. Dervishi, Kastriot. "Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005", Tiranë, 2006.
5. Diskutime. "Debati parlamentar para një shekulli...", Tiranë, 2008.
6. Diskutime. "Opozita dhe mbreti i ardhshëm i Shqipërisë", Tiranë, 2008.
7. Elezi, Ismet. "Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri", Tiranë, 1998.
8. Fischer, Bernd. "The Development of the Modern Albanian State." ICHS, Australia, 2005.
9. Grup autorësh. "Historia e shtetit të së drejtës në Shqipëri", Tiranë, 2006.
10. Grup autorësh. "Historia e Shqipërisë", Akademia e Shkencave, Tiranë, 2007
11. Loloçi, Krenar. Hyrje në "Debati Kushtetues", Tiranë, 2006.
12. Loloçi, Krenar. "Kushtetuta e re dhe nevoja për një mentalitet të ri", Tiranë, 2002.
13. Omari, Luan. "Probleme të rendit kushtetues", Leksione, Magis, Tiranë, 2006.
14. Omari, Luan. "Sistemi parlamentar". Parlamenti në Shqipëri, Tiranë, 2004.
15. Pollo, Stefanaq. "Në gjurmë të historisë së Shqipërisë".Akademia e Shkencave,Tiranë, 2003.
16. Roka, Roberto Moroco. "Kombi dhe feja ne shqiperi" (1920-1944), Tirana, 1994.

17. Zaganjori, Xhezair. "Demokracia dhe shteti i së drejtës". Tiranë, 2002.

18. Statuti Organik i Shqipërisë, Tiranë, 1914.
19. Statusi i Lushnjës, Tiranë, 1920.
20. Zgjerimi i Statusit të Lushnjës, Tiranë, 1922.
21. Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare, Tiranë, 1925.
22. Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare, Tiranë, 1928.
23. Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare, Tiranë, 1939.
24. Kushtetuta e Republikës Populllore të Shqipërisë, Tiranë,1946.
25. Kushtetuta e Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1976.
26. Dispozitat Kryesore Kushtetuese të RSH, Tiranë, 1991.
27. Kushtetuta e Shqipërisë, Tiranë, 1998.

POMEN IN ZNAČILNOSTO VOLITEV

Dr. Franc Grad

Neposredna in posredna demokracija

Sodobne demokracije temeljijo na načelu ljudske suverenosti, po katerem je nosilec suverene oblasti v posamezni družbeno urejeni skupnosti lahko samo ljudstvo. Z načelom ljudske suverenosti se izraža zamisel o tem, da vsa oblast v državi izhaja iz ljudstva in pripada ljudstvu ter da nosilci oblasti delujejo kot predstavniki ljudstva. Iz načela ljudske suverenosti izhaja načelo demokratične države. Demokratična je tista državna ureditev, v kateri vsa oblast izhaja iz ljudstva in se izvaja v njegovem interesu. V demokraciji torej lahko vladajo le tisti, ki jih je izvolilo ljudstvo, kateremu so tudi odgovorni.

Znotraj načela demokratične države razlikujemo dva temeljna načina izvrševanja ljudske suverenosti: posredno in neposredno. Ljudstvo torej lahko uresničuje oblast tako da samo neposredno izvršuje vse ali nekatere njene funkcije (neposredna demokracija), ali da voli svoje predstavnike, preko katerih bo neposredno izvrševalo oblast (posredna demokracija oziroma politično predstavništvo).
Neposredna demokracija je v praksi dokaj redka, v veliki meri je prakticirajo le nekatere države, zlasti Švica. Pogosto neposredno odločanje je namreč povezano z velikimi organizacijskimi težavami in stroški. Na drugi strani je večina zadev, o katerih se odloča v državi tudi preveč zapletenih, da bi lahko o njih odločali volilci sami.

Zaradi tega prevladuje v svetu posredna demokracija, torej demokracija, pri kateri sprejemajo temeljne odločitve osebe, ki jih ljudstvo izvoli v ta namen. To so predstavniki ljudstva, ki skupaj tvorijo predstavniško telo. Predstavniško telo torej sprejema odločitve v

imenu ljudstva, ki ga njegove odločitve vežejo. Tako demokracijo imenujemo zato predstavniška demokracija za razliko od neposredne demokracije, kjer sprejema odločitve neposredno ljudstvo. Razmerje med ljudstvom in njegovimi izvoljenimi predstavniki pa imenujemo politično predstavništvo. To temelju na mandatu (pooblastilu), ki ga ljudstvo z izvolitvijo podeli svojim predstavnikom v predstavniškem telesu.

Volitve so v sodobnem pojmovanju demokracije eden najpomembnejših izrazov ljudske suverenosti in nujni pogoj za demokratično oblikovanje najpomembnejših državnih organov, zlasti predstavniškega telesa. Zato so demokratične volitve tudi nujni pogoj za vzpostavitev in ohranitev sodobne pravne države. Volitve omogočajo volilcem neposreden vpliv na sestavo parlamenta, s tem pa tudi posreden vpliv na odločitve, ki jih ta sprejema. Z volitvami volilci podelijo članom parlamenta mandat, pooblastilo za to, da odločajo v njihovem imenu o najpomembnejših družbenih vprašanjih. Zato volitve dajejo legitimnost izvajanju oblasti s strani predstavniškega telesa. Volitve torej dajejo vladajočim temelj oziroma naslov za izvajanje oblasti.

Čeprav so se volitve kot oblika sodelovanja širšega ali ožjega kroga državljanov pri oblikovanju organov oblasti pojavljale v demokratičnih političnih sistemih že v prejšnjih zgodovinskih obdobjih, so vendar dosegle višek in polno potrditev šele v političnem sistemu buržoazne predstavniške demokracije. Poglavitna ideja, na kateri je temeljilo zanikanje fevdalne države in utrditev buržoazne demokracije, je bila ideja o suverenosti ljudstva, o tem, da oblast izhaja iz ljudstva in pripada ljudstvu. Idejo o suverenosti ljudstva je bilo mogoče uresničiti samo v taki obliki organizacije državne oblasti, ki je zagotavljala trajen in organiziran vpliv družbe na državno oblast - torej v demokraciji. Čeprav se je radikalni teoretik francoske buržoazne revolucije Rousseau zavzemal za uresničevanje ideje o suverenosti ljudstva v neposredni demokraciji, se je buržoazna demokracija razvila skoraj

izključno kot predstavniška, to je posredna demokracija.

Z izvolitvijo dobijo predstavniki ljudstva v parlamentu pooblastilo za sprejemanje odločitev v parlamentu. To pooblastilo se imenuje poslanski mandat in njegova vsebina je ureditev razmerja med volilci in njihovimi predstavniki v parlamentu. Vsebina tega razmerja se nanaša predvsem na vprašanje, ali je poslanec vezan na stališča in navodila svojih volilcev, ali pa ga ta navodila ne zavezujejo in je v celoti neodvisen od kakršnihkoli smernic in napotkov. Glede na pravno naravo mandata sta poznani predvsem dve vrsti mandata članov predstavniških teles: imperativni in reprezentativni mandat.

Imperativni ali vezani mandat pomeni, da je izvoljeni predstavnik v parlamentu samo pooblaščeni zastopnik volilnega telesa in mora v celoti ravnati po navodilih tega telesa. Za svoje delo je odgovoren volilcem, volilci imajo pravico nadzora nad njegovim delom in ne nazadnje pravico odpoklica, če z njim oziroma njegovim delom niso zadovoljni.

Reprezentativni mandat pa pomeni, da izvoljeni člani predstavniškega telesa ne predstavljajo posameznih volilcev, ki so jih izvolili, niti volilne enote, v kateri so bili izvoljeni, pač pa ljudstvo kot celoto. Zato ne odgovarjajo volilcem za svoje delo in volilci jih tudi ne morejo odpoklicati.

Reprezentativni mandat poslancu omogoča, da ravna v skladu s svojo vestjo in prepričanjem in da je pravno neodvisen od političnih strank in drugih zunaj parlamentarnih formalnih in neformalnih združenj in posameznikov. Vendar pa v praksi politične stranke nadzorujejo in usmerjajo delo poslancev, zato poslanci niso več vezani na volilce (kot pri imperativnem mandatu), vendar niso dejansko neodvisni (kakor bi morali biti po reprezentativnem mandatu).

Volitve in volilno telo

Volitve so lahko dobile svoj sedanji pomen šele z uveljavitvijo sodobnega parlamenta kot predstavniškega telesa. Na drugi strani se je tudi parlament lahko uveljavil kot predstavniško telo šele, ko je dobil široko volilno osnovo, se pravi, ko se je volilna pravica razširila od ozkega sloja do vseh odraslih državljanov[77]. V razvoju sodobnega parlamentarizma je odigrala pomembno vlogo stara srednjeveška stanovska skupščina, ki se je kot parlament spremenila v splošno predstavniško telo, ki ga volijo državljani kot enakopravni volilci, razdeljeni v volilne enote. Vsi volilci skupaj tvorijo volilno telo, ki je demokratična osnova oblasti parlamenta. Volilne enote morajo biti praviloma približno enako velike, zato da je vsak državljan približno enako predstavljen v parlamentu, čeprav le kot del enotnega volilnega telesa.

Po koncepciji splošnega političnega predstavništva namreč parlament predstavlja voljo in interese celotnega ljudstva (ne pa posameznih lokalnih ali drugačnih skupin).
Člani predstavniškega telesa dobijo to funkcijo z izvolitvijo. Iz same koncepcije predstavniške demokracije izhaja, da se politični sistem predstavniške demokracije lahko obnavlja le z volitvami, ki so najpomembnejši akt, s katerim ljudstvo uresničuje svojo suverenost. V sodobnih političnih sistemih so zato volitve splošno sprejeta demokratična osnova in tipični način konstituiranja in osnovanja političnega predstavništva.

Z demokracijo so neločljivo povezane politične pravice posameznika. Politične pravice državljanov se namreč uresničujejo v demokraciji, po drugi strani pa ni mogoče uresničiti demokracije brez politične svobode posameznika, ki mu omogoča politično delovanje. Med političnimi pravicami posameznika je nedvomno ena

---

[77] O teoretičnih in političnih vidikih širitve volilnega telesa glej: Gaber S., Predstavništvo in demokracija v: Volilni sistemi (Zbornik), Krt, Ljubljana 1996, str. 7 do 21

najpomembnejših ravno volilna pravica, ker omogoča organizirani in institucionalizirani vpliv posameznika na vzpostavitev in delovanje temeljnih državnih organov.

Glede na to ali ima volilec na volitvah možnost izbirati med različnimi osebami oziroma med različnimi političnimi pogledi (ki so utelešeni predvsem v političnih strankah) lahko ločimo kompetitivne oziroma nekompetitivne volitve[78]. Nekompetitivne volitve so lahko posledica normativne ureditve, mogoče pa so tudi v normativni ureditvi, ki formalno dopušča kompetitivne volitve, vendar so dejansko onemogočene zaradi političnih odnosov v državi.

Pogosto se iz podobnih razlogov razlikujejo svobodne oziroma nesvobodne volitve. Značilno za prvi tip volitev je enakopravno tekmovanje različnih oseb oziroma političnih strank na volitvah ter svobodna izbira volilca med njimi. Za drugi tip pa je značilno ravno nasprotno: privilegiran položaj ene ali nekaj strank, celo obstoj ene same stranke, kar že samo po sebi onemogoča svobodno izbiro volilcev. Za to, da lahko govorimo o svobodnih volitvah, pa kaže upoštevati še druge družbene pogoje. Tako Mackenzie[79] navaja med temeljnimi pogoji neodvisno sodstvo, ki razlaga volilne predpise, poštea nestrankarska državna uprava, ki vodi volitve, razvit sistem političnih strank, ki so tako dobro organizirane, da so sposobne predložiti svoje politične poglede volilcem v izbiro ter določena, vnaprej znana pravila igre pri volitvah, ki omejujejo boj za oblast in jih družba splošno sprejema.

Gre torej za pravne in politične dejavnike znotraj, kot tudi izven samih volitev, ki pa odločilno vplivajo na samo naravo volitev.

1.3. Volitve in predstavniško telo

[78] *Nohlen D., Izborno pravo i stranački sustav, Školska knjiga, Zagreb 1992, str. 16 do 23*

[79] *Mackenzie W.J.M., Free Elections, Allen&Unwin Ltd., Liverpoool 1958, str. 14*

V sodobnih demokracijah se neposredno voli predstavniško telo, redkeje tudi šef države. Zato so – tako s teoretičnega kot tudi s praktičnega vidika - najpomembnejše volitve predstavniškega telesa. Predstavniško telo je kolegijski (zborni) organ, ki predstavlja ljudi v neki skupnosti (državi, lokalni skupnosti) in je praviloma voljen. Tako telo včasih predstavlja le del take skupnosti (stanove, interesne skupine in podobno), vendar najpogosteje predstavlja vse člane skupnosti in se zato imenuje tudi splošno predstavniško telo.

Na državni ravni navadno rabimo izraz predstavniško telo za tisti državni organ, ki predstavlja ljudstvo kot celoto in sprejema najpomembnejše odločitve državne oblasti. Gre torej za organ, ki je oblikovan tako, da predstavlja državljane in je v njem utelešena volja ljudstva kot suverena. Ker ta organ praviloma opravlja zakonodajno funkcijo kot svojo najpomembnejšo funkcijo, se imenuje tudi zakonodajno telo[80].

V ustavnih ureditvah po svetu sta znana tako enodomno kot tudi dvodomno predstavniško telo, redko večdomni parlament. Res je sicer, da je v zahodnih demokracijah pogost dvodomni parlament (v glavnem ga nimajo manjše države) in da je za ureditve novejših držav bolj značilen enodomni sistem, vendar so razlogi za dvodomnost tako različni, da ni mogoče iz njih izluščiti splošno veljavnega pravila. To velja v celoti za unitarno državo, kateri v enaki meri ustreza en ali drugi tip parlamenta. Pač pa je v naravi zvezne države, da ima dvodomen parlament. V federaciji namreč en dom predstavlja državljane celotne zvezne države ne glede na federalno enoto, drugi dom pa predstavlja federalne enote. Tudi v unitarni državi vedno velja pravilo, da prvi dom predstavlja vse ljudstvo (splošno predstavniško telo), drugi dom pa navadno različne posebne družbene interese.

Ker se šteje prvi dom parlamenta za predstavnika vsega ljudstva je v

---

[80] Več o opredelitvi in položaju predstavniškega organa glej: Grad F., Parlament in vlada, ČZ Uradni list, Ljubljana 2000, str. 73 do 81

sodobnih demokracijah voljen neposredno, na podlagi splošne in enake volilne pravice. Tudi drugi dom se v sodobnih demokracijah praviloma oblikuje z volitvami. Vendar pri drugem domu volilno načelo ni tako dosledno kot pri prvemu. Dom Lordov v Veliki Britaniji se še sedaj tradicionalno oblikuje brez volitev, delno pa se brez volitev oblikujejo tudi drugi sodobni primeri drugega doma, čeprav je ta način v glavnem že opuščen. Ti načini so različni. Pretežni del Doma Lordov npr. predstavljajo (oziroma so še do nedavna predstavljali) člani, ki so to po svojem (večinoma dednem) položaju, druge pa lahko v tak položaj povzdigne kralj. Drugi primer neizvoljenega drugega doma je Senat Kanade ki ga imenuje vlada (formalno sicer generalni guverner) in naj bi zastopal interese federalnih enot Kanade. Ponekod pa se drugi dom sicer praviloma oblikuje z volitvami, del članov pa tudi na druge načine. Italijanski senat se npr. praviloma oblikuje z volitvami, vendar pa je dosmrtni senator, kdor je bil predsednik republike, pet članov pa lahko imenuje predsednik izmed zaslužnih državljanov.

Opuščanje nevolilnega oblikovanja drugega doma je povezano s sodobnim pojmovanjem predstavniške demokracije, po katerem lahko odloča v imenu ljudstva le telo, ki predstavlja ljudstvo, ki je torej izvoljeno. Zato neizvoljeno telo ne more imeti take avtoritete kot izvoljeno telo. Volilna osnova drugega doma je nedvomno pomemben odraz njegove demokratizacije in posodobitve.

Çabej shkruan se "një vëmendje të vecantë meriton ai divi vigan e me një sy në ballë, që del shpesh nëpër përrallat e shqiptarëve, të serbëve, të morlakëve e të së tjerëve popuj të Ballkanit po edhe në vise të tjera të Europës gjer lart në Finlandë. Është figura e atij kiklopi që ha njerëz, sikurse na shfaqet që te Odiseja e Homerit me emrin Polifem (...). Është për të vënë re që kjo figurë në shekullin e kaluar ishte gjallë edhe tek elementi arbëresh i Siqelisë, sikurse shihet nga një mbledhje e gjuhëtarit italian D. Compareti. Sikurse e vuri re G. Meyeri, tek emri i këtij divi të egër ruhet kujtimi i kompanisë së mercenarëve nga Katalanja e Spanjës, të cilët hynë më parë (më 1302) në shërbim të perandorit bizantin Andronik II Paleologut e më pas, si kusarë deti, ranë pre për disa kohë nëpër Gadishull të Ballkanit. Ky gjigand në Shqipëri përfytyrohet si një farkëtar div i palatuar, me një sy në ballë, pa gjunjë e me këmbë të drejta si dyrek. Po të sillemi nga jugu i Shqipërisë do të shohim se kjo figurë divi e cila na del sidomos në Labëri (kujtojmë edhe gojëdhanën e Gjeçovit këtu – shën imi), mban një emër vendi e quhet Siqënhenjeri. Ky emër që në formimin e vet është një bashkim dy kompozitesh, me kuptimin "syqen" që ha njerëz", paraqet interes edhe për folklorin". Le ta shohim shpërndarjen e kësaj figure mitologjike përsëpari në traditat folklorike rrotull nesh. Ky lloj qiklopi te bullgarët quhet "ednook" (me një sy), ndërsa te rumunët thirret "ochila" dhe lidhet poashtu me syun. Të njejtat veçanti demonologjike ka edhe kensa që në përrallat serbe e kroate thirret "psoglavi, pasoglavci" e që don me thënë "kryeqen, kokëqen". Sikundër vëren Çabej, këto figura Çajkanoviçi "objektivisht

e gjuhësisht i afron me greqishten 'kunokefaloi' dhe sheh aty një kryqëzim figurash të besimeve orientale me demonët kufomë-ngrënës të disa popujve indoeuropianë". Këtij vargu krahasimesh mund t'i shtojmë edhe apelativin bullgar "pesoglaveca" dhe atë rumun "capcaun", që duan të thonë poashtu "kryeqen" dhe dalin si demonë që hanë mish njeriu. Vijon Çabej: "Është afërmendsh të mendohet në këtë mes që këto emra të gjuhëve slave e të rumanishtes të jenë të jenë përkthime (calques linguistiques) të greqishtes "kunokefaloi", si reflekse të ndikimit bizantin në ato gjuhë. Përsa i përket Syqenit e Syqenëzës të shqipes, këto, si figura, për vetinë antropofage që kanë, hyjnë pas gjithë gjasash edhe këto në këtë grup demonësh. Nga pikëpamja e formimit gjuhësor ndërkaq këto largohen nga figurat në fjalë të popujve fqinj sepse janë emërtuar nga një krahasim me sytë e jo me kokën e qenit". Mëtojmë ta shtyjmë mendimin, duke parë të shkrirë në një disa veti kensash që i përgjigjen të njëjtës figurë demoniake: syun e vetëm si tipar të cilin e vëmë re te Katallajtë (Kiklopes) me qenin që ha njerëz më anë tjetër. I do mëshuar faktit se gjetje të tilla në kulturat vernakulare janë tejet të rëndësishme, pasi ato nuk janë thjesht elemente përrallash. Sikundër vëren Max Müller, në kohët e lashta, figura të tilla të teogonisë ishin qeverisja e jetës së përditshme, e mandej me kalimin e njerëzimit nga besimi politeist në atë monoteist, ato u bënë thjesht pjesë e folklorit në trajtë përrallash e legjendash.

Si u shestuan këto figura në folklorin tonë dhe në atë rrotull nesh, le të vërejmë cfarë shkruhet në burimet historike mbi apelativët e lartpërmendur. Izidori i Siviljes (560-636 pas Krishtit), në vëllimin e tij Etimologie XI, 3 shkruan: "Sikundër mes njerëzve vërehen edhe individë të deformuar, ashtu edhe brenda farës njerëzore të vëzhguar në tërësinë e vet, ekzistojnë fise të përbëra nga përbindësha, sikundër janë Gjigandët, Cinoqefalët (Kokëqentë), Qiklopët dhe të tjerë të ngjashëm". Edhe për Strabonin dhe Plin Plakun ekzistonin popuj të tillë, të thirrur Cynamolgi dhe banonin në Etiopi, ndërsa tek Tertuliani dalin si Cynopennae dhe ai i vendos në Persi. Kryeqentë

vijojnë të dalin edhe në historiografinë mesjetare. Kleriku Hyon de Narbonne, në një letër dërguar arqipeshkvit të Bordosë, Gerardus de Malemort, përshkruan rrethimin që i bënë tartarët qytezës Wiener Neuestadt. Dhe kur flet mbi mizoritë e tartarëve, ai thotë se prijësat e tyre kanë Cinoqefalë (Kryeqenë) në radhët e veta, të cilëve u japin të hanë trupat e robërve të luftës.
Figura e Kryeqenit, mesa duket tejet e ngulët në besimin e popujve, mbërrin të kapërcejë edhe në hagjiografinë e krishterë. Në mjaft ikona e afreske bizantine, Shën Kristofori paraqitet me shembëlltyrën e një Cinoqefali (Kryeqeni). E po ashtu në Passio sancti Christophori martyris, tekst i cili pati një përhapje të madhe në Mesjetë, Shën Kristofori përshkruhet si një gjigand i llojit të Kryeqenve, i cili u konvertua pasi barti me mundim mbi supe Krishtin fëmijë nga njera anë e lumit në tjetrën.

Pas vëzhgimesh të tilla, bëhet edhe më e qartë pse rrëfenjat me Qiklopë e Katallaj kanë mbërritë të patrazuara deri në kohë të Gjeçovit, e sidomos bëhet edhe më i domosdoshëm rishqyrtimi i krejt trashëgimisë së tij mitologjike duke e krahasuar pa reshtur me arealin ku kultura jonë bën pjesë.

Këtu u ndalëm vetëm në njerën nga thërmijat e "Trashëgimisë Thrako-Ilirjane" të Gjeçovit, porse korpusi i tij përmban shumë mbledhje të këtilla, të shestuara si pikëpremje mes mitit dhe historisë. Gjejmë aty përralla, doke e zakone të lashta të gjindjes sonë, përshkrime të kostumografisë popullore, të tatuazheve për të cilat shtyhet thellë-thellë në kohë, gjejmë përshkrime të betimeve mbi gur e mbi rrufe, ligje e mënyra caktimi kufijsh e trojesh, nderimin e malësorëve tanë ndaj Diellit duke bërë kryq në ballë e gjithë çka janë rregullat e jetës zakonore të një populli që beson në Zot e ruan traditat. Ky korpus e bën Gjeçovin themeluesin e Etnografisë Shqiptare. Ky korpus i rishqyrtuar është edhe elementi integrues i kulturës sonë kombëtare.

GJURMË TË LAMBERTZIT NË MBLEDHJEN DHE STUDIMIN E FOLKLORIT SHQIPTAR

Dr. Rovena Vata

Kontributi i Lambertzit në mbledhjen dhe studimin e folklorit shqiptar
Në veprimtarinë shkencore të Maximilian Lambertzit një vend kryesor zënë botimet rreth folklorit, e veçanërisht rreth poezisë popullore në vëzhtrimin më të gjerë të kësaj fjale.
Shkrimet e tij nuk janë përfundimet e shpejta të kërkimeve të rastit, ato janë pema e pjekur e përpjekjeve e shumëvjeçare e me dashuri të madhe për lëndën.
Monografia *"Poesia popullore e Shqiptarëvet, një studim hyrjeje"* dolli së pari te gazeta "Posta e Shqypniës" e pastaj si libër më vete. Është i pari botim përmbledhës që kemi për këtë temë. Në të trajtohen farët e ndryshme të këngëvet, si këngë trimash, këngë dashurie, këngë dasme, këngë vargje fëmijësh, ligje e vajtime, përralla, gojëdhëna etj. Shqyrtohet ndër të tjera metrika e këngëvet dhe mënyra e recitimit të tyre nga ana e këngëtarëve[91].
Lambertzi u mor thuajse me të gjitha format e shfaqjes së traditës gojore: në poezi e në prozë, me përrallën, këngën rituale, eposin heroik legjendar, të cilit i kushtoi studimin "*Epika popullore e shqiptarëve*" - "*Die Volksepik der Albaner*" (Halle 1958), një prej monografive më të rëndësishme të traditës së studimeve për ciklin e kreshnikëve, përkthyer për nevojat e studiuesve prej gjuhëtarit shqiptar E. Çabej në vitet 1970 dhe mbetur në arkivat e instituteve të trashëgimisë deri në fundin e shekullit të kaluar.
Nga gjinitë poetike, përveç përrallës e legjendës gjurmohet sidomos poesia epike e poesia lirike: kënga heroike bashkë me teknikën epike, me krahasimet e dendura e me vargjet si hyrje që kanë lidhje me

[91] *Eqrem Çabej, Studime gjuhësore V,Rilindja, Prishtinë, 1975, f. 174.*

natyrën, pastaj kënga e dashurisë dhe kënga e dasmës, vajtimi, këngët e fëmijëve, vargjet e numërimit, këngëzat e motit e të shiut etj[92].

Siç shprehet edhe profesor Eqrem Çabej ku nënvizonte se studimet lambertziane kanë qenë fokusuar rreth folklorit shqiptar, kryesisht përrallave dhe eposit popullor shqiptar, mitologjisë, epikës, baladave, gojëdhënave, këngë të trimërisë, të dashurisë, të dasmave, ligjeve e vajeve.

Disa prej veprave më të rëndësishme të M. Lambertz-it në dijet albanologjike janë: "*Albanische Märchen und andere Texte zur albanischen Volkskunde*" - "*Këngë shqiptare dhe tekste nga folklori shqiptar*" (Ëien 1922); "*Gjergj Fishta und das albanische Heldenepos 'Lahuta e Malcís'*" - "*Gjergj Fishta dhe epopeja e madhe shqiptare 'Lahuta e Malcís'*" (Leipzig 1949). Ai shkroi një studim për këngët popullore shqiptare ("*Die geflügelte Schëester und die Dunklen der Erde: albanische Volksmärchen*" - Eisenach 1952); dhe një tjetër për letërsinë shqipe ("*Albanien erzählt: ein Einblick in die albanische Literatur*" - Berlin 1956). Gjithashtu përktheu pjesë nga "*Lahuta e Malcís*" dhe e studioi në mënyrë të krahasuar me eposin e kreshnikëve ("*Gjergj Fishta: 'Die Laute des Hochlandes'*" - München 1958).

Studimet filologjike të gjysmëshekullit të fundit kanë saktësuar e konfirmuar se disa dukuri të kulturës tradicionale qofshin ato: gjuhësore, etnografike, historike apo letrare, në procesin e gjatë të bashkëjetesës, janë *ballkanizuar*, pavarësisht nga prejardhja, afërsia apo largësia gjenetike që popujt kanë me njëri-tjetrin.

Lambertzi si për literaturën shqiptare, ashtu edhe për poezinë popullore shqiptare ka vënë më dukje karakteret origjinale që e dallojnë nga poesia e popujve fqinj, me gjithë se dihet që ka shumë tipare të përbashkëta midis popujve të Ballkanit në këtë drejtim pikërisht për faktin që sapo përmendëm.

Kemi bërë një hulumtim në dy veprat e tij në koleksionet e titulluara *"Midis Drinit dhe Vjosës"*, dhe *"Posta e Shqypniës"*, të cilat janë

---

[92] *Eqrem Çabej, Studime gjuhësore V, Rilindja, Prishtinë, 1975, f. 183-184.*

botime të Qendrës së Studimeve Albanologjike, të vitit 2011, ku japin më në thellësi këto tipare të kulturës së shqiptarëve.

Autori në veprën *"Midis Drinit dhe Vjosës"*, ka përshkruar Shqipërinë gati një shekull më parë, gjatë kohës që në Ballkan e në Europë zhvillohej Lufta e Parë Botërore. Lambertz para se të prekte "*vendin e shqipeve*" (M. Lambertz-i është një prej albanologëve ngulmues për shpjegimin e etnonimit "*shqiptar*" prej totemit "*shqype*", "*shqipe*").

Vepra "*Midis Drinit dhe Vjosës*" përmban një prej koleksioneve që M. Lambertz mblodhi e përzgjodhi prej botimeve shqiptare të shekullit të romantizmit e në vijim, të cilat duket qartë se i njihte tërësisht; nga shtypi letrar dhe ai politik i fillimeve të periudhës shtetërore; si dhe nga bartësit jo të pakët që takoi vetë gjatë qendrimit në Shqipëri. Janë poezi e përralla të botuara gjermanisht dhe të krahasuara prej tij me motive të ngjashme të popujve të Europës dhe të kulturave e qytetërimeve të tjera.

Kriteri mbi bazën e të cilit M. Lamberz-i ka bërë zgjedhjen e lëndës është para së gjithash ai i primitivitetit, irracionalitetit dhe arkaizmit, si shenja të sigurta të lashtësisë së saj. E njëjta zgjedhje vërehet si për poezinë, ashtu dhe për prozën. Ku nuk ka epikë historike, as legjendare; por nuk ka as lirikë të ritualeve themelorë të jetës së njeriut: lindjes, rishtarisë, martesës, vdekjes. M. Lambertz-in e intereson më shumë ajo pjesë e traditës gojore që mund të quhej *para-poezi* dhe që shpesh herë s'ka një kuptim të shpërfaqur, s'ka rrjedhshmëri, s'ka personazhe, s'ka fabul[93].

Koleksioni i përrallave është më i plotë. Në të vërtetë, më shumë se përralla, në kuptimin terminologjik që ka marrë kjo fjalë në folkloristikën shqiptare, ato janë rrëfime në formën e *shëmbëlltyrave*, të cilat tregohen jo në mjedise familjare, siç është skema bazë e komunikimit të përrallës, por në mjedise më të gjera: në dasma dhe ngjarje të tjera publike të jetës së njeriut; në kuvende, në oda burrash, në takime rastësore të individëve. Nuk janë doemos përralla që gjyshi

[93]*Shaban Sinani, "M. Lambertz-i dhe koleksioni i tij me folklor shqiptar", Revista "Haemus", 2012.*

ua tregon nipërve. Qëllimi i këtyre shembëlltyrave është që rrëfimtari të dëshmojë dijen dhe përvojën e tij, t'i japë kënaqësi mendore dhe estetike bashkëbiseduesit, të krijojë një gjendje të ngritur emocionale e intelektuale, të provokojë një diskutim të mëtejshëm, por dhe të vërë në provë urtësinë e të tjerëve[94].

Kurse në veprën *„Posta e Shqypnies"*.....një vend të veçantë në shkrimet e tij zë edhe poezia popullore shqiptare, ose krijimtaria popullore shqiptare, ku Lambertzi shprehet se poezia popullore nuk është vetëm paraardhësja e literaturës artistike të një populli, por edhe pasqyra shpitërore e një mase të gjerë të një populli. Ndaj, kush nuk njeh krijimtarinë popullore të një kombi, ai nuk njeh atë popull fare, ndërsa këngët e Mujit e të Halilit përbëjnë eposin më të vjetër të poezisë popullore shqiptare. Si të tilla, ato përmbajnë mjaft elemente të vjetra përrallash.

Në këtë vepër autori nuk lë pa përmendur edhe poezinë shqiptare për fëmijë ku vë theksin se ashtu si tek çdo popull, edhe në krijmtarinë artistike për fëmijë, tek këngët, lojërat, përrallat, gjejmë mjaft elemente karakteristike të kohëve të lashta. Ato janë pjesa më konservatore e shpirtit fëminor të një populli. Janë gratë ato më tepër se burrat, të cilat i ruajnë më fanatizëm këto këngë dhe që nuk u largohen origjinalitetit të tyre. Këngët më të ëmbla e më intimet janë ato që nëna i këndon fëmijës së saj të vogël. *Nina, nana* i këndon nëna shqiptare foshnjës së saj, ashtu si nënat tona që u këndojnë fëmijëve të tyre *fli fëmija im*, *fli.* Ninulla të bukura i këndon nëna shqiptare foshnjës së vet kur e vë atë në gjumë, i këndon kur i dalin dhëmbët e parë apo kur hedh hapat e parë.

Në moshë më të rritur fëmijët këndojnë të gjitha llojet e këngëve. Ajo çfarë i karakterizon e njëkohësisht i bashkon të rinjtë e të gjithë popujve është të diturit e këngëve për fëmijë.

Të shumta janë edhe lojërat që njihen edhe si „lojërat e shoqërisë". Një lojë e tillë është kur njëri nga lojtarët thotë një fjalë, e më pas secili nga pjesëmarrësit në lojë duhet të vazhdojë të thotë nga një

---

94 Shaban Sinani, "M. Lambertz-i dhe koleksioni i tij me folklor shqiptar", Revista "Haemus", 2012.

rresht, ku të përmendet një cilësi e një qenije njerëzore a e një sendi. I fundit duhet të thotë rreshtin përmbyllës, ndryshe ai humbet.
Fëmijët shqiptarë u këndojnë edhe festave të ndryshme e të stinëve të vitit. Për krishtlindje e për Vit të Ri, po edhe për Pashkë, ata dalin derë më derë duke kënduar e duke mbledhur dhurata të ndryshme. Po kështu, kur hëna është e plotë a kur është nevoja të bjerë shi pas një thatësire të gjatë, ata këndojnë këngë enkas për to. U këndohet ashtu si tek ne, edhe shenjtorëve të popullit, p.sh lejlekut, i cili për myslimaët është një zog i shenjtë, pasi udhëheq pelegrinët për në Mekë.
Në hapësirën jugore të vendit është një balladë me titull Kostantini i vogëlith, në të cilën haset motivi i dhëndrit që mendohet i vdekur por kthehet në castin e fundit, kur nusja gati martohet me një tjetër dhe shenja dalluese e njohjes që përdoret është një unazë, por aq e njohur është edhe Kënga e Doruntinës, në të cilën tregohet sa e rëndësishme është fjala e dhënë që duhet mbajtur me cdo kusht dhe lidhja mes vëllait e motrës, i cili bëhet mbrojtësi i familjës pas vdekjes së babait.
Për vlerën e punës në mbledhjen e thesarit folklorik Lambertzi nuk lë pa përmendur edhe studiuesit dhe mbledhësit si: Atë Vinçens Prendushi, Atë Gjergj Fishta dhe Atë Shtjefën Gjeçovi.
Në mjaft shkrime Lambertzi, ka përballur edhe mendime të historianëve apo etnologëve të huaj që i paraqitnin shqiptarët si popull i ashpër (i egër), sikur gjuhës së tyre u mungonin fjalët e politesës e të dashurisë, duke sjellë shembuj të kundërt nga krijimtaria popullore, plot modele finese me ndjenja të holla, të veshura me fjalë të zgjedhura e prekëse, fjalë kyçe e mbresëlenëse që gjen dendur në këgnët popullore të dashurisë si në rastet: *Lulja e blinit, shega, manushaqe bukuroshe, mollë e kuqe imja, fllanza, o zambaku i bardhë, o moi e bukura, moj hyria ime, o moj holl, moj holl e gjatë, moj e vogla ime, moi faqegastare*.
Lambertzi me veprimtarinë e gjerë të tij si gjuhëtar, si histroian i letërsisë shqipe dhe mbi të gjitha si folklorist, duke e vështruar në një

tërësi organike kulturën e një prej popujve më të vjetër të Ballkanit, dha një shembull kuptimplotë në fushën e studimeve albanologjike.
Si përfundim mund të themi se ndihmesa që Lambertzi i dha studimeve të folklorit shqiptar shihet më së miri si:
Ai ka mundur që me anë të vëzhgimeve dhe analizave, të vërë në dukje pasuritë e dy prej fushave të rëndësishme të folklorit tonë sic janë përrallat dhe epika heroike lengjendare.
Midis këtyre pasurive ai ka identifikuar një numër elementesh që dëshmojnë për lashtësinë e këtij fondi që të con me burimet e tij në fondin etnokulturor ilir.
Duke vënë në dukje elementet e trashëgimisë sonë folklorike që përkojnë me ato të popujve të tjerë, duke dalluar tiparet e tij qenësore, ka dhënë një ndihmesë të rëndësishme për ta vënë folklorin tonë në lidhjet e mëdha të folkloristikës së përgjithshme ballkanike dhe europiane.

KOSTUMOGRAFIA DHE RITET E DASMES TRADICIONALE SHQIPTARE

doktorante, Rovena Kuka

Abstrakt

Ky studim ka per qellim percjelljen dhe njohjen e riteve dhe traditave te Dasmes Shqiptare, duke fokusuar vemendjen ne zonen e Laberise.Ne kete zone martesa ka qene dhe mbetet nje nga ritualet dhe ngjarja me e rendesishme, me e gezueshme ne jeten e nje cifti te ri.

Nje moment I shoqeruar me nje seri ritualesh. Nuk behet fjale vetem per kenge e valle. Nder elementet e dasmes tradicionale vlen te permendim kostumografine (fustani I bardhe, velloja e nuses), aksesoret qe simbolizojne bashkimin e nje cifti (Unaza e marteses) te cilat jane te trasheguara deri ne ditet e sotme, duke vazhduar me ritet pergatitore premartesore dhe pasmartesore.

Te gjithe keta elemente mbartin ne vetvete simbolika perfaqesuese te krahinave te ndryshme shqiptare, te cilat ne ditet e sotme jane rrethuar nga nje tjeter kornize perceptimi.

Në fakt, në mënyrë virtuale çdo pjesë e dasmës, që nga fejesa dhe deri në muajin e mjaltit, ka një histori të pasur. Rrënjët kulturore, prejardhja dhe besimi fetar kanë fokusuar martesën për mijëra vjet të njerëzimit. Ky shkrim paraqet një histori te shkurtër te elementeve të ndryshëm të dasmes tradicionale Shqiptare.

Fjalët kyçe: dasma tradicionale, unazat e marteses, dasma vlonjate

Martesat e hershme ishin shumë të ndryshme nga ideja e sotme e martesave. Paraardhësit tanë primitiv qëndronin bashkë për tu

mbrojtur dhe për të mbijetuar më shumë, se sa për të krijuar lidhje të kuptimshme. Dhe, në momentin që numri i tyre ishte i sigurtë, njerëzit primitive formuan tribu, të cilave u qëndronin shumë besnikë. Disa historianë besojnë se martesat e para kanë qenë grup-martesash, që duheshin kryer detyrimisht brenda tribuve. Dhe, pak kohë më vone, burrat dhe gratë filluan të qëndronin bashkë dhe formuan familjet e veçanta. Që nga ajo kohë, martesat nuk kanë qenë gjithmonë një ngjarje e lumtur. Dhe, pikërisht prej rivalitetit të tribuve, shpeshherë gratë dhe fëmijët grabiteshin ose rrëmbeheshin. Që kur brenda tribuve ishte e ndaluar të martoheshe brenda klanit, atëhere gratë rrëmbeheshin dhe ishin të detyruara të lidheshin në martesë me të huajt që i kishin rrëmbyer. Historianët, i referohen shpesh kësaj periudhe, që ishte pjesë e kohës së erës së martesës me rrëmbim.
Kjo diagramë në shekuj tregon se në çfarë proçesi ka kaluar ceremonia e dasmës nga ajo që ne njohim sot.

Veshjet e dasmës

Rrobat e dasmës nuk kanë qenë gjithmonë, kështu si janë sot. Në shekullin e 18-të, nuset e varfëra visheshin me veshje të thjeshta. Kjo simbolizonte për burrin e saj të ardhshëm, se ajo nuk kishte sjellë asgjë dhe po kështu nuk e detyronte të shoqin për asgjë. Ndërsa, në mes të shekullit të 19-të, të gjitha nuset filluan që të aplikojnë veshjet e bardha të nusërisë. E para që e ka përdorur fustanin e bardhë, thuhet se ka qenë në vitin 1840, Mbretëresha Viktoria.
Sepse dihet që kostumografia gjithmonë do fillonte nga shtresat e pasura, për arsye ekonomike dhe simbolike, e bardha simbolizon pastërtinë morale e saj para burrit, pra ky simbol organizativ ishte qëlluar më shenjë nga rregjizorët e oborrit dhe mbeti përgjithnjë e tillë për çdo nuse.[95]

Velloja e nusërisë.

---

[95] *Tradita dhe bashkëkohorja në ritin e dasmës, Leontina Gega (Musa), Jehona e re. - Nr. 1-2, , 2007*

Velloja, në mënyrë origjinale, është mbajtur nga gratë e pamartuara për të treguar modestinë. Në ceremoninë martesore, një nuse e mban vellon si simbol të nënshtrimit dhe premtimit, që do t'i bindet të shoqit të saj. Dhe vetëm pas ceremonisë velloja ngrihet për të zbuluar pamjen e nuses, përpara dhëndrit. Dikur në shekullin e 16-te, veshjet me vello ishin shume delikate, ndërsa vellot me tantella, për herë të parë u bënë popullore mbas martesës së Mbretëreshës Viktoria në vitin 1840.

Velloja gjithashtu mbante edhe kuptimin se nusja, bukurinë e saj e kishte vetëm për burrin e saj.Për një lloj marrëdhënie tjetër Sabina Vaqarri shkruan"ka ekzistuar edhe një formë martese që quhej"Ndërmasë" kur në familje jepej një vajzë e merrej një nuse, kjo për qëllim që të mos paguhej për pajë nga asnjëra familje, pasi lidhjet realizohen mes njerëzve të së njëjtës shtresë sociale dhe të njëjtës fe.[96]

Unazat e martesës

Tradita e unazave të martesës është nga më të vjetrat ndër të gjitha traditat e tjera martesore. Aërsisht, çdo qytetërim, duke filluar që nga egjiptianët, i kanë përdorur unazat martesore, si simbol të marrëveshjes martesore. Sipas hiroglifeve egjiptiane, rrethi përfaqëson përjetësinë, dhe unazat e para janë bërë nga fijet e barit, lëkura, bari i thatë, kocka apo fildishi. Dhe, kur u zbuluan metalet, atëherë ato zunë vendin kryesor në përberjen e këtyre unazave.

Vendi klasik ku duhet mbajtur unaza martesore është gishti i katërt i dorës së majtë.Ky zakon ka filluar tek egjiptianët, sepse ata besonin që një venë në dorën e majtë, që ndodhej pikërisht në gishtin e katërt, kishte direkt lidhje me zemrën. Ndërsa shpjegimi pragmatist i sotëm

[96] *Tradicionalitet dhe risi në dasmat tiranase, Sabina Vaqarri ,fq.315*

është i thjeshtë: vihet në dorën e majtë, sepse shumica e njerëzve e kanë inaktive këtë dorë, pasi këta njerëz shkruajnë me të djathtën.
Por, ka dhe përjashtime, pasuesit e Elisabetës në Angli, e mbanin në dorën e djathtë unazën martesore, dhe mbanin madje disa të tilla. Katoliket romane po ashtu i mbanin në anën e djathtë. Gjithashtu është e ndaluar, që unazat e martesës, të blihen ditën e premte. Për supersticion, unazat nuk duhen mbajtur, përpara ceremonisë së martesës."Si periudhë për organizimin e dasmës ,ka qenë vjeshta, ose stina e bollëkut , me prirje nga gjysma e dytë e saj, kur ishin në përfundim punët bujqësore dhe hambaret ishin plot".[97]Në përgjithsi kjo prirje ishte pothuajse në të gjitha trevat e Shqipërisë e barabartë.

Ëmbëlsira e martesës

Ëmbëlsirat kanë qenë pjesë e ceremonisë së martesës që në kohët mesjetare. Në Romë ëmbëlsira e parë e marteses ishte bërë nga feta të bukës së bardhë. Gjatë ceremonisë buka thyhej mbi kokën e nuses, si një bekim për një jetë të gjatë dhe shumë fëmijë. Miqtë e ftuar në dasëm hanin një pjesë të saj, si shenjë të fatit të mirë.
E gjitha kjo regjizurë dhe mizansenë janë tepër të përpikta me përcaktime tepër simbolike ose me metaforike siç është unaza që tregon besnikërinë e përjetshme.

Muaji i mjaltit (hënës)

Muaji i mjaltit, i çiftit të sapomartuar, nuk ka pasur kuptimin, që ka në ditët e sotme, si muaji i parë i kaluar së bashku. Fjala ka ardhur, ose ka rrjedhur nga Evropa e veriut, nga një vend ku për traditë, bëhej verë nga hidromeli (një lloj pije) dhe mjalti. Kjo traditë e Evropës së veriut, nënkuptonte që çifti për të pasur fat në jetën e tyre, duhej të pinin këtë verë të ëmbël, që quhej metheglen, për një muaj pas martesës. Dhe, që kur muaji i parë u quajt "henor" kjo periudhë u njoh me emrin "muaj mjalti".
Ka ndryshuar shumë ceremoniali martesor, përgjatë periudhave të ndryshme në Shqipëri. Të cilin mund të tentojmë, që ta ndajmë në tre

---

[97] *Tradicionalitet dhe risi në dasmat tiranase, Sabina Vaqarri ,fq. 315*

periudha, jo shumë të përpikta. Dikur, shumë arkaik dhe i përpiktë, sot është më liberal dhe më pak i kontrolluar. Ndërkohë, që është pasuruar në qytet, me elemente që i afrohen dasmave, të vendeve evropiane.

Në një ceremonial të hershëm, i cili na ka ardhur i gjallë, falë një dokumentari te "Luce" në fundvitet '30, një çift shqiptar në veri të vendit, martohet sipas një rituali, që duket se është i përcaktuar mirë. Nusja është e mbuluar dhe është e veshur me kostumin popullor të zonës, ndërsa dhëndëri po ashtu mban një veshje kombëtare të zgjedhur. Pak çaste, përpara se të futen në shtëpi, ajo pozon përpara të gjithë dasmorëve, në krah të dhëndërit. Është vjehrra, që e para përmes xhirimeve të shpejta të dokumentarit të kohës, e merr dhe ia vendos gishtat në derën e shtëpisë. Kjo është shenja e besimit, e mikpritjes"Hospitaliteti, thotë Wiliams, është në kulmin e tij në Shqipëri.Një atakim po ti bëhet mikut në çdo mënyrë qoftë , është një çnderim i madh për të zotin e shtëpisë e për të gjithë fisin e tij.Ai që grabit ose vjedh mikun , simbas zakonit të vendit dënohet shumë rëndë ose me vdekje ose nxirret jashtë fisit."[98]I tërë ky organizim teatral të kujton një inskenim impresionues për spektakle tepër të fuqishme". E cila përsëritet, pak a shumë në të njëjtën mënyre, në të gjitha vendet, në këtë kohë, që nuk janë pasqyruar në dokumentar. Kështu zhvillohej ceremoniali martesor, në vitet '40 në Shqipëri, sipas dokumentarit italian. Por, evidenca të qarta të saj kemi, për të gjitha ata, që kanë shkruar për Shqipërinë. Historianët kanë lënë një evidencë të qartë, kështu, për ceremonialin e Skënderbeut me Donikën. Një nga dasmat më të dëgjuara të historisë sonë, për pompozitetin dhe gradën e të ftuarve.

Para Luftës së Madhe

Duke iu kthyer kujtimeve filmike të "Luce", pak më tej, në ekstremin verilindor të Shqipërisë etnike, nusja merrej e shoqëruar me flamurin kombëtar. Madje, edhe në qytetet e Kosovës, respektohej ky veprim.

[98] *The Shkypetares Xh.Wiliams fq.27*

Në Shqipërinë e Jugut dhe ë Mesme, nusja e mbuluar, kryente ritualet, e përcaktuara qartë, ndërsa vjehrra, që atë ditë transformohej si "Zonja e parë e shtëpisë". Në disa, fshatra, ajo qëllonte të ishte shumë më e madhe edhe sesa dhëndëri (për shkak të emigrimit). Në qytete, nuk dukej se mund të ndryshonin më shumë ceremonitë. Ato, falë përbërjes të gjere demografike shqiptare, që kishte maxhorance fshatare, kishin shumë elemente tradicionale.

Ndryshimi, i vetëm brenda trevave, kishte lidhje me ndryshimin e besimeve fetare. Dhe, besime të ndryshme aplikonin zakone të ndryshme. Ndërkohë, në zonat më pak të urbanizuara, respektohej elementi i rrëmbimit, (madje veprimi quhej si një zotësi e dhëndërit);"ky fenomen , thotë A.Dojaka, ka qenë shumë i rrallë, në një të kaluar më të largët ishte mjaft i përhapur.Këtë fenomen e ka njohur dhe e drejta zakonore."[99]

Kurse në disa zona malore, nuk u harrua deri vonë elementi i blerjes së nuses. Madje, dhëndëri i ardhshëm, duhej të ishte i aftë që të kishte një sasi të mjaftueshme për ta blerë të shoqen. Nga kjo sasi të hollash, ai kishte të drejtë, që të zgjidhte nusen-mall të tij. E cila, që ditën e parë, do të ishte skllavja e re e shtëpisë. Këto zakone më shumë e robëronin femrën shqiptare. Në shumicën e rasteve, kuptohet se prirja kryesore ishte dasma me anë të njohjes me shkuesi.

Dhe, megjithë kënaqësine e madhe jetësore, se ato do të krijonin familje, në përgjithësi femrat e konsideronin veten krejtësisht të robëruara. Vetëm, në qytete, dhe kontaktet me jashtë të familjeve të borgjezise shqiptare, dhe pronarëve të tokave bënë që të ndryshonin krejtësisht këto ceremoni. Kuptohet në pak familje. Që shfrytezuan edhe lidhjet martesore, për forcimin ekonomik dhe për aleanca të ndryshme mes tyre.

E rëndë vazhdoi të paraqitej për femrën shqiptare, gjendja e saj në zonat rurale dhe ca me shumë në zonat, që ishin larg qendrave urbane, deri në mesin e shekullit të kaluar. Ceremoniali i brendshëm,

---

[99] *Dasma në Shqipëri A.Dojaka fq.31*

pastaj ishte njëlloj. Preferohej lidhja martesore pranë autoriteteve fetare. Muzika zgjidhej nga vendi, origjina e të cilit ishte dhe origjina e çiftit martesor. Paja e nuses, do të përcaktohej nga mundësia e familjes, apo nga marrëveshja, që ishte bërë gati matematikisht, në mes përfaqesuesve të dy palëve."Jorganët, dyshekët, kundrat(këpucët), enët e bakrit bliheshin në pazar tek zanatçinjtë.Arka e pajës ,apo sepeti i nuses, dhe kutitë e sendeve të arta e të argjenta bliheshin në pazar, në llogarinë që merrej nga familja e dhëndërrit për tu paguar(para 1945 familja e dhëndërrit i jepte zakonisht 20-35 napolona flori).Për të marrë pajën e nuses si rregull, shkojnë vetëm burra nga të afërmit e dhëndërrit"[100]Ky rit pothuajse është i njëllojtë në të gjitha trevat e Shqipërisë me ndryshime nuancash të vogla.

Pas Lufte

Kjo gjendje u trashëgua edhe pas luftës. Vetëm se me një ndryshim. Rregjimi komunist nuk dëshironte, që t'i qëndronte, që në fillimin e tij strikt, zakoneve të kaluara. Dhe, filloi që në masë, përfaqësuesit e saj t'i braktisnin këto ceremoni. Kjo, pak më vonë, u bë një normë masive. Dhe, të rinjtë, që vinin nga zona të ndryshme të vendit, për pune të ndryshme vullnetare, që hapi sistemi komunist, filluan që t'i marrin dhe t'i aplikojnë këto zakone. Filluan që të demaskonin sistemin e njohjes me shkuesi, pavarësisht se shmangia e tij nuk ka mbaruar ende. Disa kohë, madje ishte jo e pëlqyeshme që të mbahej, edhe uniforma e martesës, nga ana e nuses. Dasmat u reduktuan, ndërsa dominonte kudo muzika e sistemit të ri, që kishte lindur. Në ceremoni, përpos shëndetit të çiftit, duhej që të tregohej besnikëria e dasmorëve për Partinë.

Çiftet, pastaj si muaj mjalti, duhet që të shkonin në një nga kampet e pushimit, kur ndërsa çiftet në fshat ishin më të privuara, falë gjendjes ekonomike. Me kalimin e kohës, por kryesisht që me ndarjen e fesë, ritualet ishin reduktuar disi. Ndërsa për sa i përket pushimeve, ato duhet të kishin kujdes, që të mos tejkaloheshin. Është akoma e gjallë

[100]*Praktika të ritualeve paramartesore Sabina Vaqarri fq.146*

një këngë, që tashmë është kthyer, në një përqeshje për sistemin e kaluar. Diçka që tingëllon e tillë:
Të dielen u martove/ të hënën në pune shkove/. Një përqeshje tipike cinike e sistemit! Nga ana tjetër, varfëria bëri, që të kurseheshin shumë. Kurse, ata që ishin më në gjëndje, në të shumtën e herës, dasmat në qytet i bënin nëpër lokale dhe më pak në shtëpi, ndërsa në fshat, ashtu si tradicionalisht, nëpër shtëpira të ndryshme. Ku, kohë më parë, duhej që të përgatiteshin marrja e lejeve për gjetjen e ushqimit dhe ceremoniali tjetër plotësues.
Por në Labëri ceremonialet e dasmave kanë ndryshuar shumë pak, flasim gjithmonë për vitet e hershme.Ku krushqit shkonin në shtëpinë e nuses një orë me vonesë dhe me arritjen e tyre , kërciste arma si formë përshëndetjeje.
Në këtë shpurë përzgjidheshin njerëzit më kryesorë të familjes, me ta sigurisht mund të ishte edhe mblesi , i cili kishte qenë protagonist i kësaj martese. Funksioni i tij ishte i madh sepse ai mbante përgjegjësi për atë lidhje deri edhe me kokë. Kur shkonte në derën e nuses për të kërkuar dorën e saj, ishte një mjeshtër i reklamës së familjes së djalit , e ngrinte në qiell tërë farefisin e tij e sidomos , dhëndërin.
Si zakon familja e nuses nuk pranonte për herë të parë, sepse dihej që duhet ta bënte pak të vështirë dorëzimin.Por shkesi vazhdonte punën, ai nuk i ndahej luftës për bindje.Më në fund familja gjoja me vështirësi pranonte.E gjitha kjo hynte tek arsenali mizansenal, që përdorej për ta rregulluar punën.
Regjizura këtu duhej për ta përgatitur dhëndërin të ishte gojë mjaltë dhe mjaft i duruar. Duhet të përdorte fjalë standarte mjaft të çensuruara që familja e vajzës të mos fyhej.Prandaj shkesi , i cili kishte bërë goxha punë me monologjet e tij inteligjente , tani e kishte vendin i pari në shpurën e krushqëve. “Shkuesi zakonisht duhet të ishte mik i të dy familjeve, të djalit dhe të vajzës, në këtë mënyrë ai do ta kishte më të lehtë misionin e tij. Veç kësaj, duhet të ishte një person që i njihte mirë zakonet”.[101] Sigurisht në banket atyre u rezervohej një vënd kryesor dhe priteshin me këngë e valle për ti

[101] *Dasmat në Shqipëri A.Dojaka fq.37*

nderuar. E gjithë ky organizim përcaktohej nga ligje strikte regjizoriale.Ngriheshin [102]dolli pa fund dhe nëqoftëse ato kërkoheshin të ktheheshin me fund, personi që ishte kërkuar duhet të thoshte "Nderi Juaj" dhe ai nuk e diskutonte, gotën dopjo që do ta kthente me fund, ndryshe mund të bëhej sherr i madh! Këto ishin shenjat e burrërisë që i ftuari duhet të tregonte.

Pastaj merreshin këngë me vargje steriotipe që po ti ndërroje emrin personit në varg, dilte sikur kënga ishte shkruar për të zotin e shtëpisë.Ky ballafaqim krushq-dasmorë gjithmonë kishte mirkuptim dhe tepër kortezi. Pastaj duhet krushqit të merrnin një valle për hirë të miqësisë , ku e gjithë dasma e shoqëronin me duartrokitje.E gjitha kjo kishte një organizator që i dinte ritet shumë mirë, ai ishte në vënd të një regjizori praktik dhe intuitiv. Sepse në dasma njerzit fyhen lehtë, kjo gjë krijon trazira ose prishjen e dasmës.Në përgjithësi në dasmat labe kënga polifonike është ajo që mbulon atmosferën, por ka edhe orkestër e cila shoqëron ndonjë këngë jashtë këngës popullore.

Si mizansenë familjarët edhe nusja rrinë në qëndër, kurse në tavolinën anash ose përballë.Ata shpesh herë ngrenë dolli për çiftin dhe të zotin e shtëpisë.

Në përgjithsi dasmat labe janë të rënda , ku shumë nga të ftuarit përfundojnë në dhomën e kashtës se bëhen tapë nga dollitë.Ata që nuk i rezistojnë dot pijes , shpesh herë mbeten të ç'burrëruar .Kjo garë kapadaillëku e ka origjinën shumë të lashtë, ku burrat e jataganit duhet ta tregonin veten se si mposhtëte asnjë në këtë botë, përveç se plumbit.Gratë gjithmonë këndonin edhe veç ka zakone që nusja rri në dhomë me to, por në përgjithësi ato nuk përzihen me burrat. Këngët e tyre janë karakteristike në krahasim me burrat, ata kanë brënda sentimentalizmin e nënës, që qan për largimin e nuses ose këndojnë për lulet e bukura ku krahasohet nusja me to.

[102] *Martesa nëpër shekuj dhe krushqia midis elementave ndryshe në Shqipëri të lire, Vasil K. Dilo Tiranë : Shtypshkronja "Gjinokastra", 1924*

Sigurisht, që edhe në Labëri nuk gjendet një moment tjetër më i rëndësishëm jetësor sesa organizimi dhe festimi i një martese. Ceremonia, ritualet dhe tradita, janë ato që sërish flasin me një gjuhë krejt autentike të zonës, duke shfaqur veçanti, ashtu sikurse në episode fragmentare, natyrisht që nuk mund të mungojnë elementë të përngjashëm me dasmat që zhvillohen në trevat e tjera të vendit. Periudha e martesës është momenti më i rëndësishëm i jetës në zonën e Labërisë. Para se të planifikohej një bashkim mes dy familjesh, përmes lidhjes së kurorës nga çifti i ri, ajo që shikohej me vëmendje më parë nga të dyja palët, ishte zgjedhja e mikut. Krushqit, duhet patjetër që të ishin të një niveli ekonomik, social e kulturor, në mënyrë që të mos lindnin diferencime e mospërputhje klasore dhe të shmangeshin pakënaqësitë e përveçme.

Ai që merrte iniciativën për një bashkim martesor, patjetër që nuk mund të ishte veçse mblesi. Mblesi shkonte për të pirë kafe në shtëpinë së cilës i kishte vënë "shënjestrën" dhe nëpërmjet simbolikës frazeologjike, plastikës së lëvizjes dhe çdo gjesti e fjale që thoshte, linte të kuptohej qëllimi i vizitës. Pra, e thënë në mënyrë më popullore, "ai kuptohej që në gojë, kur kishte ardhur për punë mblesërie". Më tej, mblesi kërkonte dorën e vajzës në emër të familjes që do ta merrte për nuse. Çdo bisedë zhvillohej mes burrave. Pastaj, sipas zakonit, familja e vajzës kërkonte pak kohë për të dëgjuar "zërin" e dhëndrit dhe familjes së tij, pasi kishte raste kur ai mund të ishte me të meta fizike, mendore, apo me ndonjë ves.

Momentet premartesore të Labërisë

Siç mbaronin punë mblesërit, familjet që jepnin pëlqimin reciprok për njëra-tjetrën, caktoheshin datat dhe vazhdonin përgatitjet njëra pas tjetrës. Kryheshin ceremonitë paramartesore të shkëmbimit të nishanit, dhuratave, unazave, e kështu me radhë për të ardhur tek ajo që e kemi quajtur "momenti premartesor". Një grup nga familja e dhëndrit, "sijinxhit", ku zakonisht futen daja i djalit, që zë vendin dhe

përgjegjësinë kryesore, xhaja, e ndonjë tjetër i afërm, shkojnë u bëjnë peshqeshe nuses dhe krushqve. Ata priten me të gjitha respektet, sipas zakoneve dhe pasi hanë e pijnë tërë natën, në mëngjes bëhen gati të rikthehen në shtëpinë e dhëndrit, duke marrë me vete kuajt, që tashmë janë ngarkuar nga krushqit e nuses, me plaçkat dhe pajën që ajo ka përgatitur.

Nusja do të hipej siç e donte adeti, mbi një pelë të madhe, të bardhë e të zbukuruar, sikundër në ditët e sotme, për të zgjidhen makina luksoze të bardha e të zbukuruara më tepër se të tjerat, me shirita, lule, tollumbace. Por, kishte raste që brenda një ditë këmbeheshin rrugës dy palë karvanë dasmorësh, që sillnin nuset për tek dhëndri. Ndryshe nga zona e Korçës dhe e Dibrës, ku të tilla koincidenca pasoheshin me tragjedi, pasi asnjë karvan nuk i hapte rrugën tjetrit, sepse i shkonte dasma ters, vlonjatët kanë një traditë tjetër, të paktën kështu shprehet etnologu Bajramaj: "Ishte [103]zakon, që kur shkëmbeheshin dy karvane dasmorësh në një rrugë, atëherë, ata ndaleshin dhe nuset shkëmbenin mes tyre shamitë e bardha dhe nga një ëmbëlsirë. Kjo kishte kuptimin që t'i jepnin fat njëra-tjetrës, ndërsa ëmbëlsirën e falnin për të lehtësuar lotët e ndarjes nga familja, që i fshinin me shamitë e tyre."

Nusja pritet me krisma

Duhej doemos, që nusja të shoqërohej gjatë rrugës për në shtëpinë e dhëndrit, nga një fëmijë i vogël, i afërm i saj. Teksa karvani dasmor i afrohet shtëpisë së burrit, njerëzit e këtij të fundit, dalin jashtë e qëllojnë në ajër me armët e tyre, për të lajmëruar se nusja erdhi shëndoshë e mirë. Janë pikërisht këto çaste, kur atmosfera ndizet në maksimum dhe këngët, vallet e lojërat, ndjekin njëra-tjetrën. Por, duhet thënë se dasma në shtëpinë e dhëndrit ka nisur që një javë

[103] *Nusja e dhëndri, lotët në dasmën tradicionale : kode të dasmës tradicionale shqiptare, Fejzulla Gjabri, Ballkan. - Nr. 254, 24 tetor, 2006*

para, me rituale e ceremoni të tjera, siç janë: "Dita e kafeve", apo "Dita e druve", kur i gjithë fshati del në pyll për të prerë dru, që nevojiten për ngrohje dhe gatim, gjatë dasmës madhështore që zhvillohet gjithmonë nga familja e dhëndrit.Pra kemi vendosje mizasenal tepër shprehëse, për shembull "dita e druve" është veprim kolektiv tepër domethënës.

Sprovat që duhen kaluar me vjehrrën

Para se nusja të nisej nga shtëpia e saj, porositej prej grave të fisit, hallave dhe tezeve, që të mos harronte asnjë zakon të traditës. Në asnjë mënyrë, nusja nuk duhej që të harronte se, po të takonte një nuse tjetër rrugës, ato duhet të këmbenin shamitë dhe ëmbëlsira mes tyre. Më pas, nusja e re nuk duhet të harronte gjithashtu, momentin kur të hynte në shtëpinë e dhëndrit; ajo patjetër që duhet të linte mënjanë ngurimin dhe hutimin dhe shumë solemnisht, kur të zbriste nga pela e bardhë, duhet që të përulej e t'i puthte dorën vjehrrit dhe vjehrrës. Po kështu, nusja e re nuk duhet të harronte që kur i afrohej pragut të portës, të mos hynte brenda pa ardhur ena me mjaltë, me të cilin ajo do të ngjynte pragun. Më pas, kemi momentin kur ajo përballet tek a tek, me vjehrrën në dhomën e burrave, ku duhet ta rrotullojë plakën tre herë dhe t'i puthë dorën në çdo rrotullim, për të kaluar tek monedha që nusja duhet ta fusë në këpucën e saj para se të niset, në mënyrë që kur nipçja i vogël i dhëndrit të shkojë e t'i heqë këpucën, ta gjejë këtë simbol mbarësie. Nëse nusja harronte ndonjë prej këtyre adeteve, atëherë do të shikohej që në fillim me përçmim nga vjehrra dhe do të kishte probleme në marrëdhëniet mes tyre. Veç këtyre zakoneve, kemi dhe atë që quhej "Syri i zi". Për të shmangur "Syrin e zi", nuses i vareshin hudhra e qepë të fshehura dhe një flamur i kuq, pasi labët besonin se shejtani e kishte frikë të kuqen dhe largohej.

Një sërë detajesh tepër regjizoriale paraqiten në këto tablo përshembull , leku te këpuca, lyerje e pragut me mjalt, që nuk janë gjë tjetër vetëm se mizansena të mirëfillta teatrale.

Kur vjen nusja te dhëndri, të parët që ta presin duhet të jenë patjetër vjehrra me vjehrrin. Nusja, sapo zbret nga kali, i puth dorën që të dyve, ndërkohë që, pas çaste më pas, të tjerët nisin e i hedhin nuses lekë, oriz, karamele, derisa shkon tek pragu i shtëpisë, ku vjehrra i sjell mjaltë, me të cilin nusja, për mbarësi duhet të lyejë derën. Pasi nusja hyn në shtëpi, kemi një zakon tjetër; ajo drejtohet menjëherë në dhomën e burrave, ku gjen të ulur në krye të këndit, vjehrrën. Kjo është përballja e parë vetëm për vetëm, e dy zonjave të shtëpisë. Pasi hyn në dhomë, nusja fillon të vërtitet plot tri herë rreth karriges ku është ulur vjehrra dhe në çdo rrotullim, shkon dhe i puth dorën plakës. Diçka para dhe pas atyre momenteve ishte e pathënë, por vetëkuptohej prerazi: Për çdo fjalë që vjehrra thoshte, nusja duhet t'ia kthente kokëulur "lepe", që do të thotë "si urdhëron". Siç mbaron me rrotullimin tri herë dhe puthjen e dorës së vjehrrës, nusja ulet në fronin e saj, ku duhet të nusërojë disa orë. Aty vjen një nga nipçet e dhëndrit dhe i heq vajzës këpucën, për të marrë monedhën që ajo ka fshehur. Pra rrotullimi i nuses tre herë rreth karrikes së vjehrrës tregon nga ana regjizoriale, se ajo (vjehrra) është strumbullari i kësaj shtëpie. Pastaj Dojaka shton"Sipas zakonit, dhëndërri ja hiqte duvakun nuses me majën e një thike apo hanxhari, me kobure, me petës apo me dorë"[104] , padiskutim ky është një detaj teatral simbolik ku dhëndërri tregonte supermacinë e tij.

Dhëndri dhe lojërat e hajdutërisë

Nëse krijojmë një pasqyrë imagjinare të ndarë në dy sfonde, në krahun tjetër të ndodhive me nusen, ishin dhe ndodhitë me dhëndrin. Ai merrej nga djemtë dhe burrat e fisit, të cilët e uronin, e përqafonin dhe më pas loznin me të, apo e ngacmonin me alegori, por gjithmonë në një sfond tepër dashamirës dhe në funksion të ndezjes së

---

[104] *Dasma në Shqipëri A.Dojaka fq,75*
Psikologjia e dasmës tradicionale : pjesë nga ceremoniali i dasmës shqiptare të traditës, ritet dhe zakonet, Fejzulla Gjabri, Ballkan. - Nr. 280, 23 nëntor, 2006

atmosferës festive të dasmës. Gra e burra nuk kanë qëndruar asnjëherë bashkë, madje gjithmonë ndarjet bëheshin në tri kategori: Gratë, burrat dhe fëmijët, që uleshin të ndarë sipas klasifikimit dhe nuk përziheshin me njëri-tjetrin. Si në dhomën e grave ashtu dhe nga burrat, kryheshin lojëra popullore, të cilat sipas traditës, për fitues kishin atë që tregohej më i zoti ndër shokët për të vjedhur njëri-tjetrin. Shamia e xhepit, qosteku, lekë e monedha, duheshin shtrënguar mirë, e në të njëjtën kohë, me sy kërkohej preha që duhej të humbte, pikërisht ato objekte që "hajduti" i ruante për vete, mos ia vidhnin sy ndër sy... Ka qenë dhe një zakon tjetër sipas të cilit, krushqit e nuses, para se të jepnin vajzën për grua, provonin dhëndrin sa i zoti ishte. Ata i vinin si kusht që ai të vidhte, p.sh., dashin më të mirë të një kopeje që ata ia caktonin. Nëse dhëndri nuk e bënte, do të thoshte se nuk qe i zoti "për ta nxjerrë qimen nga qulli" dhe nusja nuk i jepej. "Ky nuk është një zakon i mirëfilltë vlonjat, por e ka origjinën më tepër nga barinjtë e malësisë, të cilët kishin si zakon që ia vidhnin njëri-tjetrit bagëtinë dhe nëse dhëndrit i vidhej bagëtia dhe ai nuk vidhte dot, atëherë tregohej se nuk qe i zoti për familje". Prova e vjedhjes që i bëhet dhëndërrit është një atavizëm nga e kaluara , por ky simbol tregon prapë se gjëja më trimë është marrja e diçkaje nga tufa.

Dajat, gjithmonë në krye të këndit

Tradita e respektimit të dajës maksimalisht, madje shumë më tepër sesa xhaxhain, gjendet edhe në zonën e Labërisë. Bajramaj tregon, se "jo vetëm nëpër dasma, por në çdo ceremoni tjetër, vendet kryesore i zinin dajat, pastaj krushqit e mëdhenj në moshë, e kështu me radhë...".[105] Daja kishte rëndësi të madhe dhe konsiderohej si njeriu më i respektuar në familje, pasi nuk ishte pjesë e familjes, por ishte vëllai i nënës dhe miku më i afërt i familjes. Vazhdimisht daja ka qenë personi më i rëndësishëm, edhe për nusen dhe për dhëndrin, ndërsa xhajat kishin detyrime në shtëpi dhe merreshin me punët e dasmës. Daja mbante peshën kryesore të mbarëvajtjes së gostive,

---

[105] *Dasma vlonjate novruz Bajramaj Studjues fq.3*

muhabeteve, festës dhe krejt ceremonive. Duhet thënë se fjala e dajës kishte tepër peshë; ajo qe urdhër, qoftë për ata që shkojnë të marrin nusen, apo dhe për ata që e sjellin nusen tek dhëndri.Përcaktimi i rolit kryesor ka shumë rëndësi në spektakël, i cili duhet udhëhequr deri në fund me dinjitet.

Mëngjesi i parë i nuses, pasi ka fjetur me dhëndrin

Nusja, pasi fle me dhëndrin, del e shoqëruar nga kunatat dhe puna e parë që bën, do t'i çojë kafe vjehrrit e vjehrrës, ndërsa ata i hedhin para në tabaka (dhisk). Pastaj, ajo është e detyruar të ndërrojë rrobet e nusërisë, për të mbajtur veshjen karakteristike të zonës së gruas të shtëpisë. Siç përfundon me kafet, nusja merr shtambën dhe shkon të mbushë ujë në burimin e fshatit. Por, që në të gdhirë, kemi një fenomen tjetër tashmë të harruar, i cili ka qenë zakon për zonën. Për të treguar virgjërinë e vajzës, në mëngjes, vjehrra var në oborr çarçafin që e ka hequr nga krevati ku kanë fjetur nusja me dhëndrin, i cili duhet të jetë i përlyer me gjak, për të treguar se vajza e ka ruajtur nderin dhe ka qenë e virgjër. Por jo gjithnjë dasmat shkonin mirë...! Nëse burri s'do ta gjente vajzën e virgjër, atëherë ai e kthente në shtëpi. Këtu nuk kishte ndonjë problem mes familjeve, pasi vajza kthehej mbrapsht pa ndonjë qejfmbetje, por ata që e mbanin përgjegjësinë më të madhe ishin mblesët, të cilët kishin dalë edhe garant për vajzën. Ka pasur raste që këto probleme janë mbyllur me vrasje, ashtu siç ka ndodhur që janë mbyllur edhe me mirëkuptim.

Kthimi i nuses mbrapsht është ngjarje shumë e rëndë, ku thyhet tërë veprimi dramatik, nga gëzim në tragjedi thashethemesh.Për këtë temë Ëiliams thotë"Nëqoftëse një vajzë e fejuar lë të fejuarin e vet , ajo e ngarkon familjen e saj me një gjak të cilin e ka të drejtë i fejuari i saj ta marri."[106]

[106] *"The Shkypetares", Xh. Wiliams fq. 29*

Paja e nuses

Një zakon për shembull shumë interesant është ai i përgatitjes së pajës, i cili në labëri sposorizohet nga prindërit e vajzës , ata blejnë në pazar për nusen tre palë këpucë, fustane, triko, çanta etj. që asaj i duhen për jetën e përditshme .Ky solidaritet tepër artistik dhe shumë xhentil, bën që midis dy familjeve të ketë një bashkim tepër njerëzor.Në këto raste ata marrin edhe pëlqimin e nuses për stilin, modën që ajo i kërkon sepse kjo gjë është një përzgjedhje kostumografie që bën.

Këto fotografi paraqesin një variant paje nusërie karakteristike shqiptare.

Dihet që moshat më të vjetra nuk ishin në gjëndje të zgjidhnin pikërisht ato modele bashkohore. Sepse ne harrojmë që në çdo shekull ka pasur një modë , një mënyrë ndryshe nga vitet e kaluar për tu veshur. Për shembull shumë më përpara nusja vishej me çitjane të kuqe që ishte modë e importuar nga orienti. Pra ndikimi për stilet e veshjeve ka qënë gjithmonë prezente, ashtu siç është sot ndikimi perëndimor tek martesat shqiptare. Pra përgatitja e dasmës fillonte një vit përpara, mësoheshin për ceremonialin dhe si do hidhte këmbën e djathtë kur të hynte tek dera sepse pot ë bëhej gabim nga emocioni, që nusja të hidhte këmbën e majtë përpara do ishte blasfemi e madhe.Shikoni pra çfarë mizansene tepër strikte të dhënë nga rregjizura e shekujve , për tu zbatuar me përpikmëri , sepse kjo kishte simbolin e mbarëvajtjes së familjes së re që do krijohej.Pra këmba e djathtë është gjithçka dhe tërë shpura e dasmës e beson këtë me verbëri, pse? Sepse punohet me simboli, si në kishë , që po hyre duhet të bësh kryqin, ndryshe , kjo është një fyerje karshi krishtit dhe mund të ndëshkohesh. Duhet të mos harrojmë një gjë simbolet dhe paragjykimet kanë shumë pushtet mbi njerëzit. Në kishë regjizura është prezente kudo, edhe kur ngjyejnë gishtat tek uji i bekuar, e bëjnë kryqin, deri tek krezmimi që i bëhet fëmijës, ku mbas kësaj , janë të gëzuar, se ky fëmi u pranua në mbretërinë e zotit. Pra prifti lexon pjesë nga bibla tamam si aktor kryesor dhe besimtarët e

dëgjojnë me devocion pamvarsisht se ato pasazhe i dinë përmëndësh.
Përsëritja bën gjithmonë që në trurin tënd , ato mësime që kishës i interesojnë të ngulen fort dhe të mos shqiten për tërë jetën.Po kështu ndodh me simbolin zakonor të dasmave , ato kanë qënë ligje të pashkruara , që janë një partiturë veprimi dhe ajo duhet ta zbatonte pikë për pikë.Pra ky "teatër" që bëhej në një skenë që quhej dasëm , ndofta ishte më i vështiri nga të gjithë.Pastaj vinte pjesa tjetër e vështirë, përplasja me vjehrrën , puthja e dorës së saj tre herë. Pushteti psikologjik që ajo mundohej ta vendoste që në shikimin e parë.Se duhet ta kuptojmë që familjet labe, kanë veneracion për nënën e tyre, ata atë e quajnë si të thuash menaxheren e familjes.Prandaj nëqoftëse nusja padashje ose me dashje hynte në një konflikt me vjehrrën e saj , kjo parapërgatiste një stuhi të madhe në të ardhmen. Sepse gjithmonë dhëndrri në labëri ose mbante anën e nënës ose heshtëte.
Dihet që nënat labe kanë qënë shpesh herë të egra dhe tepër diktatore në familje, për arsye se atyre u kishte takuar të mbanin barrën e familjes në ekonomi, për arsye se burri gjithmonë largohej ose për të ruajtur dhëntë dhe ky ka qënë profesioni më i lëvruar në ato anë ose shkonte në kurbet , për të siguruar të holla për familjen.Punët e vështira gjithmonë duhej ti bënin burrat, gruaja labe mbetej kryetare familjeje me gjithë fëmijët.
Pra në këtë drejtim, nusja mbetej një rol karakteri i dytë ose mbështetës se ajo s'kishte asnjë lloj pushteti deri sa vjehrra e saj të mbyllte sytë. Imagjinoni sikur ajo të jetonte shumë gjatë , se në çfarë mjerimi psikologjik do i kalonte ditët e jetës nusja fatzezë.kjo ishte dramaturgjia e brëndshme e familjes.Kundra rregullave nuk mund të dilte asnjë përveç ndonjë dredhie që mund të përdorej, siç kemi për shembull nusen tek filmi "Përrallë nga e kaluara" , ku atë e martojnë me një çilimi , vetëm për interesa fitimi.Atëherë nusja vendos të mos rrijë kot, lufton me armët e tyre brënda rregullit "Më martuat, atëherë unë jam shtatzanë". Kjo gjë si kishte shkuar në mënd asnjërit, familja

tërbohet por s'kanë çfarë ti thonë, ajo vazhdon ta luajë lojën me shumë seriozitet, duke shprehur dhe revoltën e saj kundra këtyre zakoneve barbare që gruan e trajtonin si frymorë. Regjizori Anagnosti këtu ka punuar me një mjeshtëri shumë të madhe sidomos në përpunimin e karaktereve, sidomos fëmija 8 vjeç që ishte dhëndrri, i strukur në atë botën e tij fëminore, i cili s'kuptonte asgjë se çfarë po luhej në kurrizin e tij, krijonte një situatë humori dramatik që shkaktonte dhimbje tek spektatorët. Kjo dasëm si organizim regjizorial është nga trajtimet më të veçanta dhe groteske që është parë në regjizurën shqiptare.

Pra në të gjitha dasmat shqiptare kemi rite tepër origjinale që përbëjnë element rregjizorial spektakolar. Duke qënë shpesh herë ndër shekuj edhe të izoluar njëra krahinë nga tjetra, edhe ritet e dasmave ndërtonin rite të veçanta, sepse terreni malor i joni e përftonte këtë gjë. Por gjithmonë ato organizime "spektakli" nëqoftëse mund ti quajmë kështu nuk kishin gjëra të sforcuara ose absurde, çdo element e dasmës e kishte një nënkuptim, ndryshe nuk kishte përse të vihej. Edhe nusja nuk pranonte të martohej me filan djalë, për arsye shumë objektive, ka pasur raste që janë mbledhur pleqësia e fshatit dhe e kanë diskutuar fenomenin, prandaj nuk mund të themi se ekzistonte një intolerancë ekstreme.

Në të tilla raste kur një palë ose tjetra e kishte gabim çështjen, ndarjen ai ishte i detyruar të paguante edhe harxhet e fejesës , të cilat nuk diskutoheshin, nëqoftëse vendoseshin nga pleqësia e fshatit apo e krahinës, duhet ta kuptojmë mirë, se në atë kohë këto lloj gjyqe kishin autoritet apsolut, prandaj prishja e një fejese nga ana e djalit ose e vajzës duhej peshuar mirë, motivet e dashurisë as që përfilleshin fare , ashtu siç i kuptojmë ne sot. Për këtë çështje Wiliams thotë: "Në Shqipëri familjes ose trashëgimtarëve nuk u mbetet gjakmarrja vetëm për vrasje, por edhe për çështje nderi". [107]Kjo çështje pothuajse mbetet njëlloj për shumë treva të Shqipërisë. Djali dhe vajza pothuajse konsideroheshin mall për një treg në shitje sipas interesave të familjes sidomos shikoheshin me përparsi ana

---

[107] *"The Shkypetars", Xhorxh F. Wiliams, fq. 28*

ekonomike, pastaj morale, mbi këto baza mbështetej bashkimi në kurorë. Prandaj kur të dyja palët do paraqisnin faktet për këtë gjë, duhet të ishin zgjedhur tepër me kujdes, sepse temparamenti lab mund të merrte flakë dhe mbas kësaj nuk dihej si do të shkonte puna. Megjithatë pleqtë që zgjidheshin për këtë punë kishin autoritetin e duihur edhe zgjuarsinë ta peshonin mirë të vërtetën edhe gënjeshtrën sepse kishte raste që edhe ata mund të luanin me kokën e tyre në qoftë se nuk e ndanin ashtu siç duhet shapin nga sheqeri. Dihet që për këto gjëra krahina e labërisë ishte tokë e vështirë sepse ata krenarinë e manifestonin në çdo gjë. Kështu që duhej një mençuri tepër ekuilibriste, të bënte gjygje të tilla ku njëra familje do të gëlltiste fyerjen. Mos harrojmë se jemi në kohëra të tilla ku nderi dhe kranaria çmoheshin më shumë se çdo lloj pasurie tjetër. Labëria gjithashtu kishte edhe kanunin e vetë. Kështu që shumë gjëra i referoheshin edhe atij në këto raste. Por dihej se kjo fushë ishte pothuajse e minuar, prandaj para se të hynin në grindje familjet i peshonin mirë opsionet e ndarjes, sepse hasmëria gjithmonë kishte shuar familje të tëra. Dhe ky zakon vazhdonte prej shekujsh në këto krahina. Lufta vëllavrasëse për motive ndonjëherë fare të dobta, ishte karakteristikë e keqe e popullit tonë, bile kjo gjë nuk e lintë atë të bashkohej dhe të vazhdonte përpara. Natyrisht që këto lloj përçarjesh armiqve të kombit tonë i pëlqenin dhe bënin çmos ti shtynin urët për ti vazhduar këto zakone armiqësish .Prandaj lebërit në momente të caktuara e nuhasnin me intuitë se këto gjëra si bënin mirë shëndetit të krahinës dhe si për inat dilninmbi veten dhe kryenin proçesin e pajtimit, ose nëpërmjet pleqësisë , vulosnin drejtësinë.Raste të tilla pajtimi ose ndarje fejese në mirkuptim , krahina ka shumë .Por sidoqoftë dhënia e fjalës për martesë , ishte diçka e shenjtë dhe prishja e saj konsiderohej ters i madhë.

Por duhet ta kuptojmë mirë se dasma për labërinë ishte një eveniment i madhë, prandaj çdo gjë vlerësohej si një atmosferë madhështore.Vetë nusja kur vinte mbi kalin e bardhë , që ja kishte blerë babai dhe ishte pjesë e pajës , ajo konsiderohej si një

mbretëreshë, kur vinte tek dera e burrit me atë pamjen e saj madhështore.Dhe tërë shpura që ecte në këmbë duke i tërhequr kalin për kapistre. Konceptimi I nuses ditën e dasmës do të duhej "Të ndërmjetësohej nga imagjinata artistike, të dallonte të zakonshmen nga e pazakonshmja...atë që përsëritet nga ajo që mund të ndodhë rrallë".[108] Kështu shprehet Alfred Uçi për këtë eveniment.

Ishte padiskutim një mizansenë regjizoriale tepër efektioze, ku të gjithë ecnin në këmbë si shërbëtorë të kësaj mbretëreshe , veshur me të bardha.Sepse dihej që në këtë ditë të shënuar asaj i ishte lënë vendi kryesor.Të gjithë shikonin atë, të gjithë e kishin mëndjen tek ajo dhe mundoheshin të kapnin diçka nga bukuria e saj, por vështirë se do e zbulonin këtë mister , sepse rregjizura e kishte përcaktuar me kohë që bukurinë e nuses do ta shohë vetën një njeri:dhëndërri, asnjë tjetër nuk kishte të drejtë ta kontrollonte me sy atë, ishte e ndaluar .Rregulla strikte, shpesh herë të pa kuptueshme por tepër me vlerë për ritin .Megjithatë ne gjithmonë bëjmë pyetjen, pse nusja është me duvak dhe nuk i duhet parë fytyra nga të tjerë, kjo rregjizurë duket ndonjëherë tepër e çuditshme dhe pa logjikë, mos vallë ruheshin nga syri i keq?! Sepse është mjaft e çudithshme që me dhjetra dasmorë mblidheshin këtu për një eveniment tepër të rëndësishëm, bashkimin e dy njerëzve për të krijuar një familje dhe ata s'paskan të drejtë të shohin fytyrën e bukur të nuses. Ndofta kjo ka qënë edhe një mbrojtje sepse jo të gjitha nuset mund të jenë të bukura, kështu që ndonjëra që bukurinë nuk e kishte pronë të saj, bëhej ndofta objekt talleje në sytë e dasmorëve. Kjo sepse nusja duhet të ishte simboli i bukurisë por kjo lloj teorie ideale nuk shkonte shume me realitetin, atëherë siç duket regjizura iu duk më e arsyeshme që të gjitha nusen duhen mbuluar të tëra sepse bukurinë e saj e kishte të drejtë ta shihte vetëm burri i saj për herë të parë. Kjo dihej që absurdi i asaj kohe ishte se as vajza as djali nuk e kishin parë njëri-tjetrin. Ata do e verifikonin njëri-tjetrin vetëm ditën e dasmës dhe bile atë ditë nuk do të flinin bashkë po nusja rrinte në dhomë me një fëmijë të vogël. Diçka që sot ky zakon të lë me gojë hapur! Mos flasim pastaj për çarçafin që duhej

---

[108] *"Estetika e Groteskut III", Alfred Uçi, fq. 58, Tiranë 2001*

treguar me një njollë gjaku për tju mbushur mendjen të tjerëve që nusja ishte e pastër. Sigurisht kjo ndërhyrje kaq thellë në intimitetin e tjetrit, tregonte qartë se jetesa në fise e kishte lënë peng individualizmin e njeriut. Këto zakone sigurisht nuk kanë qënë të përhapura këtu por në shumë vënde dhe më të qytetëruara se ne. Virgjëria e femrës quhej një pasuri dhe ajo bënte pjesë në pajën e saj, ishte kusht i heshtur midis burrit dhe gruas. Prandaj ajo duhet ta dinte mirë se në qoftë se i mungonte ky kusht martesa mund të dështonte. Në kanunet tona martesore deri tek Lek Dukagjini dhe Skëndërbeu nuk njiheshin martesat me provë por kushtet e fshehta e parashikonin këtë gjë, prandaj në qoftë se një vajzë e kishte humbur virgjërinë para martesës duhet ta kuptonte mirë se në këtë primitivizëm që jetonte do e kishte tëpër të zymtë të ardhmen. Kjo nuk përbënte fare problem kur një grua e ve martohej për herë të dytë me një burrë por të ishte i ve. Se ajo të merrte një burrë beqarë pothuaj e kishte të pamundur, për arsye të opinionit tepër të egër që ekzistonte. Ritualet e dasmave ne trevat shqiptare dhe, respektivisht ketij shkrimi, ne Laberi jane rite tepër të çmuar që bota meqënëse është globalizuar po i shikon këto gjëra si perla të diversitetit, sepse ne po e shohim se çdo ditë kultura botërore po i humbet ngjyrat dhe po centralizohet si kurrë ndonjëherë. Ne perundim, mund te themi se ne kemi arsye tepër të plotë të mendojmë se karakteri i riteve tona popullore mbase po mbeti i pathyeshëm në këtë botë globale, do jetë gjithmonë shprehje e një karakteri diversiteti dhe ngjyre shumë të çmueshme në kolanën e artit botëror.Këto kalcifikime zakonore ritesh qëndrojnë shpesh herë gjatë të patundura, kur llogjika e tyre e brëndshme në mardhënie me psikologjinë e popullit, janë tepër harmonike ose me e thënë tamam bëhen pjesë e A.D.N. së popullit dhe pothuajse janë të pashkatërrueshme.

Literatura:

1. S. Vaqarri, Tradicionalitet dhe risi në dasmat tiranase,
2. S. Vaqarri, Praktika të ritualeve paramartesore
3. A. Dojaka, Dasmat në Shqipëri A.Dojaka
4. V.K. Dil, Martesa nëpër shekuj dhe krushqia midis elementave ndryshe në Shqipëri të lire, Tiranë: Shtypshkronja "Gjinokastra", 1924
5. F. Gjabri, Nusja e dhëndri, lotët në dasmën tradicionale : kode të dasmës tradicionale, shqiptare, Ballkan. - Nr. 254, 24 tetor, 2006
6. N. Bajramaj, Dasma vlonjate
7. J. Williams "The Shkypetares",
8. A. Uçi, "Estetika e Groteskut III", Alfred Uçi, Tiranë 2001
9. F. Gjabri, Psikologjia e dasmës tradicionale : pjesë nga ceremoniali i dasmës shqiptare të traditës, ritet dhe zakonet, Ballkan. - Nr. 280, 23 nëntor, 2006,
10. M. Dibra, Bukuria e nuses në këngët e ceremonialit të dasmës, Kultura popullore. - Nr. 1 - 2, , 2012
11. A. Isaku, Zakonet e harruara të dasmave, Koha jonë. - Nr. 183, 3 korrik, 2011
12. G. A. Bakiu, Martesat dhe dasmat, Klan. - Nr. 621, 10 korrik, 2009,
13. Hapja e pajës së nuses : tradita e dasmës së vjetër, Nacional. - Nr. 76, 19 - 26 dhjetor, 2010, Pëllumb Gorica
14. M.Mato, : Marrëdhëniet familjare, pjesa e I, Luarasi, 2001

Ne vigjile te 2. Korrikut 1990

IZVINITE DRUŽE PREDSEDNIČE II

Vazhdim i tekstit te dr. Skender Skenderit nga numri i kaluar

Kushtetuta e re e Serbisë me referendum popullor

Më 25.06.1990 Kuvendi i Serbisë aprovon niciativën për nxjerrjen e Kushtetutës së re të Serbisë dhe po atë ditë shpallë edhe Referendumin popullor për nxjerrjen e Kushtetutës së republikane për territorin e Serbisë, Kosovës dhe Vojvodinës i cili mbahet me 1 dhe 2 korrik 1990, të cilin Kosova nuk e përfill. Me këto akte Kosova mbetet me një statut të cilin e aprovon Serbia.

Më 26.06.1990 Serbia nxjerrë Ligjin mbi veprim në rrethana të posaçme në Kosovë, me të cilin filloi zbatimi I masave të posaçme në ndërmarrje dhe institucione në gjithë Kosovën.

Mbledhja e DHPB të Kuvendit të Kosovës

25.06.1990

Seanca filloi me kohë, u aprovua rendi i ditës pas shtyrjes së shumë pikave, realizimi i të cilave nuk kishte pengesë kohore. Me këtë u pajtuam të gjithë. Disa nga ligjet që mbetën për tu shqyrtuar kishin të bëjnë me regjistrimet në shkolla fillore, të mesme dhe fakultete. Disa pika tjera të rendit të ditës ishin edhe më urgjente pasi nga ato varej mirëvajtja e Kuvendit të RS të Serbisë, pasi për to ishte i domosdoshëm edhe mendimi i Kuvendit të KSA të Kosovës. Disa ligje të tjera kishin të bëjnë edhe me mirëvajtjen e Kuvendit të RSF të Jugosllavisë, ashtu që mbledhja duhej të kryente punën sa më shpejtë, pra pikat e rendit të +ditës, mundësisht të shqyrtohen në këtë seancë.

U kalua në pikën e parë dhe ajo u krye.

Para se të kalohej në pikën e dytë të rendit të ditës, delegatët serb e malazias e lëshuan mbledhje, pa ndonjë arsye bindëse. Iu bë thirrja dhe lutja që ta vazhdojmë mbledhjes vetëm për pikat më urgjente, por nuk pati sukses. Disa kolegë më vonë na treguan se para mbledhjes gjatë bisedave, kishte pasur kërkesa që të shtyhet kjo

seancë së paku për tri – katër ditë. Sinqerisht, unë e dija se këto ishin shantazhe të porositura për pengimin e çdo gjëje jo vetëm në Kuvend por edhe në shumë vende tjera. Ta kemi parasysh rasti e konviktit të studentëve në Prishtinë, zbrazjen e konviktit, me kusht që studentët të kthehen pas 7 ditësh, mos vijimin e mësimit të studentëve serb në Universitetin e Prishtinës etj.

Para se të filloi seanca, delegatëve iu shpërnda Konklusioni mbi "Disa çështje aktuale nga fusha e arsimit, shkencës dhe kulturës" *i cili ishte dërgua nga Këshilli për arsim, shkencë dhe kulturë:*

Për hire të së kaluarës në këtë Kuvend, për hir të shumë gjërave tjera, pranuam që, mbledhja të vazhdoj të hënën me 27.06.1990 në të njëjtën kohë në përbërje të plotë.

Obligim nga kryetari i Kuvendit të KSA të Kosovës nga data është lajmërimi se

"Seanca VIII e ndërprerë e Kuvendit të KSA të Kosovës vazhdon më 2.07.1990 në 10:00".

Formimi i grupit të delegatëve për veprime urgjente

Vendimi i delegatëve të pakënaqur për seancën e ndërprerë në mënyrë arbitrare nga kryetari Bozhoviq, vendosin të mbajnë mbledhje të pandërprerë të Kuvendit deri në zgjidhjen e problemeve me rendin e ditës (21. 06. 1990).

Kundërshtimet e fuqishme të synimeve serbe;

Krijimi i grupit joformal të Kuvendit për punë jashtë Kuvendit (në shtëpinë e delegatit dr. Sender Skenderi, Arbëria 1, rruga" Metush Krasniqi " nr. 27).

Ishte koha kur tërë pjesa shqiptare e delegatëve kishin vetëm një orientim: të vihej në rend dite inicimi i hartimit të Kushtetutës së KSA të Kosovës. Kjo kundërshtohej me të gjitha mjetet nga Kryetari i Kuvendit Gjorgje Bozhoviq dhe të të gjithë delegatëve serb, e përkrahej fuqimisht nga të gjithë delegatët joserb e malazias. Puna në Komisionin kushtetues nuk kishte më mundësi as të mblidhej, dhe në

këtë situatë sekretari i Komisionit kushtetues z. Halit Muharremi mu lutë që të përpiqem ta sigurojmë një vend pune jashtë lokaleve të Kuvendit ku do të punojë një grup i emergjencës i delegatëve në lidhje me çështjen e Kushtetutës së Kosovës. Menjëherë ofrova shtëpinë time, duke ju falënderuar për besimin që kishte në mua. Më tha që të lajmëroja disa delegatë, të cilët edhe ai do të përpiqet ti lajmëronte. Ashtu u bë.

Vazhdimi i mbledhjes së DHPB nga 25.06.1990

27.06.1990

Sipas marrëveshjes së të premtes, delegatët shqiptarë kishin ardhur në terminin e caktuar për vazhdimin e mbledhjes së DHPB, por u panë dy mungesa të mëdha: një, mungojnë të të 6 delegatët serb e malazez, dhe dyert e sallës së amfiteatrit të DHPB ishin të mbyllura!

E gjithë administrata ishte në nëpër vendet e punës, po ashtu të gjithë përgjegjësit ishin nëpër Kuvend, të gjithë e dinin se dyert e delegatëve legjitim iu ishin mbyllur me urdhër të dikujt (në shumës), por asnjë veprim i duhur nuk u mor!

Në vazhdim ishin shumë propozim ligje republikane dhe federative për të cilat duhet deklaruar dhoma. Pas mbarimit të punës rreth këtyre ligjeve, delegatët e DHPB të Kuvendit të KSA të Kosovës, dhanë edhe shume mendime e iniciativa të tjera që lidheshin me disa mungesa në punën e organeve të RS të Serbisë, ndaj Kuvendit të RSA të Kosovës. Kishte shumë pyetje pse draft ligjet dërgohen në shqyrtim në Kosovë vetëm në gjuhën serbe?

Në pikën e rendit të ditës cilat përmendore duhej të mbroheshin me ligj në Kosovë, propozimet ishin të orientuara vetëm në pronat me përkatësi serbe e asnjë të përkatësisë së kulturave tjera që jetojnë në Kosovë. Delegati Adem Mikullovci propozoi që ky ligj të refuzohej si i tillë, dhe të plotësohet edhe me përmendore kulturore tjera që në Kosovë janë me shumicë. Duhet që për të gjitha këto të ketë fjalën edhe Enti Krahinor për mbrojtjen e monumenteve kulturore.

Mbledhja më në fund punoi dhe mbaroi obligimet minimale (pasi shumë pika ishin shty për mbledhjen tjetër – e cila nuk u mbajte kurrë!).
Jehona e kësaj mbledhje në opinion ishte madhështore. TV Prishtina, organizoi një emision të posaçëm të gjallë, ku u thirrën 5 delegatë (dr. Skender Skenderi, Muharrem Shabani, Adem Mikullofci, Ramadan Kelmendi dhe Bujar Gjurgjeala).
Delegatë të DHPB të kryetari Hisen Kajdomqaj
27. 06. 1990

Pas mbarimit të mbledhjes së DHPB të KSAK delegatët Dr. Skender H. Skenderi *dhe* Muharrem Shabani *në emër të delegatëve tjerë të DHPB Kuvendit të KSA të Kosovës shtruan kërkesën që një delegacion i këtij Kuvendi të pranohet së shpejti edhe në Kryesinë e KSA të Kosovës. Kjo është e domosdoshme sepse gjendja e rëndë në Krahinë ka arritur kulmin. Kryetari i Kryesisë së KSA të Kosovës Kajdomqaj na pranoj po atë ditë.*

Skender Skenderi *falënderojmë gatishmërinë e juaj për pranim kaq të shpejtë. Siç e dini situata në Kosovë po bëhet gjithnjë e më e keqe. Ndërhyrjet e Serbisë nuk kanë të ndalur edhe në kompetencat e Kosovës ndaj Federatës. Ne patëm takim me kreun e Qeverisë Jugosllave ku shumë gjëra u prezantuan dhe u sqaruan, prandaj në emër të delegatëve të Kuvendit tonë, kërkojmë që Ju të na mundësoni takimin e një delegacioni të Kuvendit të Kosovës me Kryesinë e RSFJ-së, mundësisht sa më shpejtë.*

Muharrem Shabani *duke i bërë vështrim mbledhjes së kaluar dyditëshe të Kuvendit të RS të Serbisë, tha se* "delegatët nuk do të pranojnë asnjë vendim që shkon në dëm të popullatës shqiptare në Kosovë, por as në dëm të cilitdo komb a kombësi në Krahinën tonë. Ne delegatët, shtoi ai, nuk kemi pranuar dhe nuk do të pranojmë kurrfarë separatizmi, por duam të mbrojmë Jugosllavinë të ndërtuar mbi baza të KAÇKJ-së dhe autonominë e Kosovës. Me këtë, pra, nuk kërkojmë asgjë më shumë, por njëherësh edhe asgjë më pak se të tjerët dhe luti Hisen Kajdomqajn që këto bindje dhe kërkesa të

delegatëve, por edhe të popullit tu përcillen organeve më të larta të vendit"[109]. *Në fund Muharrem Shabani konstatoi se gjendja e jashtëzakonshme në Kosovë "de jure" është hequr, por "de facto" ajo është trashur edhe më shumë dhe theksoi se masat e fundit të Kuvendit të RS të Serbisë janë vetëm një lloj stabilizimi fiktiv i gjendjes, por me to nuk arrihet asgjë në shtigje më të gjata".*

***Feride Hyseni** u angazhua që Kryetari dhe Kryesia e tij të bëjnë përpjekje për zhbllokimin e punës të Kuvendit të KSAK dhe të ruhet niveli i parlamentit, sepse, shtoi ajo, ne nuk duam të pushtojmë Kuvendin dhe ne nuk jemi për majorizim, siç trumbetohet nga disa mjete të informimit e zyrtarë. Ajo shtoi edhe kërkesa konkrete: të ruhet elementi konstituiv i KSAK në Jugosllavi, organet krahinore të jenë më aktive dhe ta ndajnë fatin me popullin, si dhe ti mobilizojnë të gjitha forcat për tejkalimin e situatës së tashme të rëndë në Krahinë dhe ta ruajmë barazinë.*

***Bujar Gjurgjeala** pati vërejtje për pasivitetin e Kryesisë së KSAK dhe tha se shtrohet pyetja a kemi fare Kryesi apo jo. Ai vlerësoi se politike e tashme ndaj Kosovës nuk zgjidh asgjë, por vetëm destabilizon edhe më tutje gjendjen dhe në këtë aspekt kërkoi të ndërmerren aksione stabilizuese.*

***Ramadan Kelmendi** kërkoi që në kuadër të kompetencave të Kryesisë të aktualizohet gjendja në Kosovë. Për ndryshimet kushtetuese në Serbi, ndërkaq, shprehu bindjen se janë të papranueshme dhe kundër-kushtetuese dhe në këtë aspekt veçmas apostrofoi Ligjin republikan për veprim në rrethana të posaçme në Kosovë. Edhe ky delegat u angazhua për elementin konstituiv të Kosovës në Federatë, dhe që akti më i lartë juridik i saj të jetë kushtetuta, e jo statuti, siç propozohet.*

***Sabri Hashani** kërkoi nga Kryesia të veprojë në mënyrë më energjike dhe urgjente për të penguar kolapsin e ekonomisë së Kosovës. Ai tha se në Elektro-ekonomi të Kosovës milicia është vazhdimisht e pranishme dhe se ajo pengon mbajtjen e mbledhjeve.*

---

[109] *Për mua, ky qëndrim ishte shkak që Muharrem Shabani duhej ta udhëhiqte seancën VIII të Kuvendet të KSAK.*

Ky folës në fund përmendi edhe kërcënimin e kryetarit të Këshillit punëdrejtues të Elektro-ekonomisë së Kosovës Petar Kostiq.

***Basri Bajrami** u angazhua që Kryesia e KSAK dhe kryetari i saj të kenë qëndrimin e vet, pastaj përmendi rastin e fabrikës së Tubave në Ferizaj, ku tha, ai, manipulohet me djersën e 900 punëtorëve shqiptarë të qitur në rrugë, kurse 300 punëtor serbë e malazez marrin nga 15 miliardë dinarë të vjetër rrogë në bazë të rezultateve të arritura në punë më herët e me djersën edhe të punëtorëve shqiptarë.*

Në fund ky grup delegatësh kërkoi nga Hisen Kajdomqaj që të insistohet edhe te kryetari i Kuvendit të KSA të Kosovës Gjorgje Bozhoviq për ta mbajtur në rregull seancën e caktuar nga ai për 2 korrik të këtij viti.

***Hisen Kajdomqaj** duke iu drejtuar këtyre delegatëve, theksoi se qysh sot e nesër në mbledhje në nivel republikan dhe atë federativ do t' i përcjellë të gjitha këto kërkesa, bashkë me atë që ato të pranohen edhe në Kryesi të RSFJ-së.*

Takimi i parë: Formimi i grupit të delegatëve dhe njohuritë me detyrat

27.06.1990

Veprimtaria e këtij grupi ishte përqendruar në përgatitjen e një dokumenti të cilën Kuvendi do ta realizonte urgjentisht. U bë edhe një thirrje disa udhëheqësve dhe funksionarëve nga Kosova për deklarim publik, e cila u botua aso kohe në Rilindje. Në Rilindjen e dy korrikut ishte deklarimi i z. Riza Sapunxhiu. Në seancën e parë ishin prezent 17 deri 20 delegatë. Të gjitha takimet e këtij grupi u mbajtën në shtëpinë time në Prishtinë, në lagjen "Arbëria 1" në rrugën "Metush Krasniqi" nr. 27 (ish Dragodan).

1. *Halit Muharremi, sekretar i Komisionit Kushtetues.*
2. *Skender Skenderi, delegat*
3. *Muharrem Shabani*
4. *Ramadan Kelmendi*

5. *Bujar Gjurgjeala*
6. *Kadrije Ismali*
7. *Selvije Gjinaj*
8. *Enver Pula*
9. *Shaban Hashani*
10. *Qazim Kelmendi*
11. *Sabri Hashani*
12. *Ruzhdi Bakalli*
13. *Adem Mikullovci*
14. *Gafurr Kiseri*
15. *Rushdi Bakalli*
16. *Qemajl Sahatqiu*
17. *Adem Mikullovci*
18. *Shemsi Hajdini etj. (Në çdo takim ka pasur edhe delegatë të tjerë).*

Gjorgjeviqi ndërron datën 2.07.1990 për vazhdimin e mbledhjes me 5.07.1990

Më datën 30. 06. 1990 Kryetari i Kuvendit dërgon telegram shtetëror me këtë përmbajtje:

TELEGRAM SHTETËROR

Vazhdimi i mbledhjes së ndërprerë të të gjitha dhomave të Kuvendit të KSA të Kosovës do të mbahet më 5. 07. 1990 në ora 10:00.

Prishtinë, më 30 qershor 1990

Kryetari i Kuvendit, Gjorgje Bozhovic, d. d.

Thirrje urgjente në Kryesinë e Kuvendit

U thirrën disa delegat për të aprovuar shtyrjen e datës së mbajtje së seancës së VIII jo. me 2. 07. 1990 siç ishte caktuar më

parë, por të mbahet më 5.07.1990. Ishim prezent delegat të përzier. Por asnjë nga delegatët shqiptar nuk pranoj këtë ndryshim.

Urgjent një emision TV

Me qëllim të popullarizimit të datës ***Dy korrik 1990*** *e cila ishte pranuar si e përshtatshme edhe nga grupi joformal i delegatëve nën udhëheqjen e Halit Muharremi, tasht si datë të* ***shpalljes së Deklaratës Kushtetuese****. TV shtetëror organizoj këtë emision në të cilin ishin këta delegat: Dr. Skender H. Skenderi, Muharrem Shabani, Adem Mikullofci, Bujar Gjurgjeala dhe Ramadan Kelmendi. Gazetar ishin Sylejman, drejtues i emisionit dhe Mahmuti, kontaktuesi me dëgjuesit e emisionit.*

Takimi i dytë e grupit të delegatëve: Informim për përgatitjen e vazhdimit të tretë të seancës së VIII

29.06.1990

Versioni i parë*: mbledhja mbahet në sallën solemne. Në vartësi se kush do të kryesoj mbledhjen, duhej përcjell situatën në lidhje me rendin e ditës. Në të duhej të vihej pika e re* Nxjerrja e Deklaratës Kushtetuese e Kosovës.
Versioni i dytë: mbledhja nuk lejohet të mbahet brenda. Sipas situatës që e krijuam në Kuvend në seancat e fundit, këtë e pritshim të gjithë. Në këtë rast, pas arritjes së kuorumit të duhur të delegatëve, Dr. Skender Skenderi me një arsyetim se mungojnë kryesuesit e Kuvendit, do tu drejtohej delegatëve me këto fjalë: "Kolegë të nderuar, nëse më lejoni, propozoi që këtë seancë ta kryesoi delegati Bujar Gjurgjeala, pasi kemi kuorumin***".***
Versioni i tretë: *si ta lypte nevoja.*

Deklarata Kushtetutare mbi Kosovën e Re Demokratike e Forumit Demokratik të Kosovës

(1. 07. 1990, Prishtinë)

Forumi Demokratik i Kosovës (në përbërje nga përfaqësuesit e të gjitha Partive dhe Grupeve politike opozitare, LDK – ja , Parlamenti rinor, PSDK, Partia Fshatare, UJDI, dega në Prishtinë, Këshilli iniciativ i Partisë së të Gjelbërve të Kosovës, Intelektualët e pa varur dhe KMLD (Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të njeriut) në Kosovë aprovoi Deklaratën Kushtetuese mbi Kosovën e Re Demokratike. Kjo është baza politike (e arritur me konsensus të plotë) mbi të cilin synohet ndërtimi i Kosovës së Re. Në Forum murrën pjesë mbi 500 veta përfaqësues të të gjitha Partive dhe Grupeve opozitare të Kosovës. Pasi që forcat policore u kërcënuan se do të shpërndajnë tubimin me dhunë, Forumi aprovoi Deklaratën pa diskutime dhe pa debat.

Kongresi i parë i Bashkimit të Sindikatave të pavarura të Kosovës
(1-2. 07. 1990, Gjakovë)

Në Gjakovë u mbajte me plot sukses Kongresi i Parë i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës. Referatin kryesor e paraqiti dr. Hajrullah Gorani i cili nga Kongresi u zgjodh Kryetar i BSPK. Pak para përfundimit të punimeve të Kongresit, në sallë hynë inspektorët e sigurimit serb dhe e arrestuan dr. Hajrullah Goranin, i cili u lëshua pas "bisedës informative" me pushtetin policor serb. Në këtë ishte prezentë edhe veprimtarja e njohur ndërkombëtare Eva Bredli.

Teksti final i Deklaratës Kushtetuese e Kuvendit
("Bota Sot", 2 korrik 2005, faqe 7)

Nuk ka shqiptar që nuk rrëqethet kur i dëgjon fjalët e Muharrem Shabanit, edhe pas, me siguri për të 100-të herë nga leximi i parë me 2 korrik të vitit 1990. Lus të gjithë dëgjuesit që sa herë ti dëgjojnë këto fjalë historike, të mendojnë se ***i lexon*** *akademiku i nderuari Akademik profesor dr. Gazmend Zaimi, se i lexon profesor dr. Ejup Statovci, se i lexon profesor dr. Kurtesh Salihu, se i lexon profesor dr. Ismet Salihu, se i lexon profesor dr. Riza Smaka, se i lexon profesor dr. Fatmir Fehmiu, pasi në pyetjen*: kush e përgatiti tekstin final të Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990 dhe Kushtetutën e parë të Republikës së Kosovës - Kaçanikut, të 7 *shtatorit, koordinatori i detyrave të fundit përmbledhëse me një grup*

delegatësh, i cili ka qenë në qendër të të gjitha ngjarjeve, zoti Halit Muharremi deklaron:

". . . Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, në krye të së cilës atëherë ishte Akademik Gazmend Zajmi", z. Halit Muharremi më tutje shkruan:

"Sa për koincidentë, pikërisht sot, më 29 qershor, kur edhe e zhvillojmë këtë bisedë për "Botën Sot", bëhen 15 vjet kur për herë të parë në shtëpinë e delegatit Skender Skenderi, në Arbëria 1, ish Dragodani në Prishtinë, kisha ftuar nja 15 delegatë të Kuvendit të Kosovës, ku për herë të parë shpalova konceptin politik të Deklaratës Kushtetuese. Në atë takim definitivisht jemi marrë vesh dhe dakorduar edhe për të gjitha detajet e tjera të organizimit të mbledhjes së 2 Korrikut, jemi marrë vesh se kush do ta udhëheq mbledhjen, kush do ta lexojë tekstin e Deklaratës, por jemi marrë vesh edhe për variantet, nëse ndodhë kështu, apo ashtu, në rast të ndërhyrjes së policisë serbe etj.

Po në këtë takim kemi harmonizuar përfundimisht edhe tekstin final të Deklaratës, që në fakt ishte i kryer në takimet e tjera të rrethit më të ngushtë të ekspertëve tanë eminentë shkencorë që ato ditë punonin pa ndërprerë në këtë çështje, e ata ishin: Profesor dr. Ejup Statovci, profesor dr. Kurtesh Salihu, profesor dr. Ismet Salihu, profesor dr. Riza Smaka, profesor dr. Fatmir Fehmiu.

Takimi III: Shpalosja e "Deklaratës Kushtatuese"

1.06.1990

Në seancën e tretë e grupit të delegatëve u lexuan dy tekstet e prezantuara dhe u bë aprovimi i tekstit të Akademisë së shkencave dhe arteve të Kosovës. Ky tekst ishte i emërtuar "Deklaratë Kushtetuese" që do ta aprovonte Kuvendi në mbledhjen e rregullt të Kuvendit që ishte caktuar zyrtarisht për 2 korrik të vitit 1990.

Sipas vendimit të grupit të delegatëve që punonin në shtëpinë e delegatit Skender Skenderi, nën koordinimin e Halit Muharremit, mbrëmjen e ditës e diel, 1 korrik 1990 u përgatit mbledhja solemne e Kuvendit të RSA të Kosovës dhe u shpalos përmbajtja e Deklaratës

kushtetuese edhe për të pranishmit në atë mbledhje (përpos delegatëve, aty ndodhej edhe Nadire Skenderi, arsimtare, e zonja e shtëpisë, Burbuqe Skenderi, stud. e mjekësisë, Arbene Skenderi, st. e Fizikës dhe Besnik Skenderi, që me shokun e tij Mustafa bënin roje prapa shtëpisë por nuk di a dinin përse?

Kuvendin do ta kryesoj delegati Bujar Gjurgjeala, i cili e ka kryesua edhe Seancën III të Dhomës së Punës së Bashkuar.

Tekstin e Deklaratës, sipas të njëjtit vendim do ta lexoi delegati Muharrem Shabani.

U vendos që me përgatitjen teknike, të shtypjes, të shumëzimit dhe të dorëzimit në çastin e duhur ta bëjë dr. Skender Skenderi.

Në këtë mbledhje është aprovuar teksti e Deklaratës së dytë pa asnjë vërejtje nga ana e koordinatorit dhe e të gjithë delegatëve prezent: Halit Muharremi, koordinator dhe kryetar i Komisionit Kushtetues, Skender Skenderi, Muharrem Shabani, Selvije Gjinaj, Bujar Gjurgjeala, Kadrije Ismaili, Enver Batalli, Adem Mikullofci, Kadrije Gashi etj.

Detyrat më me rëndësi iu besuan delegatëve të caktuar të cilët të propozuar nga koordinatori z. Halit Muharremi janë:

Udhëheqja e seancës plenare të të tri dhomave i besohet delegatit ***Bujar Gjurgjeala****;*

Përgatitja teknike e tekstit të draft Deklaratës Kushtetuese dhe ruajtja e saj deri në çastin e leximit i besohet delegatit ***Dr. Skender Skenderi****;*

Leximi i tekstit të Deklaratës Kushtetuese i besohet delegatit ***Muharrem Shabani****;*

Grupi i delegatëve për thirrjen e udhëheqësve të Kosovës u besohet delegatëve:

Skender Skenderi, Muharrem Shabani, Bujar Gjurgjeala, Selvije Gjinaj dhe Ramaden Kelmendi.

Pas mbarimit të punëve, delegatët që udhëtonin më larg e lëshuan shtëpinë të parët. Më pastaj grupi tjetër dhe aty mbetëm pak delegat dhe i fundit që e lëshoi shtëpinë ishte Halit Muharremi.

Poezi

Nikolin Gurakuqi

HIMNI I SHPIRTIT

Vetmi të dua shumë
Ti më jep privilegjin
Të të puth,të të prek,të të ndjej
i privilegjuari yt jam
se ti më bën zot të heshtjes,
zot të qetësisë së mistershme
zot të gjithësisë
zot të tingujve të kambanës shpitërore
tinguj që ndryshe quhen "Himni i Shpirtit"
himn qënuk këndohet as në teatro
as në dasma,as në vaki,
por midis mureve të padukshme
të kambanës shpirtërore
himn rënkues që kurrë nuk ekzaltohet
por aty poshtë rri
në notat e ulëta të pentagramit
e nën shoqërinë e tij me vetmi,
me mua përqafohet
e mëbën vehten ta ndjej
zot të heshtjes e të gjithësisë.

TË VËRTETAT TUA

Në pusin e thellë të ndërgjegjes njerëzore
Ku ruhen në skedarë
shumë të vërteta të pathëna
u shtuan edhe të vërtetat e tua të skeduara

të bukura, të trishta,
të ëmbla, të hidhura,
si vetë dielli,
si vetë hëna.

ECIM PRESIM

Në anijen e ferrit kemi hipur
Ne humanët dykëmbësh
Dhe presim,presim duke rrugëtuar
me anijen prej dheu
që kurrë nuk ndalet së ecuri,
ndërsa ne presim, presim,
presim që fëmijë të lindim,
pstaj vrapojmë për t'i rritur
kur sëmuren e në shtrat gozhdohen
si Jezusi në kryq,
ne presim,presim,
nga sëmundja të çlirohen
Anija prej dheu lodhet duke pritur,
prandaj nuk ndalet së ecuri,
ndërsa ne presim,presim,
presim diellin të lindë,
hënën të ndriçojë në errësirë
shiun të vrapojë,borën të vallzojë,
stinët njëra tjetrën të zëvendësojnë,
presim fëmijët t'i shkollojmë,
e pataj t'i martojmë,
presim rrogën të marrim,
pushimet të marrim,
pastaj presim qeveritë të ndërrohen,
e lumturinë të na bjerë nga qielli
ashtu si shiu,
pastaj presim, presim duke rrugëtuar
me anijen prej dheu,
presim të gjithë të pasur e të varfër,
të gjallë e të vdekur,
presim në pension të dalim,
me anijen prej dheu ecim,
hipur në anijen prej ferri,
pastaj presim për të vdekur,
ecim, ecim,pastaj presim,presim,
nga asgjëja lindim,nga asgjëja vdesim,
nga asgjëja vijmë,nga asgjëja shkojmë,

se asgjë jemi, kohë e humbur jemi,
kot që t'j fillojmë,
anija prej dheu
ecën edhe pa praninë tonë.

GJYSTES

T'hânen âken dit pazarit
Dikush trekton, dikush ën pûn
Kallabllêk ûlej prej malit
Vet ën shkoll e ti me drû
Fushës Dinoshës jem tye u ûl
Tye me qesh tye kûvêt
Ater rrishim mê jâj gur
Me pushua me zân vêt

Na konopët i shtrgoshim
Kur ja merrte ânâ gomarit
N'maje t'gishtêt na u çoshim
Meu rrok për krye samârit

Po kur delshim prej Podgoricet
Dora,dora si dy fëmi
U afroshim rrâx Pllanicet
Aty u dashim plotë dashtni
Tuk u dashim më merrte mâlli
Se nuk dijsha kur kem me u pa.
Ty po t'merr fusha e mua mâli
Ëm dhêpte zêmra çi jem da
Vet t'kqyrsha prej mâjes mâlit
Per buz Cemit ka pom tret
Ater i pëshilsha syt e ballit
Se zêmra ême po pëlset
Ura e Dinoshës kjoft mallkua
Se shum her naka da
Jekshtû Zoti nêka shkrua
Kurrmâ Gjyste mos meu pa
Dashtnija jon u çkatërrua
Kur m'errdh letra për ushtri
E ty ropët t'kan fejua
Vet su ktheva ma në Malsi!

Dodë Gjeka Vulaj

KERKOJA

Të thuri vargjet tona
të mbushura rreze dielli
Në buzë oqeani t'dagëzuar
Kur nuk pranë së trazuari

Edhe kur derdhja loti dhembe
sikur të pushojn dallgët
Ajo gaojë hapur të mbyllet
Që të më fliste bukur

Dhe buzeve tu i'pte shpresë jete
Vetëm t'ju ndalet rrufeja e djegjes
Me ato njofulla prej çeliku
Sa shumë gjakun thithët

Shumë mund e djersë rrëmbyet
Fëmijëve tanë të uritur e t'etur
A e dini se ëndrrat kurr nuk vdesin
Ato t'gjalla mbetën der në vdekje dënesin

Po ashtu edhe pranverat mbesin
Gjithë hereë pas dimrit n'derë trokasin:

LOTI

Si kristal shkëlqen
Loti i gëzimit
I mbushur plotë helëm
Loti i hidhërimit
Që në zemër me vret
Ajo ma mori lumturin
Ju lutem me sillni pram
Se me mori malli ...
Therras ,më ze t'lodhur
Eh ,moj Evropë e vjetër
Mjiqind thirrje ti shkrova
nemrin e popullit tim

Që lirinë n'troje e veta kërkon
I ulur në cep të kënges
Historikun ne e shkruajm :
E krismave na kendojn mbi kry
As kush nuk më degjon
edhe pse fjala është e lirë
Edje kur flisjamkeq për evropen
I pa lëkundeshem qendroja
Kerkesat me gjakun tonë mbroja
Të mbushur shpres në rrezet e diellit
Nëpër dallgët e bubullia
Në trazirash detrash e furtuna
Djelt si sokola mbrojten tokë e shtëpia
Ndër shekuj numerore rrojnë
Perkrenare nga ajo kokë e brinje dhie
Gjergj Kastrioti e der ne Adem Jasharn.

QAZIM XANI

Në qerpikun tand një pik loti krenarie
Mbi çatit Kuqërore.
Tjer shi petalesh, në plaken mbi varr.
Ooo ,Mos me thuani se ka ikur pa këthim
Në këte vjeshtë ari , të këtij muaji 15. 10 .2014
mos me thoni që s'është më ne Qazimi
Ndiej plagë, për Ty dajë, shokë, pikon malli
Do të vij këtu të premtoj, do ta shuaj mallin
Pran varroit Tënd ....

ATJE N'JUUG

Ah , mbrëmja më thërrt
Në labirintin e gjërë
Atje ku frymon kënga
Gëzimi dhe dashuria
Versulem fluturimth
Në perqafim të erës së jugut
Për ti prekur Yjet
e shkendit e shkrepuara

Andej mbi valet e liqenit
Ngjyra, ngjyrë argjendi
Të mbytëm në ëndrra t'jetës
Si një mërgimtar i vjetër

UDHËTAR

Nëpër rrugë kryqe
Fala zemrën
Në heshtje m'shkoje
shiqimi e prap heshtje
I pluhërosur nga udhëtimi
Nga largë i ardhur
Më shiqon dhe heshtje
Po, duarët e thara
E asgjë në duar boshe...
Monolog i zbehur
Dëshprim jete e heshtje
E shpresen e mori era
Eh, dorëthati i ngati
Ska nderim ....
Rrugës hecnim heshtnim
Vetëm një rrugëtim
I shkurtë e vije fundi.
Rrugët shperndahen
Si dëshirat, por kujtimet
Mbesin pë tërë jetë
Pikë në zemër mbesin
Udhëtar i vetmuar mbetem

Andej mbi valet e ligenit
Natyra, ngjyrë argjendi
Të mbyllem në ëndra fjetës
Si një mërgimtar bujqësor

UDHËTAR

I

Nëpër mugë kryqe
Fsha zeqerân
Në hèshtje m'shkoje
shkjimi i prap hesht je
I plakërosur nga udhëtimi
Nga largë i ardhur
Më shkoj: dhe hesht je
Po, duarët e tharë
E asgjë në duar bosht...
Monolog i zbeht ur
Desh pim jetë e bosht ur
E shpresën e lmort ezë
Eh, dorëzhett i ngadi
Sikë ndenim...
Rrugës hecnim heshtrim
Vetëm një rrugëtim.
I shkurtë e vije tundi.
Rrugët shpërndahen
Si dështirë, por kuptimet
Mbesin në tërë jetë
Pikë në zemër mbesin
Udhëtar i vdekur mbetem

NARODNA IN UNIVERZITETNA KNJIŽNICA
GS
403 668 2015
920153760,5
COBISS

ALTERNATIVA